

KOMISIONI EUROPIAN

Bruksel, 9 nëntor 2005
SEK (2005) 1421

Shqipëria

Progres Raporti 2005

{KOM (2005) 561 final}

A. HYRJE..... 3

1. PARATHËNIE

2. MARRËDHËNIET NDËRMJET BE-së DHE SHQIPËRISË

B. ZBATIMI I PROCESIT TË STABILIZIM-ASOCIIMIT

1. GJENDJA POLITIKE

1.1 *Demokracia dhe shteti i së drejtës*

1.2 *Të drejtat e njeriut dhe mbrojtja e minoriteteve*

1.3 *Çështjet rajonale dhe detyrimet ndërkombëtare*

1.4 *Vlerësim i Përgjithshëm*

2. GJENDJA EKONOMIKE

2.1 *Zhvillimet ekonomike*

2.2 *Përparimi drejt stabilitetit ekonomik dhe konkurrueshmërisë*

2.3 *Vlerësim i Përgjithshëm*

3. STANDARDET EUROPIANE

3.1 *Tregu i brendshëm*

3.1.1. *Lëvizja e lirë e mallrave*

3.1.2. *Lëvizja e personave, shërbimeve dhe e drejta për vendosje*

3.1.3. *Lëvizja e lirë e kapitaleve*

3.1.4. *Doganat dhe tatimet*

3.1.5. *Konkurrenca*

3.1.6. *Prokurimi publik*

3.1.7. *Ligji i pronësisë intelektuale*

3.1.8. *Statistika*

3.2 *Politikat sektoriale*

3.2.1. *Industria dhe SME*

3.2.2. *Bujqësia dhe peshkimi*

3.2.3. *Mjedisi*

3.2.4. *Politika e transportit*

3.2.5. *Energjia*

3.2.6. *Shoqëria e informacionit dhe media*

3.2.7. *Kontrolli financiar*

3.2.8. *Politika të tjera*

3.3 *Drejtësia, liria dhe shoqëria*

3.3.1. *Viza, kontrolli kufitar, azili dhe migrimi*

3.3.2. *Pastrimi i parave*

3.3.3. *Drogat*

3.3.4. *Policia*

3.3.5. *Lufta kundër krimit të organizuar dhe terrorizmit*

3.4 *Vlerësim i Përgjithshëm*

C. PARTNERITETI EUROPIAN: VLERËSIM I PLOTË

A. HYRJE

1. Parathënie

Në Feira, në qershor 2000, Këshilli European konfirmoi që

“ka për objektiv integrimin e plotë të vendeve të Ballkanit Perëndimor në bashkësinë politike dhe ekonomike të Europës nëpërmjet procesit të Stabilizim-Asociimit, dialogut politik, liberalizimit të tregtisë dhe bashkëpunimit në Drejtësi dhe Çështje të Brendshme. Të gjitha shtetet e interesuara janë kandidatë potencialë për anëtarësim në BE”.

Bazuar në samitin e Selanikut në qershor 2003 midis BE dhe Ballkanit Perëndimor, Këshilli për Çështjet e Përgjithshme dhe Marrëdhëniet e Jashtme miratoi “Agjenda e Selanikut për Ballkanin Perëndimor: drejt integritit european”. Agjenda e Selanikut përforcoi procesin e Stabilizim-Asociimit me prezantimin e instrumenteve të reja për të mbështetur reformat dhe përpjekjet e këtyre vendeve për integrimin european, përfshi edhe Partneritetet Europiane. Kjo agjendë u nënshkrua nga Këshilli European dhe nga vendet e Ballkanit Perëndimor në qershor 2003.

Në qershor 2005, Këshilli European ritheksoi që

“... përparimi i secilit shtet drejt integrimin european, duke marrë parasysh evoluimin e acquis, varet nga përpjekjet e tyre për të respektuar kriteret e Kopenhagenit dhe kushtet e procesit të Stabilizim-Asociimit. Në këtë proces, bashkëpunimi rajonal dhe fqinjëria e mirë, do të vazhdojnë të jenë elemente thelbësore të politikës së BE-së.”

Struktura e raportit është thajse njësoj me atë të vitit paraardhës dhe vlerëson zbatimin e procesit të Stabilizim-Asociimit. Raporti:

- përshkruan marrëdhëniet midis Shqipërisë dhe Bashkimit European;
- analizon gjendjen politike në Shqipëri në aspektin e demokracisë, shtetit të së drejtës, respektimit të të drejtave të njeriut dhe mbrojtjes së minoriteteve;
- vlerëson gjendjen ekonomike në Shqipëri në aspektet e zhvillimeve ekonomike dhe përparimit drejt stabilitetit ekonomik dhe konkurrueshmërisë;

– shqyrton kapacitetet e Shqipërisë për zbatimin e standardeve europiane, domethënë, hartimin e legjislacionit në politika kyçe që të jenë sa më në përputhje me standardet dhe legjislacionin europian.

– ekzaminon shkallën e adresimit të prioritetëve të Partneritetit Europian.

Ky raport vlerëson përparimin që nga raporti 2004 dhe mbulon periudhën mars 2004 – 30 shtator 2005. Raporti vlerëson nëse janë realizuar reformat e planifikuara në raportin vjetor 2004, ekzaminon nismat e reja dhe vlerëson nivelin e përgjithshëm të zbatimit.

Progresi është matur në bazën e vendimeve *realisht* të ndërmarra, legjislacionin *realisht* të miratuar dhe shkallën e zbatimit. Si praktikë, nuk janë marrë parasysh ligjet ose masat që janë në faza të ndryshme të përgatitjes ose për miratim në Parlament. Kjo metodë garanton trajtim të barabartë të të gjitha shteteve dhe mundëson një vlerësim objektiv të secilit shtet në aspektin e progresit konkret në zbatimin e procesit të Stabilizim-Asociimit.

Raporti bazohet në disa burime informacioni. Shqipëria është ftuar që të paraqesë informacion për progresin e arritur që nga raporti i fundit. Për hartimin e raportit janë marrë parasysh diskutimet e Këshillit, raportet e Parlamentit Europian dhe rezolutat. Komisioni ka hartuar edhe një vlerësim të bërë nga shoqata të ndryshme ndërkombëtare, veçanërisht nga Këshilli i Europës, OSBE, institucionet e huaja financiare dhe organizatat jo-qeveritare.

2. Marrëdhëniet midis BE-së dhe Shqipërisë

Zhoillimet e fundit në marrëdhëniet dypalëshe

Shqipëria merr pjesë në Procesin e Stabilizim-Asociimit (pSA). Marrëdhëniet aktuale kontraktuale midis Komunitetit dhe Shqipërisë, bazohen në Marrëveshjen e Tregtisë dhe Bashkëpunimit Ekonomik (1922) e cila duhet zëvendësuar me Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit (MSA) sapo të përmbushen kushtet për përfundimin e saj. Disa pjesë të MSA-së do të vihen në zbatim nëpërmjet një Marrëveshjeje të Përkohshme deri në ratifikimin e plotë të MSA-së. BE është partneri kryesor tregtar i Shqipërisë dhe Shqipëria përfiton nga lëshimet e njëanshme tregtare në kuadrin e masave autonome tregtare të BE-së (MAT). BE u jep udhëzime autoriteteve shqiptare për prioritetet e reformave nëpërmjet

Partneritetit European, i cili pasohet nga takime të rregullta të CTF-së. Shqipëria përfiton edhe asistencë të konsiderueshme financiare nga BE.

Marrëveshje e Tregtisë dhe e Bashkëpunimit Ekonomik (1922) synon të zhvillojë dhe të zgjerojë tregtinë midis Shqipërisë dhe BE-së, si dhe të shërbejë si bazë për bashkëpunim ekonomik dhe tregtar. Mbikëqyrja e funksionimit të duhur të marrëveshjes, bëhet nga një Komitet i Përbashkët që mblidhet çdo vit, së fundmi në maj 2005 në Tiranë. Pesë Grupe Pune sektoriale takohen çdo vit për të monitoruar zhvillimet dhe reformat në fushat përkatëse dhe pastaj ia raportojnë Komitetit të Përbashkët.

Në periudhën prill 2004 – korrik 2004, takimet e Grupeve të Punës në Bruksel dhe Tiranë diskutuan një sërë çështjesh: *çështjet ekonomiko-financiare*: zhvillimet makro dhe mikro-ekonomike, buxheti, tregtia, çështjet fiskale dhe monetare; *bujqësia dhe peshkimit*, përfshi mbrojtjen e konsumatorit; *doganat dhe tatimet*: zhvillimet legislative dhe kapacitetet administrative; *harmonizimi i legjislacionit*: fusha me rëndësi të veçantë për negociatat MSA si për shembull të drejtat e pronësisë intelektuale, konkurrenca, prokurimi publik, ndihma shtetërore, ligjet mbi kompanitë, politikat SME, kontabiliteti, auditimi, lëvizja e lirë e mallrave, shërbimeve dhe kapitaleve.

Negociatat për një projekt-**Marrëveshje të Stabilizim-Asociimit** filluan në 2003. Që nga fillimi i marsit 2004, tre raunde zyrtare (përfshi përfaqësuesit e Shteteve Anëtare) dhe pesë raunde teknike janë mbajtur me autoritetet shqiptare për këtë projekt-marrëveshje. Tashmë është arritur në parim marrëveshja për shumicën e elementeve të tekstit të projekt-marrëveshjes. Sidoqoftë, në letrën në prill 2005 drejtuar ish-Kryeministrit, komisionari Rehn u shpreh qartë që Shqipëria duhej të realizonte zgjedhje të rregullta parlamentare në 2005 dhe arritje konkrete në prioritetet e Partneritetit European në fusha si shteti i të drejtës, pronësia e tokës, të drejtat e njeriut, liria e medieve dhe doganat, përpara se Komisioni të rekomandonte përfundimin e marrëveshjes.

Në nëntor 2004, në Bruksel u zhvillua në takim ndër-parlamentar midis Parlamentit European dhe Shqipërisë. Midis çështjeve në diskutim, ishte gjendja politike dhe ekonomike në Shqipëri, ku u vu theksi në ligjin zgjedhor, ligjin e pronave dhe luftës kundër krimit të organizuar. Kontaktet me Komitetit European Ekonomik dhe Social në lidhje me Shqipërinë, janë mbajtur rregullisht në nivel *ad hoc* gjatë periudhës raportuese.

Vendimi i Këshillit për miratimin e **Partneritetit European** për Shqipërinë, u botua në qershor 2004 (*shikoni pjesën C – Partneriteti European: Vlerësim i Plotë*).

Në shtator 2004, Shqipëria miratoi Planin e Veprimit për Zbatimin e Partneritetit European dhe në dhjetor 2004 dhe mars 2005 e njoftoi Komisionin për ecurinë e zbatimit të Planit të Veprimit.

Që në mars 2004, janë mbajtur pesë takime CTF me Shqipërinë. Takimet u përqendruan në prioritetet kryesore të Partneritetit European: lufta kundër krimit të organizuar, përgatitja e zgjedhjeve parlamentare 2005, respektimi të drejtave të njeriut nga organizmat e forcave të rendit, kthimi dhe kompensimi i pronave, liria e shprehjes dhe e medias, të drejtat e minoriteteve, migrimi dhe menaxhimi i financave publike. Në secilin takim u ra dakord për një paketë rekomandimesh për veprim nga ana e autoriteteve shqiptare.

BE është partneri **tregtar** i Shqipërisë, pasi përfaqëson 74% të importit total dhe rreth 85% të eksportit total. Eksportet e BE-së në Shqipëri u rritën me 95 nga 2003 në 2004, ndërkohë që importet nga Shqipëria u rritën me 10,2%, duke rezultuar në një thellim të deficitit tregtar të Shqipërisë me BE-në nga 760 milion EUR në 2003, në 820 milion EUR në 2004. BE importon nga Shqipëria mallra kryesisht industriale. Tekstilet zënë rreth 28% të importeve të BE-së nga Shqipëria dhe prodhimet bujqësore rreth 8%. Eksportet kryesore të BE-së drejt Shqipërisë janë makineritë dhe mallra të tjera industriale që përbëjnë 75% të eksporteve totale të BE-së. Prodhimet bujqësore zënë 15% të eksporteve totale të BE-së. Që në prill 2004, janë vendosur rregulla të përcaktuara për mbrojtjen e agrumeve, me efekte për të gjithë, rrjedhimisht mbulojnë edhe Shqipërinë. Një hetim për importin e luleshtrydheve të ngrira u hap në korrik 2005. Shqipëria përfiton nga Masat Autonome Tregtare të Komunitetit që në shtatori 2000. Këto masa lejojnë importimin e thuajse të gjitha mallrave nga Shqipëria në BE pa kufizime sasiore dhe pa barrë doganore. Përrjashtimi i vetëm është rasti i disa produkteve të lopës dhe peshkut, sheqerit dhe verës, të cilat janë objekt i kuotave preferenciale tarifore. Megjithatë, për të përfituar sa më shumë nga preferencat autonome të tregtisë, Shqipërisë i duhet të përmirësojë standardet fitosanitare, sanitare dhe industriale dhe të përmirësojë cilësinë e prodhimit, veçanërisht në sektorët e bujqësisë dhe të peshkimit. Është shumë e rëndësishme të nxiten investimet e huaja me qëllim rritjen e konkurrueshmërisë, duhet të përdorë në mënyrë më strategjike dhe agjencia e promovimit të eksporteve dhe të forcojë sekretariatit e OBT-së. Progresi në miratimin e standardeve të KE-së kërkon kapacitete zbatuese dhe bashkërendim më i mirë në ministritë e linjës.

Asistenca Komunitare

Gjatë periudhës 1991-2004, Shqipërisë i është dhënë një **asistencë Komunitare** rreth 1.2 miliard EUR nga të cilat 635 milion EUR janë përfituar nëpërmjet programit Phare. Lloje të tjera asistence kanë qenë ndihmat e mëdha në ushqime dhe emergjenca humanitare, mbështetja për zgjedhjet nëpërmjet OSBE, programi TEMPUS për projektet e vogla në sektorin e arsimit të lartë dhe hua nga BEI.

Në 2000-2004, Shqipëria ka përfituar rreth 240 milion EUR nga asistenca e BE-së (një akordim vjetor prej 50 milion EUR). Që në 2001, CARDS ka qenë instrumenti kryesor financiar i KE-së për Shqipërinë. Asistenca CARDS, që mbështet pjesëmarrjen e Shqipërisë në procesin e Stabilizim Asociimit, bazohet në katër fusha për sa u takon reformave: Çështje të Brendshme (rreth 40% të fondeve), Formimi i Kapaciteteve Administrative (rreth 20%), Zhvillimi Ekonomik dhe Social (rreth 35%) dhe Stabiliteti Demokratik (rreth 5%). Menaxhimi i projekteve të KE-së i është transferuar Delegacionit të KE-së në Tiranë, në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Integritit European në Shqipëri. Me përshpejtimin e ritmeve është përmirësuar zbatimi i programeve të asistencës KE.

Mbështetja e dhënë nëpërmjet CARDS në 2005, u përqendrua në përparësitë e Partneritetit European, të cilat marrin parasysh gjendjen politike dhe ekonomike në Shqipëri dhe kriteret që duhet të përmbushë Shqipëria për zbatimin e MSA-së. Asistenca totale që CARDS i ka dhënë Shqipërisë, arrin në 44.2 milion EUR. Katër fushat kryesore të ndihmës janë:

Stabiliteti Demokratik (2.4 milion EUR) – për rritjen e rolit të shoqërisë civile dhe medias në procesin e integritit european duke forcuar rolin e OJQ-ve, sindikatave dhe organizatave të tjera të shoqërisë civile, duke inkurajuar përfshirjen e tyre në debate dhe hartimin e politikave; me qëllim përballimin e sfidave sociale me anë të financimit të mekanizmit të shoqërisë civile që dikton shpërndarjen e shërbimeve sociale.

Mirëqeverisja dhe Ndërtimi i Institucioneve (26.6 milion EUR) – mbështetje për reformën gjyqësore (3.8 milion EUR), mbështetje për Policinë e Shtetit në luftën kundër krimit të organizuar dhe terrorizmit, dhe për garantimin e integritetit të policisë (3.0 milion EUR); për të mbështetur misionin PAMECA (7.0 milion EUR); formimi i kapaciteteve të administratës publike (4.3 milion EUR), ndihmë për

decentralizimin (5.5 milion EUR); dhe përmirësimi i tatimeve dhe doganave (3.0 milion EUR).

Zhvillimi Ekonomik dhe Social (14.7 milion EUR) – për përmirësimin e klimës investuese (3.2 milion EUR); për ngritjen e Autoritetit Kombëtar për Ushqimin (3.0 milion EUR); për mbikëqyrjen e ndërtimit të segmenteve rrugore kyçe (3,5 milion EUR); për trajtimin e “vatrave të nxehta” të mjedisit dhe për vlerësimin mbi zbatimin e legjislacionit për mjedisin (3.0 milion EUR); për zbatimin e TEMPUS III (1.0 milion EUR) që promovon zhvillimin e sistemit të lartë arsimor shqiptar dhe që ndihmon në zhvillimin e sistemit të sigurimeve shoqërore (1.0 milion EUR)⁷.

Hapja e Programeve për Komunitetin (0.5 milion EUR). Në samitin e Selanikut në 2003, BE pranoi që të lejonte edhe vendet e Ballkanin Perëndimor që të merrnin pjesë në programet për komunitetin, sipas modelit të zgjerimeve të mëparshme. Në nëntor 2004, ndërmjet Komunitetit dhe Shqipërisë u nënshkrua një marrëveshje-kuadër për pjesëmarrjen e Shqipërisë në Programet Komunitare. Komuniteti e ratifikoi marrëveshjen në maj 2005, po ashtu edhe Shqipëria nga ana e saj. Kontributi financiar shqiptar (‘bileta e hyrjes’) që kërkohej për shpenzimet e pjesëmarrjes në këto programe, mund të mbulohej pjesërisht nga buxheti CARDS.

Shqipëria përfiton edhe nga programi rajonal CARDS, i cili në 2005 pati një buxhet total prej 40.4 milion EUR, për të mbështetur veprimet me interes të përbashkët për rajonin e Ballkanit Perëndimor, për shembull në fushat si infrastruktura, krijimi i institucioneve dhe bashkëpunimi ndërkufitar në lidhje të ngushtë me aktivitetet Interreg.

Përveç asistencës CARDS, Shqipëria është një vend parësor për Nismën Europiane për Demokraci dhe të Drejtat e Njeriut, dhe përfiton nga programi LIFE për mjedisin, si dhe nga Programi Kuadër i 6-të për Kërkim dhe Zhvillim.

Komisioni ka përgatitur një memorandum mirëkuptimi për t’i dhënë Shqipërisë një asistencë makro-financiare (deri në 25 milion EUR: 16 milion EUR grant + 9 milion EUR hua). Kësti i parë prej 12 milion EUR do të lëvrohet para fundit të vitit 2005, pasi Kuvendi të ratifikojë Marrëveshjen e Huas në shtator 2005. Lëvrimi i asistencës makro-ekonomike, bazohet në disa kushte si përmirësimi i menaxhimit të financave publike me qarqe financiare më të sigurta, masat për përmirësimin e funksionimit të administratës publike, lufta kundër korrupsionit

dhe progresi i reformës në sektorin financiar. Shqipëria i ka përmbushur kushtet e nevojshme për të tërhequr këstin e parë.

Binjakëzimi

Një nga sfidat kryesore për Shqipërinë, është forcimi i kapaciteteve gjyqësore dhe administrative. Për të ndihmuar Shqipërinë në adresimin e kësaj çështjeje, samiti i Selanikut vendosi të zgjerojë mekanizmin “**binjakëzim**” për Ballkanin Perëndimor, i cili rezultoi i suksesshëm gjatë zgjerimit të mëparshëm. “Binjakëzimi” i garanton shtetit partner ekspertizën e sektorit publik të Shteteve Anëtare nëpërmjet transferimit afatgjatë të nëpunësve civilë të huaj, e shoqëruar kjo me misione dhe trajnime afatshkurtra me ekspertë. Ballkani Perëndimor mund të tërheqë ekspertizën e Shteteve Anëtare është nëpërmjet “binjakëzimeve të lehta” (projekte me kohëzgjatje deri në 6 muaj). Aktualisht në Shqipëri janë në zbatim 3 projekte binjakëzimi. Këto projekte ndihmojnë Strategjinë Shqiptare për Menaxhimin e Kufijve, Ministria e Financave në përmirësimin e Kontrollit të Brendshëm Financiar dhe Institutin e Statistikave. Edhe 4 projekte të tjera binjakëzimi janë planifikuar të fillojnë në 2005.

B. ZBATIMI I PROCESIT TË STABILIZIM-ASOCIIMIT

1. Gjendja politike

Kushtet e procesit të Stabilizim-Asociimit u parashtruan në përfundimet e Këshillit të Çështjeve të Përgjithshme në prill 1977. Për t'u bërë anëtarë të Bashkimit Europian, shtetet duhej të përmbushnin kriteret e vendosura në përfundimet e Këshillit Europian në qershor 1993 në Kopenhagen. Kriteret politike të Kopenhagenit, vënë si kusht që vendet duhet të kenë arritur "stabilitet të institucioneve që garantojnë demokracinë, shtetin e së drejtës, të drejtat e njeriut dhe respektimin dhe mbrojtjen e minoriteteve."

Elementet e ekzaminimit përfshijnë parimet demokratike, të drejtat e njeriut dhe shtetin e së drejtës, respektimin dhe mbrojtjen e minoriteteve dhe bashkëpunimin rajonal. Përveç këtyre, për disa vende merren për bazë elemente specifike si respektimi i detyrimeve ndërkombëtare siç janë marrëveshjet e paqes dhe bashkëpunimi me Gjykatën Ndërkombëtare Penale për ish-Jugosllavinë (ICTY).

Sipas raportit 2004 të Komisionit, në përgjithësi, interesat afatmesme të Shqipërisë shpesh u sakrifikuan nga interesat e ngushta afatshkurtra politike dhe konsolidimi i kulturës demokratike është thelbësor për realizimin e reformave të nevojshme. Klima armiqësore politike – tensionet midis partive kryesore dhe brenda Partisë Socialiste që kishte pushtetin në atë kohë – i vonoi reformat. Për pasojë, shumë mangësi të evidentuara në Raportet e mëparshme, nuk u adresuan.

Për sa i takon **demokracisë dhe shtetit të së drejtës**, raporti doli në përfundimin që, pavarësisht nga përmirësimi i kodit zgjedhor, në zgjedhjet lokale të tetorit 2003 u shfaqën të meta serioze. Aftësia e administratës publike për të vënë në zbatim Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit (MSA) vazhdonte të ishte një problem shqetësues. Edhe pse ishin marrë disa hapa për përmirësimin e funksionimit të sistemit gjyqësor, nevojiteshin përpjekje të konsiderueshme me qëllim zbatimin e ligjit, veçanërisht në lidhje me krimet e rënda. Reforma në administratën publike dhe forcimi i shoqërisë civile, kanë shënuar njëfarë progresi, por raporti arriti në përfundimin që nevojitet më shumë vendosmëri dhe vullnet politik, për të mundur përmirësim të mëtejshëm. Raporti konstatoi se ligji në Shqipëri vazhdonte të ishte i brishtë; korrupsioni dhe krimi i organizuar cilësoheshin kërcënime serioze për përparimin e vendit dhe se

kërkoheshin përpjekje të mëtejshme për respektimin e plotë të të drejtave të njeriut nga ana e organizmave përgjegjëse për zbatimin e ligjit.

Mbi të drejtat e njeriut dhe mbrojtjen e minoriteteve, raporti theksoi që edhe pse të drejtat e njeriut dhe liritë thelbësore janë të garantuara me ligj, duhet të shtohen përpjekjet për zbatimin e tyre. Gjyqësori duhet të ishte më i përgatitur për çështjet e të drejtave të njeriut. Kanë vazhduar përpjekjet e qeverisë për të ndërhyrë në media. Është arritur njëfarë progresi legjislativ për kthimin dhe rikompensimin e tokave të konfiskuara, nëpërmjet hartimit të ligjeve të reja. Shqipëria duhet të bënte përpjekje më të mëdha për mbrojtjen e minoriteteve. Shqipërisë iu kërkua veçanërisht të llogarisë përqindjet e minoriteteve në Shqipëri dhe të përmirësonte legjislacionin që ka të bëjë me minoritetet, në mënyrë që të mbështesë vënien në zbatim të konventave përkatëse ndërkombëtare të ratifikuara nga Shqipëria.

Për sa i takon **çështjeve rajonale**, Shqipëria ka mbajtur qëndrim konstruktiv, janë përmirësuar marrëdhëniet me vendet fqinje, falë edhe zbatimit të frytshëm të marrëveshjeve të tregtisë së lirë të përfunduara nën Memorandumin e Mirëkuptimit të Paktit të Stabilitetit për Liberalizimin dhe Lehtësimin e Tregtisë. Në fushën shumëpalëshe, raporti nënvizonte se Shqipëria vazhdonte të ishte anëtare aktive e Këshillit të Europës dhe OSBE dhe kishte kontribuar në nismat kyçe për bashkëpunimin në Europën Juglindore, por detyrimet ndërkombëtare nuk janë përmbushur në të gjitha rastet, për shkak të vështirësisë së përgjithshme të Shqipërisë në zbatimin dhe shtrëngimin e ligjeve.

Pjesa më poshtë jep një vlerësim të zhvillimeve politike në Shqipëri që nga raporti 2004, përfshi funksionimin e përgjithshëm të sistemit gjyqësor dhe ekzekutiv, shtetit të së drejtës, respektimit të të drejtave të njeriut dhe mbrojtjes së minoriteteve dhe çështjeve rajonale. Këto zhvillime janë të lidhura ngushtë me aftësinë e Shqipërisë për të vënë reformat në zbatim dhe arritjen e standardeve të kërkuara me qëllim progresin e mëtejshëm në procesin e Stabilizim-Asociimit drejt Bashkimit European.

1.1 Demokracia dhe shteti i së drejtës

Parlamenti

Kuvendi i Shqipërisë (parlament me një dhomë) ka 140 anëtarë: 100 zgjidhen drejtpërdrejt dhe 40 me përfaqësim proporcional. Partitë kryesore politike janë

Partia Demokratike e Shqipërisë dhe Partia Socialiste e Shqipërisë, me një numër partish të vogla që formojnë **aleanca me këto parti**.

Parlamenti ka qenë një forum i hapur për shkëmbimin e pikëpamjeve politike. Ndryshimet thelbësore në organizimin e brendshëm kanë përmirësuar funksionimin e tij dhe janë marrë hapa për të konsoliduar koherencën e ligjeve të reja, por klima politike konfliktuale vazhdoi të ngadalësojë progresin e reformave. Zgjedhjet parlamentare të verës 2005 ishin të gjata dhe shfaqën mangësi, por u mbajtën në një mënyrë përgjithësisht të shëndoshë.

Legjislatura që përfundoi në maj 2005, miratoi disa ligje të rëndësishme, si për shembull ligji për kthimin dhe kompensimin e pronave, amendimet e kodit zgjedhor dhe një paketë ligjesh për luftën kundër krimit të organizuar dhe terrorizmit. Kuvendi po merr një rol qendror në jetën politike të Shqipërisë dhe po shqyrton çështjet e ndërlikuara legjislative. Kuvendi miratoi një rregullore të re të brendshme për t'i bërë mekanizmat vendim-marrëse më efikase dhe transparente. Numri i komisioneve parlamentare të përhershme u zvogëlua nga 13 në 8 (përfshi Komisionin e Integritit Europian) dhe u prezantua një rregullore e re për drejtimin e seancave plenare. Transformimi i komisionit parlamentar *ad hoc*, në një komision me status të përhershëm duhet të bëjë të mundur që parlamenti të përqendrohet më me efikasitet në procesin e integritit europian. Raporti 2004 u shqyrtua nga parlamenti dhe u zhvilluan një sërë debatesh parlamentare për të diskutuar konstatimet e tij. Qeveria e përfshiu parlamentin edhe në procesin e hartimit të Planit Kombëtar të Veprimit, zbatimin e përparësive të Partneritet Europian, edhe pse ky dokument nuk iu nënshtrua miratimit zyrtar parlamentar.

Krijimi i Komisionit për Reformën Ligjore ka kontribuar në përmirësimin e cilësisë dhe transparencës të procesit legjislativ. Komisionit i është ngarkuar detyra që të sigurojë koherencën e ligjeve të reja me sistemin ligjor shqiptar dhe me kuadret ligjore europiane dhe ndërkombëtare, si dhe të propozojë dhe të vërë në zbatim mekanizma efikase që garantojnë nivelin e duhur të informimit publik dhe pjesëmarrjen¹⁰ në procesin legjislativ. Ministria e Drejtësisë ka ndërmarrë hapa për intensifikimin e trajnimit të hartuesve ligjore dhe të marrëdhënieve midis institucioneve të përfshira në procesin legjislativ dhe ka botuar një manual mbi teknikat e hartimit të ligjeve dhe procesin legjislativ.

Klima politike në parlament ka vazhduar të jetë problematike. Disa seanca plenare u mbajtën në atmosferë tejet konfrontuese, ku dy kampet kundërshtarë kanë qenë të paafta të tregojnë një predispozitë konstruktive bipartizane për sa i

takon ligjeve të rëndësishme. Pavarësisht nga intensifikimi i aktivitetit parlamentar, kjo atmosferë, në disa raste, rezultoi në ngadalësimin apo pengimin e nismave kyçe legislative.

Zgjedhjet parlamentare u zhvilluan në qershor-korrik 2005 mbi bazën e Kodit Zgjedhor të rishikuar së fundmi. Edhe pse u tejzgjatën dhe jo pa probleme, zgjedhjet u zhvilluan në përputhje me Kodin Zgjedhor dhe sipas parimeve themelore demokratike, duke çuar në transferim të butë të pushtetit. PD me aleatët e saj, fituan gjithsej 80 vende përkundrejt 60 vendeve të PS-së dhe partive të tjera, duke u siguruar PD-së dhe aleatëve një shumicë komode. Qeveria e drejtuar nga PD, e mori pushtetin në shtator 2005.

Misioni OSBE-ODIHR që monitoroi zgjedhjet raportoi se një sërë zhvillimesh pozitive karakterizuan procesin zgjedhor: u administrua në përputhje me kodin zgjedhor të përmirësuar dhe në një atmosferë përgjithësisht paqësore; kandiduan një spektër i gjerë partish dhe kandidatësh, duke u paraqitur votuesve një larmi zgjedhjesh, partitë u zotuan të respektonin Kodin e Etikës i cili ishte thelbësor në përcaktimin e standardeve të fushatës; mbulimi i medias ishte në përgjithësi i baraspeshuar; Komisioni Qendror Zgjedhor dhe Kolegji Zgjedhor përmbushën funksionet e tyre me transparencë dhe profesionalizëm. Megjithatë, OSBE/ODHIR konstatuan nevojën e adresimit të disa çështjeve, përfshi këtu problemet teknike dhe administrative, shqetësimet në lidhje me “votimin strategjik”, heqjen e të drejtës së votës një numri studentësh, mungesa e përmirësimit të pjesëmarrjes së femrave në çështjet publike dhe mbi të gjitha, nevojën për të përmirësuar më tej listat e votuesve.

Mangësitë e zgjedhjeve treguan nevojën për përmirësimin e mëtejshëm të ligjeve dhe praktikave zgjedhore si dhe nevojën urgjente për punë të mëtejshme në përmirësimin e regjistrimit civil. Por në mënyrë që të jenë efikase për t'i paraprirë zgjedhjeve të ardhshme (zgjedhjeve vendore që pritet të zhvillohen në vjeshtë 2006), reformat duhen zbatuar shumë më me intensitet sesa ato para zgjedhjeve parlamentare 2005. Legjislatura e re paraqet një mundësi për të konsoliduar progresin e konsiderueshëm në lidhje me procedurën parlamentare, dhe çka është më e rëndësishme, për të arritur progres të mëtejshëm në çuarjen përpara të reformave.

Qeveria

Pas një periudhe të paqëndrueshme për shkak të grindjeve të brendshme të PS, ish-partisë në pushtet, qeveria pati një periudhë stabiliteti politik. U vunë në zbatim disa strategji dhe sisteme të reja të planifikimit të burimeve dhe u rrit efikasiteti i Ministrisë së Integrimit European, por qeveria nuk përfitoi sa duhet nga ky stabilitet për të çuar përpara çështjet e reformave. Fushata zgjedhore 2005 dhe polarizimi politik që e pasoi, konsumuan një masë të madhe të energjive të qeverisë dhe ngadalësuan progresin e reformave.

Qeveria miratoi një sërë strategjish të reja, përfshi Strategjinë Kombëtare për Zhvillimin Ekonomik dhe Social, Planin e Veprimit për Zbatimin e Përparësive të Partneritetit European dhe Planin Kombëtar për përafrimin e Legjislacionit. Qeveria lançoi Sistemin e Integruar të Planifikimit dhe hartoi mjaft ligje të reja. Qeveria gjithashtu ngriti një Komision Ndërmintoror për Zhvillimin e Teknologjive të Informacionit i cili, midis të tjerave, do të përcaktojë standardet e përbashkëta për aplikimet IT në administratën publike dhe në këtë mënyrë të përmirësojë bashkërendimin ndërministror. Qeveria e re tashmë përballet me detyrën e zbatimit siç duhet të këtyre strategjive dhe kjo të bëhet në mënyrë të bashkërenduar. Në të kaluarën, këto kanë rezultuar aspektet më problematike të nismave për reforma në Shqipëri, prandaj kërkohet vullneti i vendosur politik për të garantuar që këto nisma të përkthehen në progres konkret në sfidat e reformave kyçe.

Ngritja e një Ministrie Integrimi dhe vendimi i mëvonshëm qeveritar për të qartësuar kompetencat e ministrisë, i dhanë këtij organi një rol qendror në procesin e integrimit të Shqipërisë në BE. Që atëherë, Ministria e Integrimit European ka vazhduar të drejtojë dhe të bashkërendojë aktivitetet lidhur me integrimin european. Ministria pësoi reformim të brendshëm, me krijimin e departamenteve të reja si ato për përafrimin e legjislacionit, analizën dhe përkthimin. Pavarësisht nga këto arritje, më shumë përpjekje duhen bërë për t'i mundësuar ministrisë që të përballojë kërkesën gjithnjë e në rritje për drejtim dhe bashkërendim midis departamenteve. Ministrisë akoma nuk ia janë siguruar ambientet, personeli dhe logjistika ë i duhet për të përmbushur detyrat e saj me efikasitet. Personeli i rekrutuar së fundmi janë përgjithësisht të përkushtuar dhe me standarde të larta profesionale, por numri i kufizuar i punonjësve pengon kapacitetet e ministrisë që të ndër marrë mundësi trajnimi.

Qeveria e re që mori pushtetin në 2005, e reduktoi numrin e ministrive të linjës nga 14 në 14 (duke shkrirë Ministrinë e Rendit Publik dhe Pushtetit Vendor për

të formuar një ministri më të re dhe më të fuqishme, Ministrinë e Brendshme; duke zgjeruar Ministrinë e Industrisë dhe Energjisë në Ministrinë e re të Ekonomisë, Industrisë dhe Energjetikës; ish-sektorët e ndarë të turizmit dhe kulturës u bashkuan në Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve).

Shqipëria ka bërë përparime të rëndësishme në menaxhimin e ndihmës së donatorëve. Në mënyrë që të krijojë një strategji të vetme për menaxhimin e asistencës me një pikë të vetme kontakti me donatorët, Këshilli i Ministrave lançoi Sistemin e Planifikimit të Integruar. Ky sistem synonte të bashkërendojë burimet investuese kombëtare dhe të asistencës rreth një strategjie buxhetore të integruar dhe të ndarë me përparësi, që përqendrohej fuqimisht në agjendën e integritit Europian dhe është një linjë me mundësitë afat-mesme ekonomike. Sistemi gjithashtu synonte të mbulonte tërë ciklin e menaxhimit të asistencës, nga strategjia, planifikimi zbatimi dhe monitorimi, deri tek vlerësimi, kështu duke integruar një numër funksionesh aktualisht të ndara midis ministrive të ndryshme. Sistemi i Planifikimit të Integruar ka për qëllim t'i mundësojë qeverisë që të kanalizojë shpenzimet sipas nevojave që kërkon progresi i integritit europian, zhvillimit ekonomik dhe social dhe disa objektivave të tjerë, por që për të qenë efikas, kërkon angazhim të konsiderueshëm politik

Administrata publike

Shqipëria ka bërë progres në përmirësimin e vlerësimit, rekrutimit dhe trajnimit të shërbimit civil dhe ka marrë masa për të përforcuar kuadrin ligjor. Nevojiten akoma përpjekje të konsiderueshme për të pakësuar emërimet politike në nivelet drejtuese, përmirësimin e rrogave, strukturat e karrierës dhe prezantimin e një menaxhimi të performancës për të rritur efikasitetin e administratës publike.

Shqipëria ka marrë masa për ta konsoliduar administratën publike. Amendimet e propozuara për ligjin mbi Shërbimin Civil (që garanton një kuadër ligjor të përgjithshëm për shërbimin civil me parime të përbashkëta për të gjithë nëpunësit civilë) u miratuan nga Këshilli i Ministrave në mars 2005 në mënyrë që qeverisjet vendore dhe prefektura – organe të pambuluara më parë – të përfshiheshin në këtë ligj. Amendimet parashikojnë edhe përmirësimin e rekrutimeve dhe mbajtjen e nëpunësve civil brenda administratës publike. Këto amendime pritet të miratohen nga parlamenti.

Departamenti i Administratës Publike ka ndërmarrë disa hapa për ta bërë më transparent procesin e rekrutimit të nëpunësve civilë. Ajo ka botuar në faqen e

saj të internetit vendet e lira dhe rezultatet e konkurseve të hapura dhe ka hartuar një manual rekrutimi për komisionet rekrutuese *ad hoc* me qëllim që të ulë ndërhyrjet politike. Edhe pse gradualisht po pranohen praktikat e rekrutimit të hapur në shërbimin civil, vonesat dhe mosefiçenca në rekrutim mund të shkaktojë mungesë personeli në fusha kyçe (si në administratën e drejtësisë). Disa nga mangësitë e amendimeve të planifikuara për ligjin e Shërbimit Civil, janë reduktimi i periudhës së apelimit për emërimet dhe kontradiktat e mundshme me Kodin e Procedurës Administrative.

Numri i nëpunësve civilë të trajnuar nga Instituti Trajnues i Administratës Publike (TIPA) rritet çdo vit. TIPA ka bërë përpjekje të mëdha për përmirësimin e komunikimeve të jashtme dhe për të punuar më ngushtë me pushtetin vendor. Është në zbatim një nismë e përbashkët e Ministrisë së Integrimit Europian, Departamentit të Administratës Publike dhe TIPA-s për të siguruar trajnime për çështjet e BE-së. TIPA ka ngritur një Qendër për Trajnimin Fiskal për të trajnuar punonjësit e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave. Megjithatë, trajnimi i nëpunësve civilë mbetet i pamjaftueshëm: ministër duhet të jenë më të përgjegjshme për të përcaktuar nevojat trajnuese dhe realizimin e tyre. Duhet kuptuar më qartë menaxhimi i trajnimeve që duhet të bëjnë të gjithë nëpunësit civilë në mënyrë që të kryejnë më me efikasitet punën e tyre dhe kërkohet angazhim më i lartë nga ana e Sekretariatit të Përgjithshëm, në bashkëpunim me departamentet e burimeve njerëzore të ministrive. Komisioni i Shërbimit Civil, përgjegjës për aplikimin e duhur të ligjeve mbi shërbimin civil, tashmë ka filluar të punojë më me efikasitet. Veçanërisht roli i inspektorëve po përcaktohet më qartë dhe aktivitetet e tyre po përqendrohen më mirë në menaxhimin e shërbimit civil.

Shërbimi civil shqiptar vazhdon të pengohet edhe nga moskuptimi i nevojës, ose vullneti për të zbatuar një ndarje të vërtetë midis niveleve politike dhe administrative. Emërimet politike, deri në nivelin e Drejtorit si në shumicën e ministrive të linjës, janë bërë normë. Veçanërisht emërimi i Sekretarëve të Përgjithshëm mbetet politik dhe për këtë arsye, roli i Sekretarëve të Përgjithshëm – që është shndërrimi i ideve në politika, menaxhimi eficient i personelit për të siguruar ekzekutim efikas të politikave dhe çuarjen e shërbimeve në destinacion – po komprometohet rëndë. Ministrat janë shumë të përkushtuar në punët e përditshme të ministrisë dhe nuk kanë vullnetin që t’ua lënë këto detyra nëpunësve civile të përhershëm.

Perspektiva për karrierë në shërbimin civil dhe shërbimin publik, mbetet akoma e vakët. Numri i vogël dhe piramidat e ngushta të niveleve brenda shërbimit

civil e bëjnë shumë të vështirë krijimin e një sistemi karriere në shërbimin qendror civil, por në sektorin e gjerë publik mund të ketë më tepër mundësi për prezantimin e sistemeve të karrierës dhe planifikimin e karrierës që synojnë të thithin personelin më të talentuar dhe më të motivuar.

Aktualisht po rishikohet sistemi i rrogave, me qëllimin e përmirësimit të mundshëm. Nivelet e rrogave dhe shpërblimeve janë tejet të variueshme në shërbimin civil dhe në sektorin publik më në përgjithësi. Nuk ka një kuadër ligjor për sistemet e bonuseve, duke e bërë të pamundur buxhetimin e kostove nga ana e Ministrisë së Financave. Mungesa e sindikata efektive të shërbimit civil ka kontribuar në një situatë ku, me kalimin e kohës, rrogat janë bërë tejet të diferencuara, ku Qeveria ka favorizuar grupe të ndryshme të nëpunësve publikë, ose ku disa titullarë institucionesh janë të aftë të nxisin rastet e trajtimeve preferenciale.

Çështja e menaxhimit të performancës nuk është përballuar mjaftueshëm. Vënia në zbatim e menaxhimit të orientuar në rezultate me objektiva të qartë, do të përbënin një dallim thelbësor në efikasitetin e shërbimit civil. Pikësëpari, duhet të bëhet normë monitorimi i performancës së nëpunësve civilë.

Gjatë vitit 2004, zyra e Avokatit të Popullit (Ombudsman) ka shqyrtuar 3 840 ankesa, nga të cilat afërsisht gjysma dilnin jashtë kompetencave të kësaj zyre. Gjysma e çështjeve të pranuar u mbyllën në favor të paditësit. Ankesat më të zakonshme të shqyrtuara nga kjo zyrë kishin të bënin me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore, vendime të pushtetit vendor dhe çështje të lidhura me sigurimet shoqërore. Falë bashkëpunimit me median dhe OJQ-të, është rritur ndërgjegjësimi publik për funksionet e kësaj zyre, por më tepër përpjekje duhen ndërmarrë për t'i dhënë zyrës peshë më të madhe në marrëdhëniet me institucionet publike.

Sistemi gjyqësor

Struktura gjyqësore e Shqipërisë përbëhet nga Gjykata Kushtetuese, një Gjykatë e Lartë, 6 gjykata apeli civile dhe 29 gjykata rrethi. Secili nivel merret me çështje civile, tregtare dhe administrative. Këshilli i Lartë i Drejtësisë i jep propozime Presidentit për emërimin, transferimin dhe shkarkimin e gjyqtarëve dhe merret me disiplinën gjyqësore.

Shqipëria ka bërë njëfarë progresi në përmirësimin e funksionimit të sistemit gjyqësor, për sa i takon organizimit dhe transparencës, në funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, në zhvillimin e mjeteve legislative për drejtësinë penale dhe për të miturit si dhe në lidhje me trajnimin. Sidoqoftë, zbatimi i drejtësisë penale mbetet e i dobët; duhet të sigurohet pavarësia e gjyqësorit; të ekzekutohen vendimet dhe të rritet transparenca që vazhdon të jetë e ulët. Rrogat më të larta mund të përmirësojnë efikasitetin e personelit gjyqësor dhe kërkohet përmirësim i infrastrukturës.

Komisioni i Reformës Ligjore, një organizëm këshillues i krijuar nga Ministri i Drejtësisë, ka përgatitur një studim mbi riorganizimin e Gjykatës së Shkallës së Parë për të përmirësuar efikasitetin e sistemit gjyqësor. Ky vlerësim bazohet mbi elemente si mbulimi gjeografik, përqindja e popullsisë, ngarkesa e punës dhe nevoja për emërim të reja.

Njëfarë progresi është bërë në përmirësimin e mënyrës se si sistemi gjyqësor adreson drejtësinë kriminale, me një “paketë anti-mafia” që prezantoi mjete të reja ligjore për të lehtësuar kapjen e financave të krimit dhe zvogëlimin e fushës së kompetencës materiale të Gjykatës së Krimeve të Rënda, duke e përqendruar atë në shkeljes e lidhura me krimin e organizuar. Bashkëpunimi gjyqësor rajonal për luftën kundër krimit të organizuar është përforcuar nga nënshkrimi i memorandumit të bashkëpunimit ndërmjet Prokurorëve të Përgjithshëm të rajonit të Ballkanit Perëndimor dhe prokurorët kanë përfituar trajnime në nivel rajonal për krimet financiare, mjetet speciale hetuese dhe mbrojtjen e dëshmitarit. Kujdes duhet treguar për zhvillimin e mëtejshëm të kuadrit ligjor¹⁴ për mbrojtjen e dëshmitarit, në mënyrë të tillë që siguria për dëshmitarët e brishtë të jetë e baraspeshuar siç duhet nga e drejta e të akuzuarit për t’u mbrojtur.

Pavarësisht nga disa zhvillime pozitive, zbatimi i përshtatshëm i kuadrit ligjor ekzistues dhe funksioni efikas i sistemit gjyqësor në përgjithësi mbeten një çështje shqetësuese. Nevojiten akoma përpjekje për të siguruar akses të plotë të gjithë qytetarëve në gjykata dhe të rrisin besimin popullor te gjyqësori. Gjithashtu duhet të forcohet bashkëpunimi midis prokurorëve dhe policisë dhe kontrolli aktiv dhe i qëndrueshëm i hetimit nga ana e prokurorëve. Duhet të përmirësohen procedurat ekzekutuese në çështjet civile, tregtare dhe administrative, për të sjellë shkallën e ekzekutimeve të vendimeve gjyqësore në Shqipëri më pranë standardeve të BE-së, veçanërisht në çështje ku shteti është palë humbëse. Megjithëse shkalla e ekzekutimit të vendimeve ka shfaqur një kurbë pozitive – (gjatë 2004, u ekzekutuan 6 050 nga një total prej 13 329 vendimesh (45%))

krahasuar me 4 865 nga një total prej 14 917 (33%) në 2003) – mbetet vend i konsiderueshëm për përmirësime të mëtejshme.

Ekzistenca e dy shërbimeve paralele inspektuese për gjyqësorin, një për Këshillin e Lartë të Drejtësisë dhe një tjetër për Ministrinë e Drejtësisë, pa një ndarje të qartë të kompetencave dhe përgjegjësi midis tyre, duhet të adresohet si një çështje urgjente. Kompetenca e inspektoratit të Ministrisë së Drejtësisë duhet të kufizohet në çështje tërësisht administrative në mënyrë që të shmanget perceptimi i tij si një kërcënim për pavarësinë e gjyqësorit. Ndërkohë, mbetet e diskutueshme nëse a duhet që inspektorati gjyqësor të ekzistojë brenda Ministrisë së Drejtësisë, duke pasur parasysh që në Shqipëri është më shumë Zyra për Administrimin e Buxhetit Gjyqësor (një organizëm autonom i gjyqësorit) sesa Ministria e Drejtësisë e cila është përgjegjëse për administrimin e buxhetit të gjyqësorit. Në Shqipëri, Ministri i Drejtësisë është mbi Këshillin e Lartë të Drejtësisë dhe edhe pse ministri nuk ka të drejtë vonë në procedura disiplinore kundër gjyqtarëve, ai ka plotfuqinë që të fillojë këto procedura. Në këtë kontekst, parimi i pavarësisë gjyqësore duhet të respektohet.

Pak progres është bërë në konsolidimin e statusit dhe *pavarësisë* së gjyqtarëve. Këshilli i Lartë i Drejtësisë ka miratuar një numër rregulloresh me objektiv garantimin e efikasitetit dhe transparencës në procedurat e brendshme vendimmarrëse. Progres është bërë në përkufizimin e parimeve dhe rregullave të reja për *vlerësimin e performancës profesionale* të gjyqtarëve në bazën e sistemi të drejtë të zhvillimit të karrierës. Gjithashtu, rregullat objektive për ngarkimin transparent të çështjeve për gjyqtarëve, mbeten për t'u vendosur. Legjislacioni ekzistues për vlerësimin e punës së prokurorëve akoma nuk po zbatohet plotësisht dhe mbetet për t'u zhvilluar një sistem vlerësimi më transparent dhe i bazuar në merita.

Shkolla e Magjistraturës i ka konsoliduar kapacitetet për të planifikuar dhe organizuar *trajnim* fillestar dhe të vazhduar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, me amendime në ligjin që rregullon fushën e saj të veprimit. Edhe pse janë ngritur shqetësime për autonominë e Shkollës, veçanërisht në lidhje me menaxhimin e buxhetit, amendimet paraqesin disa ndryshime pozitive, siç është trajnimi i detyrueshëm në shërbim aktiv i gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe për këtë trajnim në Këshillin e Lartë merret në konsideratë vlerësimi i performancës profesionale të gjyqtarëve. Shkolla ka miratuar një strategji afatgjatë që t'i sigurojë qëndrueshmërinë e ardhshme dhe buxheti i Shkollës është rritur. Sidoqoftë, duke ditur që financimet me donacione nuk do të jenë pafundësisht, hapa të mëtejshëm kërkohen për të siguruar qëndrueshmërinë e saj financiare. Gjatë

periudhës raportuese, të diplomuarve nga Shkolla e Magjistraturës iu ofruan pozicione si gjyqtarë dhe prokurorë, duke konsoliduar Shkollën si moduli i lartë i rekrutimit të profesionistëve. Progres është bërë edhe në lidhje me trajnimin për profesionin ligjor në Fakultetet e Drejtësisë, të cilat janë rishikuar kurrikulumet me qëllim që t'i përafrojnë me parimet e Bolonjës. Një memorandum mirëkuptimi u nënshkrua ndërmjet ¹⁵ Ministrisë së Drejtësisë dhe Shkollës së Magjistraturës për ngritjen e një programi trajnues gjithëpërfshirës për administratorët e gjykatës në Shkollë.

Qeveria ka treguar interesim të ndjeshëm në përmirësimin e sistemit gjyqësor për të miturit. Është ndërmarrë punë e gjerë përgatitore për përmirësimin e kuadrit ligjor me konsultimet e ngushta me UNICEF dhe Komisionin European.

Infrastruktura gjyqësore në Shqipëri mbetet e mangët. Është hartuar një Plan Veprimi për Infrastrukturën Gjyqësore, por mbështetja e deklaruar politike e autoriteteve shqiptare për përfundimin fizik të gjykatave, nuk është shoqëruar akoma me dhënien e burimeve të nevojshme nga buxheti shtetëror. Përmirësimi i informimit të publikut për vendimet e gjykatave të shkallës së parë dhe apelit (botohen rregullisht vendimet e Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë) dhe shërbimet e administratës gjyqësore dhe tarifatat dhe procedurat përkatëse do të ndihmonin në rritjen e besimit të qytetarëve shqiptarë në sistemin gjyqësor.

Administrata e drejtësisë vazhdon të pengohet nga statusi i ulët dhe niveli i rrogave të *personelit gjyqësor* si për shembull administratorët e gjykatës dhe gjyqësorit. Me përjashtim të gjyqtarëve, personeli gjyqësor nuk kanë status nëpunësi civil dhe rrogat e tyre janë sistematikisht më të ulëta se të atyre me rang ekuivalent në ministrinë qeveritare. Shpërblimi më i mirë dhe siguria e vendit të punës do të rrisnin motivimin e personelit dhe do ta bënin sistemin gjyqësor më pak të brishtë ndaj korrupsionit. Efikasiteti i gjyqësorit mund të përmirësohet duke përcaktuar më qartë dhe më me transparencë rolin e kategorive të ndryshme të administratorëve gjyqësorë dhe kualifikimet e kërkuara prej secilit.

Edhe pse ligji për Noteritë u amendua në 2005, legjislacioni zbatues nuk është miratuar akoma. Nuk ekzistojnë mekanizma efikasë të brendshëm për të garantuar vënien në zbatim të Kodit të Etikës së Avokatëve të Dhomës Kombëtare të Avokatisë.

Politika anti-korrupsion

Disa përpjekje janë bërë në luftën kundër korrupsionit, me punën e Grupit Monitorues Anti-Korrupsion (GMAK) dhe pjesëmarrja në Këshillin e Grupit të Shteteve Europiane kundër Korrupsionit (GRECO), ligjet e reja për konfliktin e interesit, dhe shtimi i çështjeve gjyqësore për korrupsion kundër zyrtarëve publikë, veprimi i vendosur kundër korrupsionit policor dhe ratifikimi i një sërë konventash anti-korrupsion. Megjithatë, korrupsioni ngelet problem serioz. Ka mangësi në zbatimin, ekzekutimin dhe bashkërendimin e përpjekjeve dhe perceptimet ndërkombëtare të Shqipërisë në këtë aspekt janë të dobëta. Pavarësisht nga përpjekjet e Shqipërisë dhe mbështetja aktive e komunitetit ndërkombëtar në përkrahje të strategjisë shqiptare anti-korrupsion, rezultatet domethënëse në luftën kundër korrupsionit mbeten të kufizuara.

Shqipëria ratifikoi Konventën e Ligjit Civil për Korrupsionin dhe Konventën e Ligjit Penal për Korrupsionin në 2001 dhe nënshkroi Konventën Anti-korrupsion të OKB-së në dhjetor 2003. Në 2002, Shqipëria ratifikoi Konventën e OKB-së kundër Krimin të Organizuar Trans-kombëtar (Konventa e Palermos), e cila përmban disa dispozita në lidhje me korrupsionin. Vënia në zbatim e këtyre konventave kërkon ligje të reja, zhvillimi i të cilave, me përjashtim të aspekteve për krimin e organizuar, vazhdon të jetë i ngadaltë. Shqipëria nuk është shtet nënshkrues i Konventës OECD kundër Mitmarrjes së zyrtarë të Huaj Publikë 16 në Transaksionet e Biznesit Ndërkombëtar. Kodi penal shqiptar e cilëson mitmarrjen si krim, por Shqipëria nuk ka ligje specifike për mitmarrjen nga ana e zyrtarëve të huaj.

Megjithëse kalimi i Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në ushtrimin e Funksioneve Publike ishte një hap pozitiv, ligji përfshin deputetët, gjyqësorin, nëpunësit civilë dhe publikë dhe nuk është i përshtatshëm sa duhet për llojet e ndryshme të konflikteve të mundshme të interesit që kërkojnë zgjidhje. Këto janë gjithashtu shqetësime që ligji i ri publikon si Ligjin e Shërbimit Civil, por edhe Ligjin ekzistues për Rregullat e Etikës në Administratën Publike. Këshilli i Ministrave ka miratuar edhe një vendim për aktivitetet e jashtme dhe dhuratat për nëpunësit civilë. Nisur nga fakti që ministritë individuale të linjës janë përgjegjëse për hartimin e legjislacionit dytësor, kërkohet bashkërendim ndërministror më i fortë për të shmangur konfuzionin dhe kontradiktat. Për më tepër, autoriteti përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit, Inspektorati i Lartë për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive, ka nevojë për një rritje të ndjeshme të personelit për të qenë efikas në këtë rol. Përveç kësaj, rregullat dhe

procedurat përmes të cilave policia dhe prokurorët sigurojnë akses në informacionet për pasuritë e zotëruara nga të dyshuarit, nuk janë të qarta sa duhet.

Qeveria ka vazhduar të mbështesë kuadrin institucional dhe legjislativ në luftën kundër korrupsionit. Për sa i takon kuadrin institucional, GMAK, një organizëm i përhershëm në varësinë e Këshillit të Ministrave, vazhdon punën e vet në raportimin dhe monitorimin e masave anti-korrupsion. Nevojiten përmirësime të mëtejshme, pasi ministrinë e linjës kanë shfaqur pak interesim për të marrë pjesë në takimet e GMAK-së dhe disa pjesëmarrës nuk kanë qenë të përgatitur mjaftueshëm. Duhet përmirësuar përcimi i informacionit mbi masat anti-korrupsion të zbatuara nga ministrinë e linjës, dhe mbrojtja e ofruar nga imuniteti duhet të përdoret vetëm në përputhje me rregullat dhe praktikën ndërkombëtare. Zbatimi i Planit të Veprimit për Parandalimin dhe Luftën kundër Korrupsionit duhet të intensifikohet dhe të përmbajë hapa realistë, precizë dhe të matshëm. Për më tepër, Plani ka shtrirje të kufizuar përtej administratës publike qendrore. Edhe nivelet të tjera të autoritetit publik duhet të përfshihen në luftën kundër korrupsionit, mundësisht duke zgjeruar fushën e veprimit të Planit në mënyrë që të adresojë më me efikasitet korrupsionin vendor dhe rajonal.

Janë siguruar rregullisht kurse nga Instituti Trajnues i Administratës Publike në bashkëpunim me GMAK për trajnimin e nëpunësve civilë, në nivel qendror dhe vendor, mbi etikën dhe anti-korrupsionin.

Është rritur numri i zyrtarëve publikë të ndjekur penalisht për korrupsion: 171 në 2004, më shumë krahasuar me 76 në 2003 dhe 58 në 2002. Progres i ndjeshëm është arritur edhe në luftën kundër korrupsionit në polici, pas linçimit në fillimin e 2004-ës të nismës “Urdhër brenda Urdhrit” në Ministrinë e Rendit Publik. Nisur nga lidhja më e ngushtë midis korrupsionit dhe krimit të organizuar, “paketa anti-mafia” e tetorit 2004 do të ndihmojë në aspektin afatmesëm për lehtësimin e disa aspekteve të korrupsionit.

Në kuadrin e GRECO-s, Shqipëria ka miratuar një Raport Pajtimi për rekomandimet e Raportit Vlerësues të Raundit të Parë (dhjetor 2002) për Shqipërinë. Raporti njohu progresin e bërë nga Shqipëria në zbatimin e disa prej rekomandimeve për sa i takon strategjisë anti-korrupsion, financave të krimit dhe kodet e etikës për grupet e brishta përballë korrupsionit, por gjithashtu nënvizoi se duhen ndërmarrë më tepër përpjekje për të përmirësuar transparencën e autoriteteve publike përballë medias dhe publikut, për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave mbi korrupsionin nga të gjitha

institucionet qendrore qeveritare, për rritjen e autonomisë së policisë dhe Agjencisë së Prokurimit Publik, për forcimin e zyrës së Avokatit të Popullit (Ombudsmanit) dhe që Auditori Shtetëror të paraqesë fushën e veprimit dhe argumentimin e aktiviteteve të planifikuara në fillimin e çdo viti fiskal. Raporti pas raundit të dytë vlerësues të GREKO-s bëri një sërë rekomandimesh shtesë, ku kërkoheshin përmirësime në lidhje me evidentimin dhe bllokimin e aseteve, për zyrtarët publikë që kalojnë në sektorin privat, presionet politike, si dhe trajnime si për autoritetet tatimore ashtu edhe për llogaritarët privatë dhe audituesit.

1.2 Të drejtat e njeriut dhe mbrojtja e minoriteteve

Respektimi i ligjit ndërkombëtar për të drejtat e njeriut

Shqipëria ka ratifikuar një sërë konventash të OKB-së për të drejtat e njeriut, përfshi Marrëveshjen Ndërkombëtare për Të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, si dhe Marrëveshja Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike në 1991; Konventën për të Drejtën e Fëmijëve dhe Konventën për Statusin e Refugjatëve në 1992; Konventën Ndërkombëtare për Eliminimin e Të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor dhe Konventën për Eliminimin e Të Gjitha Formave të Diskriminimit Kundër Grave në 1994. për sa i takon instrumenteve rajonale, Shqipëria ka ratifikuar Konventën Europiane për Mbrojtjen e Të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (EHCR) dhe disa Protokolle të saj, si dhe Konventën Europiane për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimin apo Ndëshkimit Çnjerëzor dhe Degradues në 1996. Në periudhën raportuese, Shqipëria ratifikoi Protokollin 12 të EHCR në lidhje me ndalimin e përgjithshëm të diskriminimit dhe nënshkroi Protokollin 14 që amendon sistemin kontrollues të Konventës.

Qëkur Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut u bë gjykatë me kohë të plotë në nëntor 1998, ka dhënë dy gjykime në lidhje me Shqipërinë. Në rastin e parë, Gjykata konstatoi se vonesa në ekzekutimin e vendimit të Gjykatës së Apelit anonte Nenin 6.1 të Konventës Europiane për Të Drejtat e Njeriut (e drejta për gjyq të drejtë). Në çështjen tjetër, nuk u konstatua asnjë shkelje. Shqipëria e ka ekzekutuar vendimin e ECHR-së përmes një vendimi individual të Këshillit të Ministrave, por kodeve civile dhe penale të Shqipërisë aktualisht u mungojnë dispozitat specifike për t'i dhënë sistematikisht status ligjor vendimeve të ECHR.

Për sa i takon mbrojtjes së të dhënave personale, Konventës për Mbrojtjen e Individëve mbi Përpunimin Automatik të Të Dhënave Personale dhe protokollin i saj shtesë në lidhje me autoritetet mbikëqyrëse dhe vërshimin ndërkufitar të të dhënave (ETS nr. 181) u ratifikuan dhe hynë në fuqi në Shqipëri në qershor 2005. Sidoqoftë, akoma mungon një autoritet i pavarur për mbrojtjen e të dhënave dhe me kompetenca të mjaftueshme mbi sektorët publikë dhe privatë dhe me mjete të mjaftueshme. Për këtë arsye, përbën shqetësim moszbatimi i duhur i rregullave për mbrojtjen e të dhënave.

Të drejtat civile dhe politike

Ligji shqiptar garanton të drejtat njerëzore dhe liritë themelore dhe qeveria në përgjithësi mbikëqyr respektimin e tyre. Shqipëria gjithashtu ka ratifikuar një numër konventash ndërkombëtare në këtë fushë. Probleme ndeshen akoma në fusha specifike, siç është përdorimi i forcës së tepruar nga ana e policisë, mosekzekutimi i vendimeve të formës së prerë të gjykatave dhe në lidhje me burgjet, mjediset e paraburgimit dhe ndërhyrja në media e lobeve politike dhe financiare.

Në vitin 2000, Shqipëria ratifikoi Protokollin 6 të Konventës Europiane për Të Drejtat e Njeriut (ECHR), duke shfuqizuar dënimin me vdekje për shkeljet në kohë paqeje dhe në 2003 nënshkroi Protokollin 13 për shfuqizimin e dënimit kapital në të gjitha rrethanat.

Në fushën e *torturës dhe keqtrajtimit*, kuadri legjislativ shqiptar është përgjithësisht në linjë me standardet ndërkombëtare, megjithëse nenet 86 dhe 87 të Kodit Penal Shqiptar akoma nuk janë në përputhje me përkufizimin e torturës sipas Konventës së OKB-së kundër Torturës. Janë trajnuar efektivet policorë të të gjitha niveleve për të drejtat e njeriut, por efekti i trajnimeve është i kufizuar – sipas shifrave të “Amnesty International” raportohen mesatarisht në vit 35 incidente torture apo keqtrajtimi. Shqipëria duhet të bëjë përpjekje më të mëdha për të siguruar zbatim të rreptë të ligjit, duke ndëshkuar siç duhet shkelësit sipas shkallës së krimeve të tyre. Shqipëria duhet gjithashtu të rrisë ndërgjegjësimin mbi të drejtat e njeriut duke trajnuar gjyqtarët dhe prokurorët për ndalimin e torturës dhe t’u japë viktimave dëmshpërblim efikas, përfshi këtu edhe kompensim.

Pavarësisht nga përpjekjet e qeverisë për të përmirësuar *kushtet për të burgosurit*, për shembull përmes ligjit të ri mbi kontrollin e brendshëm në burgje dhe

mendimeve të ligjit mbi shoqërimin e të burgosurve dhe përmes miratimit të kodit të etikës për sistemin penitenciar, kushtet brenda burgjeve dhe qendrave të paraburgimit mbeten të ulëta. Mbipopullimi, kushtet e këqija higjienike, kontrollet mjekësore dhe trajtimet e papërshtatshme; vazhdon të mbetet serioz problemi i standardeve të ulëta të profesionizmit të personelit të burgjeve. Transferimi i pjesshëm i përgjegjësisë mbi qendrat e paraburgimit nga Ministria e Rendit Publik tek Ministria e Drejtësisë, ka ndihmuar në lehtësimin e problemit të individëve të dënuar që vazhdojnë të shlyejnë dënimin në paraburgim, por afërsisht 200 të burgosur të dënuar mbeten në mjedise të tilla. Për më tepër, të miturit jo gjithmonë mbahen veçmas nga të rriturit në mjediset e paraburgimit, në kundërshtim me ligjin shqiptar dhe standardet ndërkombëtare. Paraburgimi i tejzgjatur si rezultat i hetimeve të gjata vazhdon të jetë problem serioz.

Burimet që merren me menaxhimin e burgjeve mbeten të pamjaftueshme. Sidoqoftë, janë marrë disa masa për të përmirësuar aspektet legjislative, institucionale, organizative dhe infrastrukturore të sistemit penitenciar, përfshi për të miturit. Për sa i takon legjislacionin, Ministri i Drejtësisë ngarkoi një grup pune për hartimin e një plani për të ngritur sistemin penitenciar në përputhje me standardet evropiane dhe legjislacionin e brendshëm përkatës, konkretisht me Ligjin për Të Drejtat e Trajtimet të Të Burgosurve, Ligji për Ekzekutimin e Vendimeve Gjyqësore dhe Rregulloren Standard të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve. Si rezultat, janë vënë në zbatim një sërë ligjesh dhe rregulloresh siç është kodi i etikës për sistemin e burgjeve dhe ligji për policinë e burgjeve.

Në lidhje me organizimin penitenciar, disa ndryshime kanë ndodhur, përfshi miratimin e një strukture të re të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe disa modifikime në klasifikimin e ambienteve të paraburgimit dhe penitenciare. Këto ndryshime organizative janë shoqëruar me transferimet e personelit policor të burgjeve dhe akordimin e mjeteve, megjithatë mbeten të pamjaftueshme burimet njerëzore dhe materiale të instancave të burgjeve.

Burgje të reja janë hapur në Peqin dhe Lezhë dhe ndërtesa të tjera janë rinovuar dhe kapaciteti i tyre është zgjeruar. Pavarësisht nga këto përmirësime, shumica e këtyre masave u financuan nga donatorët e huaj dhe nevojat infrastrukturore të sektorit penitenciar janë shumë më të mëdha si për burgjet ashtu edhe për qendrat e paraburgimit, ku mbipopullimi dhe kushtet e këqija janë një problem serioz. Edhe pse janë planifikuar disa ndërtime të infrastrukturës së burgjeve me fondet e donatorëve, qeveria duhet të akordojë fondet e mjaftueshme përmes një strategjie investuese afatgjatë që parashikohet në kuadrin e saj të shpenzimeve.

Më pak se 100 të mitur mbahen aktualisht në paraburgim në Shqipëri. Të miturit e dënuar (më pak se 1/3 e totalit) mbahen në qendrat e paraburgimit për të miturit në Vaqarr pranë Tiranës, ku ka një program aktivitësh dhe të burgosurit mund të ndjekin arsimin e mesëm, por 2/3 e të burgosurve të mitur janë në pritje të gjykimit dhe mbahen në paraburgimet e Tiranës, Vlorës dhe zona të tjera urbane, ku ka probleme serioze të mbipopullimit dhe kushteve të këqija të jetesës.

Ministria e Drejtësisë ka vendosur të ngrejë në Pogradec një qendër të re paraburgimi për të miturit me kapacitet 85 vetë për të zëvendësuar ndërtesën ekzistuese në Vaqarr. Në kundërshtim me standardet ndërkombëtare në këtë fushë (konkretisht Rregullat e OKB-së për Mbrojtjen e Të Miturve të Privuar nga Liria), përmasat dhe vendndodhja e izoluar e qendrës së re të planifikuar, do ta bëjnë të vështirë trajtimin e individualizuar dhe do të pengojë mundësinë e familjeve për të vizituar rregullisht fëmijët, çka mund të ketë një ndikim negativ në rehabilitimin e tyre.

Për sa i takon *aksesit në drejtësi*, legjislacioni shqiptar garanton *mbrojtje ligjore falas* për të pandehurit që nuk kanë mundësi për avokat privat, por ky shërbim jo gjithmonë ofron asistencë ligjore të përshtatshme dhe në kohë.

Sipas Kushtetutës, nuk ka një fe zyrtare dhe të gjitha fetë janë të barabarta. Qeveria respekton *lirinë e besimit* dhe marrëdhëniet midis grupeve të ndryshme fetare janë përgjithësisht miqësore. Shqipëria vazhdon të tregojë një shembull të çmuar të harmonisë fetare në rajon.

Liria e shprehjes dhe e shtypit garantohet me kushtetutë në Shqipëri. Ka një numër të gjerë mediesh formalisht të pavarura, por shumica mbeten të varura nga interesa politike apo ekonomike. Standardet profesionale dhe etike të medias shqiptare janë në përgjithësi të ulëta. Gazetarët shpeshherë frikësohen nga kërcënimet për ndjekje penale për shpifje – shkelje që parashikohet me dënime të ashpra. Shpifja mbetet një shkelje penale që mund të rezultojë në dënime deri në dy vjet. Edhe pse janë planifikuar ligje që të adresojnë këtë çështje, ato nuk janë finalizuar akoma. Rastet e dhunës psikologjike dhe fizike kundër gazetarëve nga ana e përfaqësuesve të autoriteteve shtetërore janë sporadike, por mbeten të pranishme. Kuadri ligjor për mbrojtjen e lirisë së medieve mbetet e pamjaftueshme, për shembull pavarësia e medias pengohet nga fakti që legjislacioni i tanishëm nuk e bën të detyrueshme zbulimin e pronësisë. Edhe pse Shqipëria ka bërë njëfarë pune për ligje të reja, veçanërisht në lidhje me forcimin e mbrojtjes ligjore të gazetarëve dhe përmirësimin e statusit të tyre, megjithatë,

Kuvendi nuk ka qenë në gjendje të miratojë një ligj të ri për median e shkruar përpara përfundimit të legjislaturës së fundit nën qeverinë e mëparshme në maj 2005. I ngadaltë ka qenë progresi për miratimin e një ligji organik për median e shkruar dhe reformimit të ligjeve civile dhe penale mbi shpifjen. Masat praktike lidhur me të drejtën për lirinë e shprehjes dhe mendimit të gazetarëve dhe përfaqësuesve të medias dhe trajnimi për rritjen e profesionalizmit dhe pavarësisë së gazetarëve, mbeten të pamjaftueshme. Një zhvillim pozitiv, paçka se nën presionin e komunitetit ndërkombëtar, ishte refuzimi nga parlamenti i projektligjit mbi transmetimet digjitale tokësore që devijonte nga rekomandimet e OSBE-së dhe Këshillit të Europës dhe paraqiste rrezikun e krijimit të monopolit.

Kushtetuta garanton *lirinë e tubimeve paqësore dhe të drejtën e shoqërimit*, dhe Shteti përgjithësisht i respekton këto të drejta.

Kushtetuta e ndalon *diskriminimin* bazuar në racë, përkatësi etnike dhe gjuhë, por ka raportime për diskriminimin e komuniteteve rome dhe egjiptiane.

Kushtetuta nuk garanton qartësisht të drejtën për mospërndjekje bazuar në orientim seksual dhe ka pasur raportime të vazhdueshme për arrestime arbitrare dhe keqtrajtime të homoseksualëve nga ana e policisë. Në terma të përgjithshëm, niveli i mbrojtjes ndaj diskriminimit është shumë larg standardeve të BE-së, çka kërkon zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë ndërmjet personave pavarësisht nga origjina racore apo etnike dhe ngritjen e një kuadri të përgjithshëm për trajtimin e barabartë në punësim dhe vend pune, pavarësisht nga feja apo besimet, paaftësitë fizike, mosha apo orientimi seksual.

E drejta e pronësisë mbrohet me ligj. Miratimi i Ligjit për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave dhe ngritja e Komisionit Shtetëror për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave si dhe komisione vendore të lidhura me të, ishin një hap i rëndësishëm në përmbushjen e detyrimeve kushtetuese, por shumë nga afatet e parashikuara nuk janë respektuar. Asambleja rrjedhimisht vendosi të shtynte afatin e dorëzimit të deklaratave të pasurisë me një vit, deri më 2006, që çon në një vonesë të mundshme të zbatimit të plotë deri më 2007. Asambleja gjithashtu miratoi Ligjin për Metodologjinë e Vlerësimit për Kompensimin e Pronës. Me formën e tanishme që ka, metodologjia mund të ketë implikime të konsiderueshme buxhetore dhe mund të ndikojë për keq në aftësinë e Shqipërisë për të zbatuar si ligjin e ri për kthimin dhe kompensimin e pronave, por edhe prioritetet e zhvillimit social-ekonomik. Për më tepër, regjistrimi fillestar i pasurive të paluajtshme nuk po vazhdon me ritmin e duhur që të llogaritet se sa tokë shtetërore është në dispozicion në mënyrë që të vlerësohen nevojat

financiare për kompensimin në para. Me sa shihet, shumica e pronave në zona urbane dhe bregdetare, ku tregu i tokës është më aktiv dhe të cilat kanë potencialin më të madh ekonomik, ka mbetur akoma i paregjistruar. Ka pasur akuza të vazhdueshme për privatizimin e paligjshëm të pronave ku nuk është zbatuar akoma procesi i kthimit dhe kompensimit.

Organizatat Joqeveritare (OJQ-të) po fitojnë influencë dhe po marrin një rol më të gjerë thuajse në të gjitha aspektet e jetës sociale, ekonomike dhe politike në Shqipëri. Ligji Shqiptar për OJQ-të në 2001 siguron një bazë të qëndrueshme për zhvillimin e mëtejshëm të sektorit të OJQ-vë. Ky ligj cilësohet si një nga ligjet me liberale të llojit të vet në rajon, sepse u jep OJQ-vë një fushë të gjerë veprimi, të drejtash dhe përgjegjësish. OJQ-të përgjithësisht operojnë pa kufizime nga ana e shtetit. Megjithatë, Shqipëria mund të përfitojë nga një politikë qeveritare e cila do të nxiste përfshirjen e OJQ-vë në procesin vendimmarrës.

Të drejtat ekonomike dhe sociale

Qeveria i vazhdoi përpjekjet për promovimin e të drejtave ekonomike dhe sociale të grupeve të disfavorizuara. Njëfarë progresi është bërë edhe për çështjet gjinore: Kuvendi miratoi një ligj për barazinë gjinore dhe Këshilli i Ministrave miratoi një Strategji Kombëtare për Njerëzit me Aftësi të Kufizuara. Pavarësisht nga këto përmirësime, femrat, njerëzit me aftësi të kufizuara dhe shtresat e varfra rurale vazhdojnë të përballen me probleme për sa i takon arritjes së të drejtave të barabarta ekonomike dhe sociale ashtu si pjesa tjetër e popullatës shqiptare.

Një Ligj i ri për *Barazinë Gjinore* promovon mundësitë e barabarta dhe synon të eliminojë diskriminimin e drejtpërdrejtë ose jo në fushat si punësimi në sektorin publik. Një zhvillim pozitiv ka qenë ngritja e Komisionit Shtetëror për Mundësitë e Barabarta, por është kritikuar nga komuniteti i OJQ-vë për mungesë financime dhe mungesë influence politike. Diskriminimi ndaj fëmijëve femrave ndalohet me ligj, por vajzat, veçanërisht në zonat rurale, akoma detyrohen të martohen herët. Femrat në Shqipëri akoma nuk mbrohen nga ligje specifike që adresojnë problemin e dhunës në familje. Në shoqërinë tradicionale të dominuar nga meshkujt, dhuna kundër femrave përfshi edhe abuzimin martesor mbetet një problem serioz. Numri i çështjeve të raportuara dhe të ndjekura penalisht është shumë herë më i vogël se numri i rasteve që ndodhin realisht.

Në lidhje me *të drejtat e fëmijëve*, është ngritur një Komision Ndërministror për Të Drejtat e Fëmijëve dhe një departament për të drejtat e fëmijëve në zyrën e Avokatit të Popullit, por asnjëri nuk është pajisur me personelin dhe burimet e mjaftueshme. Qeveria ka treguar angazhim në përmirësimin e sistemit gjyqësor për të miturit, për shembull duke ndërtuar qendra specifike paraburgimi për të miturit. Numri i fëmijëve që ngujohen në shtëpi për shkak të gjakmarrjes është reduktuar ndjeshëm, megjithatë, sipas raportimeve, mbi 160 fëmijë vazhdojnë të jetojnë në këto kushte dhe rrjedhimisht privohen nga e drejta e ushtrimit të të drejtave siç është *e drejta e shkollimit*. Duhet të shtohen përpjekjet për të ndihmuar fëmijët me nevoja të veçanta që të kenë akses të barabartë në të drejtat ekonomike dhe sociale dhe kjo vlen edhe për fëmijët që janë të detyruar të punojnë. Ligji shqiptar garanton të drejtën e shkollimit falas 9-vjeçar, por problemet social-ekonomike dhe mungesa e dokumenteve të duhura – të cilat ndonjëherë humbasin për shkak të migrimit të brendshëm – pengojnë kryerjen e shkollimit të detyruar për shumë fëmijë. Akses i barabartë për kujdesin mjekësor për qytetarët e të gjitha moshave vazhdon të pengohet nga pagesat e paligjshme që janë në masë të gjerë dhe ryshfetet.

Në fushën e *të drejtave të punësimit dhe sindikatave*, kushtetuta shqiptare garanton të drejtën për të fituar të drejtën duke zgjedhur ose pranuar një punë të ligjshme. Rroga minimale për të gjithë punëtorët mbi moshën 16 vjeç është afërsisht 90 EUR, që janë të pamjaftueshme për të siguruar një standard të denjë jetese për një punëtor dhe familjen e tij/e saj. Ligji shqiptar gjithashtu siguron asistencë sociale dhe papunësi, por ndihma shtetërore është shumë e kufizuar dhe shpesh e përqendruar keq. E drejta e shoqërimit u jep punëtorëve të drejtën për të formuar sindikata të pavarura, megjithëse sindikatat pësuan një rënie në anëtarësi në 2004 për shkak të papunësisë dhe pakënaqësive të anëtarëve.

Të drejtat e minoriteteve, të drejtat kulturore dhe mbrojtja e minoriteteve

Legjislacioni amerikan njih tre minoritete kombëtare (grek, maqedonas etnikë dhe malazezë) dhe dy minoritete etno-linguistikë (vlleh dhe romë). Minoriteti grek është grupi më i madh, i udhëhequr nga shoqata e tyre kulturore Omonia. Shqipëria ka ndërmarrë përpjekje të konsiderueshme për mbrojtjen e minoriteteve, si në fushat e arsimit dhe sigurimin e shkollave dhe kurseve për minoritete të caktuara në zona specifike. Është ngritur një Komision Shtetëror për Komunitetet për përmirësimin e përfaqësimit të minoriteteve në jetën publike. Përpjekje të mëtejshme nevojiten për të përfunduar kuadrin ligjor dhe

administrativ për mbrojtjen e minoriteteve dhe zbatimin e tij, kryesisht për sa i takon rritjes së përdorimit të gjuhës së minoriteteve në marrëdhëniet e qytetarëve me autoritetet dhe vendosjen e emrave tradicionalë vendas, përmirësimit të aksesit në media për personat që u përkasin minoriteteve dhe zgjerimit të arsimit me gjuhën minoritare. Në kundërshtim me angazhimet, qeveria ka dështuar në sigurimin e statistikave të sakta në lidhje me përqindjen e minoriteteve, një çështje që ka rëndësi të veçantë për minoritetin grek.

Në 2003, qeveria miratoi Strategjinë Kombëtare për Përmirësimin e Kushteve të Jetës së Minoritetit Rom, i cili parashikon një mekanizëm për monitorimin e zbatimit. Pavarësisht nga masat e kësaj strategjie, komunitetet rome dhe egjiptiane vazhdojnë të vuajnë paragjykim dhe diskriminim në disa aspekte shoqërore. Shkollimi i fëmijëve, trajnimi profesional dhe punësimi i personave që i përkasin këtyre komuniteteve, lë për të dëshiruar. Dispozitat përkatëse të Konventës Kuadër të Këshillit të Europës për Mbrojtjen e Minoriteteve Kombëtare 22 në 1999 në të cilën Shqipëria është palë, nuk janë vënë në zbatim plotësisht. Shqipëria duhet të zhvillojë më tej masat praktike për romët sipas Strategjisë Kombëtare dhe të planifikojë burime financiare për zbatimin e plotë të saj.

1.3 Çështjet rajonale dhe detyrimet ndërkombëtare

Shqipëria ka vazhduar në mënyrë aktive që të ndjekë aktivitete *bashkëpunim rajonal* me synim thellimin e lidhjeve politike dhe tregtare me fqinjët.

Shqipëria po zbaton Marrëveshjet e Tregtisë së Lirë (MTL) me këto tetë shtete: ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë, Kroacia, Bullgaria, Rumania, Kosova (nën rregulloret 1244 të KS), Moldavia, Serbi-Mali i Zi dhe Bosnja-Hercegovina. Negociatat MTL me Turqinë janë në proces.

Shqipëria ka marrë pjesë me sukses në aktivitete nën një sërë nismash shumëpalëshe rajonale gjatë periudhës raportuese, përfshi Procesin e Bashkëpunimit të Europës Juglindore (PBEJ), Paktin e Stabilitetit, Nismën Europiane të Europës Jugore (NEEJ), Nismën Adriatik-Jo, Bashkëpunimin Ekonomik të Detit të Zi (BEDZ), Nismën e Bashkëpunimit të Juglindjes (NBj) dhe Nismën e Sigurisë Kufitare. Për më tepër, Shqipëria ka vazhduar një politikë mosndërrhyrjeje dhe pajtimi për çështjet në lidhje me pakicat shqiptare në vendet fqinje.

Marrëdhëniet me **Serbi-Mali i Zi (SMZ)** janë racionale dhe të qëndrueshme. Nënshkrimi i një MTL ndërmjet Shqipërisë dhe SMZ ishte një hap i rëndësishëm, sidoqoftë, potenciali i saj i plotë mbetet për t'u realizuar.

Shqipëria ka mbajtur një politikë të hapur dhe konstruktive kundrejt Kosovës. Shqipëria mbështet përcaktimin e statusit përfundimtar të Kosovës brenda kuadrit e integritit të saj në BE. Elementet kryesore të politikës zyrtare Shqiptare karshi Kosovës kanë qenë si vijon: respektimi i plotë i të drejtave të njeriut, përfshi këtu të të gjitha minoriteteve, përjashtimin e ndarjes, përçarjes apo çfarëdo ndryshimi në territorin e Kosovës dhe një status që pasqyron vullnetin e popullit të Kosovës. Deklaratat fillestare nga qeveria e re kanë konfirmuar pozicionin konstruktiv të Shqipërisë në këto vija dhje një qëndrim më aktiv.

Marrëdhëniet midis Shqipërisë dhe ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë kanë vazhduar të jenë të mira. MTL ndërmjet tyre rezultoi në rritjen e tregtisë dypalëshe dhe përveç vizitave shtetërore në nivel presidencial, takime ndërministrare janë zhvilluar mbi një larmi çështjesh.

Italia është partneri kryesor tregtar i Shqipërisë si dhe një nga donatorët më të mëdhenj, me disa SME kryesisht me kapital të përbashkët. Italia ka ndërmarrë aktivitete të gjera bashkëpunimi dypalësh me Shqipërinë, si për shembull Delegacioni i Ekspertëve Italianë i cili ka asistuar Forcat e Armatosura Shqiptare në përpjekjet e saj për të përmbushur standardet e NATO-s. Në lidhje me bashkëpunimin në fushën e drejtësisë, lirisë dhe sigurisë, Italia lëshoi 20 000 viza Shengen afatshkurtra në 2003/2004 për qytetarët shqiptarë. Në 2004, qeveria italiane rezervoi shumicën e vizave individuale për qytetarët shqiptare në përgjigje të përpjekjeve të qeverisë shqiptare në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore përmes Detit Adriatik.

Greqia mbetet partneri i dytë tregtar i Shqipërisë dhe lidhjet pozitive kanë vazhduar midis dy fqinjëve. Mbi 600 000 shqiptarë aktualisht jetojnë dhe punojnë në Greqi dhe numri i vizave Shengen afatshkurtra të lëshuara nga Greqia u rrit me 20% midis viteve 2003 dhe 2004. Në 2004, u lëshuan 17 000 viza pune për t'i lejuar shqiptarët që të punojnë në Greqi. Qeveritë e Greqisë dhe Shqipërisë kanë bërë përpjekje të mëdha për të përmirësuar komunikimin me tyre.

Numri i *refugjatëve* shqiptarë vazhdon të jetë i ulët dhe nuk përbën problem serioz.

Në lidhje me *Gjykatën e Ndërkombëtare Penale (ICC)*, në qershor 2003 Shqipëria ratifikoi një marrëveshje dypalëshe imuniteti me Shtetet e bashkuara e cila bie në kundërshtim me “parimet udhëzuese të BE-së në lidhje me marrëveshjet ndërmjet një pale shtetërore me Statutin e Romës së ICC dhe SHBA-së për kushtet e dorëzimit të personave në gjykatë” miratuar nga Këshilli i BE-së në shtator 2002.

Shqipëria ka shfaqur qëndrim konstruktiv në kontekstin e negociatave për Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit në lidhje me *përhapjen e armëve të shkatërrimit në masë* dhe mjetet e tyre të shpërndarjes. Megjithatë, duhet të përforcohen kapacitetet për monitorimin e detyrimeve ndërkombëtare (p.sh. për terrorizmin dhe mospërhapjen e armëve).

Shqipëria u bashkua me partneritetin e *NATO-s* për nismat e paqes në shtator 1994 dhe ishte një nga të parat shtete. Në një deklaratë të përbashkët në samitin e NATO-s në qershor 2004, Shqipëria bashkë me Kroacinë dhe ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë, konfirmoi gatishmërinë e saj për të ruajtur dhe për të zgjeruar kontributin për politikën e NATO-s, nismat, misionet dhe operacionet. Shqipëria gjithashtu vuri në dukje shpresën e saj për të fituar anëtarësim të plotë në NATO sa më shpejt të jetë e mundur dhe mbështeti përfshirjen e Bosnjë-Hercegovinës dhe Serbi-Mali i Zi në Partneritetin më Nismat e Paqes.

1.4 Vlerësim i përgjithshëm

Për sa i takon **situatës politike**, Shqipëria ka shënuar progres në institucionet demokratike, gjyqësore dhe të administratës publike, por i duhet t'i vërë në zbatim më me vendosmëri strategjitë dhe ligjet, në mënyrë që të përmirësohet më tej funksionimi i tyre. Përpjekje janë bërë për të luftuar korrupsionin dhe përmirësimin e të drejtave të njeriut. Angazhim i mëtejshëm nevojitet për të arritur rezultate më konkrete. Shqipëria ka vazhduar të luajë një rol pozitiv politik dhe tregtar në rajon.

Kuvendi vazhdon të jetë qendra e shkëmbimeve politike dhe ka kaluar një sërë ligjesh të rëndësishme. Konfrontimet e ashpra politike kanë penguar konsensusin politik për çështjet e reformave, duke e ngadalësuar progresin. Rregullat e reja të brendshme parlamentare dhe në veçanti Komisioni i Integritetit Europian që u përforcua, mund të ndihmojnë në nxitjen e konsensusit konstruktiv. Zgjedhjet parlamentare të korrikut 2005 ishin të shëndetshme dhe rezultuan në një

transferim të butë të pushtetit, por shfaqën mangësi që treguan nevojën për reformë zgjedhore.

Qeveria ka zhvilluar strategji të reja të mëdha dhe mjete bashkërendimi të përshtatshme për progresin drejt BE-së. Në disa raste, nevojitet më tepër energji dhe angazhim për t'i përdorur në mënyrë që të japin rezultate konkrete. Është forcuar Ministria e Integrimit European, por ajo ka nevojë për burime të mëtejshme për të përmirësuar udhëheqjen dhe bashkërendimin për çështjet e BE-së. Shkrimi i disa ministrive mund të përmirësojë bashkërendimin për politikat e përbashkëta, por duhet bërë kujdes për të siguruar kontrollet dhe balancat e duhura.

Shqipëria ka përmirësuar përzgjedhjen, rekrutimin dhe trajnimin e administratës publike dhe ka marrë masa për forcimin e kuadrit të vet ligjor. Tashmë i duhet të sigurojë një ndarje të përshtatshme ndërmjet niveleve të saj politike dhe administrative dhe të përmirësojë procedurat vlerësuese dhe kushtet e punës për nëpunësit civilë.

Progres është arritur edhe në përmirësimin e funksionimit të sistemit gjyqësor shqiptar. Trajnimet për gjyqtarët dhe prokurorët janë përmirësuar dhe duhet të pasohen me hapa të mëtejshëm që sigurojnë pavarësinë e tyre dhe kushte më të mira pune për personelin tjetër gjyqësor. Janë ndërmarrë masa për rritjen e transparencës së gjyqësorit dhe bashkërendimit, por më tepër duhet bërë. Edhe pse po ekzekutohen më tepër vendime, niveli i ekzekutimeve mbetet akoma relativisht i ulët. Mjetet e reja ligjore dhe marrëveshjet rajonale duhet të vihen në përdorim për të arritur rezultate më konkrete në luftën kundër krimit të organizuar dhe terrorizmit.

Disa përpjekje janë bërë për të luftuar korrupsionin: ka vazhduar puna në forumet ndërkombëtare, janë miratuar ligje të reja për konfliktin e interesave, është rritur numri i zyrtarëve publikë të ndjekur penalisht për korrupsion dhe masa të forta janë marrë kundër korrupsionit në polici. Megjithatë, rezultatet e prekshme mbeten të kufizuara: shumë më tepër përpjekje kërkohen për vënien në zbatim të legjislacionit të tanishëm dhe për miratimin e masave të reja në përputhje me plan-veprimin anti-korrupsion të Shqipërisë, me rekomandimet e GRECO-s dhe me konventat ndërkombëtare anti-korrupsion.

Në fushën e të drejtave të njeriut, Shqipëria ka bërë përpjekje për përmirësimin e kushteve të të burgosurve, me një kod të ri sjelljeje dhe një ligji për kontrollimin e brendshëm të burgjeve, por infrastruktura e dobët bën që kushtet fizike të lënë

për të dëshiruar. Duhet të përmirësohet shkalla e njohurive dhe e zbatimit të ligjit vendas dhe i konventave ndërkombëtare për trajtimin e të burgosurve. Fare pak progres konkret është bërë në përmirësimin e lirisë së medias. Progres legjislativ është bërë në përforcimin e të drejtave të pronësisë, por zbatimi në terren i tyre duhet përshpejtuar fuqishëm.

Shqipëria është shembull i tolerancës fetare, por kërkohet progres i mëtejshëm në arritjen e standardeve ndërkombëtare për të drejtat njerëzore dhe minoritare.

Shqipëria ka vazhduar të luajë një rol pozitiv në rajon, duke kërkuar në mënyrë aktive që të thellojë lidhjet politike dhe tregtare me fqinjët përmes marrëveshjeve të tregtisë së lirë dhe nismave rajonale shumëpalëshe dhe ka mbajtur një politikë konstruktive për çështjen e Kosovës²⁵.

2. Situata ekonomike

Në Raportin 2004, Komisioni konstatoi që:

“PBB në Shqipëri është rritur në 6.0% në 2003 nga 4.7% në 2002. Në fund të vitit 2003, inflacioni arriti në 3.3%, brenda planit të qeverisë. Privatizimi i bankës më të madhe në vend, Banka e Kursimeve, kaënë një arritje e spikatur. Hapat paraprakë janë marrë në adresimin e çështjes së pronësisë mbi tokën. Sidoqoftë, qëndrueshmëria afatmesme e rritjes ekonomike si dhe aftësia e vendit për të lehtësuar varfërinë po vihen në rrezik nga pasiguria politike dhe përqendrimi i pakët tek reformat. Ekonomia shqiptare vazhdon të jetë informale në një shkallë të lartë. Mjedi si i biznesit është i pamjaftueshëm dhe ofron fare pak për nxitjen e investimeve. Korrupsioni, krimi i organizuar, zbatimi deficitar i ligjit dhe mosefiçenca administrative vazhdojnë t’i vënë barriera biznesit dhe të pengojnë sigurinë ligjore. Pavarësisht nga arritjet për vendosjen e Marrëveshjeve të Tregtisë së Lirë me shtetet e rajonit, Shqipëria ka qenë e pazonja që të zbatojë plotësisht detyrimet e hyrjes së OBT.”

Në ekzaminimin e zhvillimeve ekonomike në Shqipëri, përjasja e Komisionit u udhëzua nga përfundimet e Këshillit Europian në qershor 1993 në Kopenhagen ku u vendos që për anëtarësimin në Bashkimin Europian kërkohet:

– ekzistenca e një ekonomie tregu funksionuese;

– aftësia për të përballuar presionin e konkurrencës dhe forcat e tregut brenda Bashkimit Europian;

dhe nga Përfundimet e Këshillit të Ministrave të 29-30 prillit 1997, u vendos që lidhjet kontraktuale me BE-në kërkojnë

– institucione makroekonomike dhe politikat e nevojshme për të garantuar një mjedis të qëndrueshëm ekonomik;

– liberalizim gjithëpërfshirës së çmimeve, tregtisë dhe llogarive rrjedhëse;

– ngritjen e një kuadri ligjor rregullator transparent dhe të qëndrueshëm;

– çmonopolizimin dhe privatizimin e ndërmarrjeve shtetërore;

– ngritja e një sektori bankar konkurrues dhe të menaxhuar me kujdes;

në analizën e mëposhtme, Komisioni ka përdorur metodologjinë e ndjekur Raportet e tjera të Përvitshme.

2.1 Zhvillimet ekonomike

Zhvillimet makroekonomike

Në 2004, PBB qëndroi i lartë afërsisht 6% ndërkohë që akordimi i burimeve në varësi të tranzicionit vazhdoi të nxiste prodhueshmërinë. Rritja reale ekonomike vlerësohet të ketë arritur 5.9% në 2004. Inflacioni mesatar u mbajt i ulët në 2.9% në 2004 dhe u ul edhe më tej në 2.2% në tremujorin e parë të 2005-ës, sërish brenda planit të bankës së Shqipërisë (2 - 4%). Leku u vlerësua me 6% kundrejt euros në 2004 pavarësisht nga lehtësimi i interesave bankare vendase dhe disa ndërhyrje të Bankës së Shqipërisë, duke reflektuar përmirësimin e llogarive të jashtme dhe rritjen e besimit të monedha vendase. Leku vazhdoi prirjen e vlerësimit, duke u forcuar vazhdimisht kundrejt euros edhe me mbi 2% në tremujorin e parë të vitit 2005. Për 2004-ën, autoritetet vazhduan kursin e konsolidimit fiskal dhe buxheti i tanishëm (deficiti i rregulluar për shpenzimet investuese vlerësohet të ketë qenë në balancë për herë të parë që nga fillimi i tranzicionit. Nën presionin e faktorëve të inflacionit, Banka e Shqipërisë e uli shkallën e interesit kryesor në 5.0% (me 125 pikë bazë nga janari 2004 në mars 2005). Deficiti tregtar u ul në 21.5% të PBB-së në 2004 pasi aktiviteti përpunues i eksporteve u rrit dhe importet ruajtën shkallën mesatare për shkak se në vend u rrit oferta e produkteve strategjike (energji elektrike, prodhimet ushqimore). Deficiti i llogarive është ulur në 6% të PBB-së në 2004 krahasuar me 8.1% në 2003.

Shqipëria – Prirjet Kryesore Ekonomike

		2000	2001	2002	2003	2004	2005
Rritja reale PBB	%	7.3	7.2	3.4	6.0	5.9	-
Shkalla e inflacionit	% (mesatarisht)	0.0	3.1	5.2	2.4	2.9	2.2 jan-shta
	% (fundi i periudhës)	4.2	3.5	1.7	3.3	2.2	3.1 shtat
Shkalla e papunësisë	% e krahut të punës	16.8	16.4	15.8	15.0	14.1	-
Bilanci i përgjithshëm qeveritar ¹	% e PBB-së	-9.2	-8.5	-7.3	-4.8	-5.3	-
Bilanci i përgjithshëm qeveritar ²	% e PBB-së	-8.2	-7.9	-6.6	-4.4	-5.0	-
Bilanci tregtar	% e PBB-së	-22.1	-23.2	-25.8	-24.6	-21.5	-
Bilanci i llogarive rrjedhëse ³	% e PBB-së	-7.4	-6.4	-9.7	-8.1	-6.0	-
Bilanci i llogarive rrjedhëse ⁴	% e PBB-së	-4.4	-3.4	-6.9	-5.6	-4.4	-
Borxhi i jashtëm	% e PBB-së	31.8	27.8	25.1	21.7	19.9	-
	Milion €	1.27	1.27	1.20	1.09	1.22	-
Raporti borxh-eksport	%	166	143	129	122	104	-
Investimet e huaja të drejtpërdrejta ⁵	% e PBB-së	3.9	5.0	3.0	3.1	4.5	-
	Milion €	155	227	143	155	276	42 3-mujori 1

(1) para granteve (2) pas granteve (3) para transfertave zyrtare (4) pas transfertave zyrtare (5) neto
Burimi: Autoritetet kombëtare, FMN, vlerësimet e KE-së.

Reformat strukturore

Progresi në reformën e administratës publike ka vazhduar, kapaciteti administrativ i administratës tatimore është përmirësuar në periudhën e fundit dhe janë vënë në zbatim disa reforma vendimtare (menaxhimi i burimeve njerëzore, trajnimi, reforma e sistemit të apelit etj.). Sidoqoftë, kapaciteti i mbledhjes dhe i kontrollit mbetet i dobët. Në fushën e kontrollit publik financiar dhe auditit të brendshëm, njëfarë progresi është bërë në 2004. Privatizimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme ka përfunduar, ndërsa privatizimi i ndërmarrjeve të mëdha ka pasur vonesa. Megjithatë, për sa i takon sektorit bankar, u mbyll në 2004 shitja e Bankës së Kursimeve një investitori të huaj strategjik. Përkundrazi, ratifikimi i marrëveshjes së shitjes që do të mbyllte privatizimin e Albtelekomit u hodh poshtë nga parlamenti shqiptar në tetor 2005, duke kërkuar një rishikim të kontratës së shitjes dhe të të gjithë procedurave tenderuese.

2.2 Progresi drejt stabilitetit ekonomik dhe konkurrueshmërisë

Vendosja e parimeve të tregut

Zhvillimi i parimeve të tregut kërkon liberalizimin e çmimeve dhe të tregtisë dhe zbatimin e një sistemi ligjor, përfshi të drejtat e pronësisë.

Stabiliteti makroekonomik dhe konsensusi për politikën ekonomike nxisin performancën e ekonomisë së tregut. Një sektor financiar i mirëzhvilluar dhe mungesa e barrierave të mëdha në hyrjen dhe daljen në treg, përmirësojnë eficientësinë e ekonomisë.

Pavarësisht nga njëfarë klime konfrontuese politike, ka pasur konsensus të gjerë për pikat kryesore të politikës ekonomike. Një sërë nismash janë ndërmarrë për hartimin e politikave të ndryshme dhe në përgatitjen e ligjeve. Veçanërisht plani shumëvjeçar për lehtësimin e varfërisë dhe përmirësimin e qeverisjen nën Strategjinë Kombëtare për Zhvillimin Social dhe Ekonomik, Planin e Veprimit për Zbatimin e Prioriteteve të Partneritetit European, Planin Kombëtar për Përafrimin e Legjislacionit dhe Sistemit të Planifikimit të Integruar (që synon të integrojë të gjitha kuadret e politikave në një plan të vetëm zhvillimi i lidhur me kuadrin e shpenzimeve afatmesme dhe buxhetin vjetor) që u filluan së fundmi. Megjithatë, aftësia e ekzekutivit të ri për të arritur një bashkërendim dhe zbatim efikas politikash mbetet për t'u parë.

PBB qëndroi i lartë afërsisht 6% ndërkohë që akordimi i burimeve në varësi të tranzicionit vazhdoi të nxiste prodhueshmërinë. Rritja reale ekonomike vlerësohet të ketë arritur 5.9% në 2004 pas 6% në 2003. Për sa i takon sektorit të shpërndarjes së rritjes PBB në 2004, transportet dhe ndërtimet vlerësohen të jenë rritur me më shumë se 10%, shërbimet me 6.4% dhe bujqësia dhe industria me 3%. Rritja e PBB-së është nxitur nga rritja e prodhueshmërisë për shkak të riakordimit të burimeve, por akoma nuk është konsoliduar një ekspansion me bazë të gjerë i outputeve të tregtueshme. Përveç kësaj, ekonomia shqiptare nuk është fort tërheqëse për investimet dhe pavarësisht një rënieje të varfërisë absolute, çereku i popullatës shqiptare jeton akoma nën minimumin jetik.

Deficiti tregtar është zvogëluar pasi u përmirësua bilanci kursime-investime i ekonomisë. Rendimenti eksportues i Shqipërisë u forcua në 2004 me rritjen e aktiviteteve përpunuese ri-eksportuese dhe rritja importuese ra pasi u përmirësuan ofertat vendase për energji elektrike dhe artikuj ushqimorë. Deficiti tregtar u ul në 21.5% të PBB-së nga 24.6% në 2003 dhe është mbuluar kryesisht nga remitancat e

emigrantëve dhe transferime të tjera private apo zyrtare nga jashtë shtetit, duke forcuar të ardhurat dhe kërkesën vendase. Rol shumë të madh në ekonominë shqiptare luajnë sidomos remitancat e punëtorëve. Në 2004 ato përbënin 14% të PBB-së. Ky fluks i konsiderueshëm e ka lejuar Shqipërinë që të vazhdojë të përballojë deficitin relativisht të lartë në tregtimin e mallrave dhe shërbimeve. Të ardhurat nga punëtorët emigrantë u rrit nga kërkesa për punëtorë shqiptare gjatë ndërtimit të mjediseve për Olimpiadën e Athinës. Deficiti i llogarive rrjedhëse (duke përfshirë transfertat zyrtare) u ul në 6% të PBB-së në 2004 krahasuar me 8.1% në 2003. Investimet në vend në llogaritë shqiptare përbëjnë afërsisht 24% të PBB-së.

Tregu i punës filloi të përmirësohet. Rritja e qëndrueshme ekonomike gjatë viteve të fundit, ka pasur një ndikim pozitiv në tregun e punës. Megjithatë, shkalla e këtij ndikimi vështirë se mund të llogaritet, për shkak të emigracionit të lartë dhe punësimit informal. Në fundin e vitit 2004, shkalla e papunësisë (bazuar në të dhënat e regjistruara pasi Shqipëria ende nuk ka bërë një Studim të Krahut të Punës) vlerësohet të ketë arritur në 14.1% që është pak më mirë se vitin e kaluar kur shënonte 15%. Sidoqoftë, papunësia e regjistruar është një tregues që i mungon besueshmëria ²⁸ për shkak të sektorit të konsiderueshëm informal dhe papunësisë së fshehur në bujqësi, ndërkohë që disa të papunë nuk arrijnë të regjistrohen.

Inflacioni vazhdon të ulet. Inflacioni vjetor i çmimeve për konsumatorin shënoi vlerën 2.2% në dhjetor 2004, krahasuar me 3.3% në 2003. Përqindja mesatare vjetore e inflacionit në 2004 ishte 2.9% dhe u ul deri në 2.2% në tre tremujorët e parë të 2005-ës. Niveli relativisht i ulët dhe i qëndrueshëm i inflacionit është një pasqyrim i vlerësimit të vazhdueshëm të lekut kundrejt euros dhe dollarit amerikan, që ndihmoi në mbrojtjen e ekonomisë shqiptare në njëfarë mase nga zhvillimet në tregun e përpunimit të naftës. Përveç kësaj, zhvillimet e favorshme të prodhimit bujqësor ndihmuan në çmimin e qëndrueshëm të prodhimeve ushqimore të cilat përbëjnë thuhetse 43% të indeksit të çmimeve

Inflacioni i ulët dhe vlerësimi i lekut kanë mundësuar uljen e interesave monetare kyçe. Duke pasur parasysh zhvillimet pozitive të inflacionit, Banka e Shqipërisë uli interesat me 125 pikë midis janarit 2004 dhe marsit 2005 në 5.00%. Megjithatë, në terma konkretë, përqindja e interesit afatshkurtër ka qëndruar në kuotën relativisht të lartë prej 3% dhe ka mbetur thuhetse e pandryshuar deri në fund të vitit 2003. Bashkë me vlerësimin e lekut, kushtet e politikës monetare kanë mbetur shumë të shtrënguara. Regjimi i këmbimit është forcuar dhe në 2004, leku fuqizua me 6% kundrejt euros pavarësisht nga lehtësimi i interesave vendase dhe

disa ndërhyrjeve të BSH-së, duke pasqyruar kështu përmirësimin e llogarive të jashtme dhe rritjen e besimit në monedhën vendase. Rritja e besimit demonstron edhe nga shtimi i depozitave në lek. Leku vazhdoi kurbën e fuqizimit, duke fituar edhe mbi 2% kundrejt euros gjatë 3 tremujorëve të vitit 2005.

Në 2004 vazhdoi shtrëngimi fiskal; megjithatë konsolidimi fiskal mbetet i brishtë. Autoritetet vazhduan një kurs konsolidimi fiskal dhe bilanci buxhetor (deficiti i rregulluar për shpenzimet investuese) vlerësohet të ketë qenë në balancë për herë të parë që nga fillimi i tranzicionit, edhe pse bazuar në bilancin e kartëmonedhave, deficiti buxhetor arriti në 5% të PBB-së në 2004. Raporti taksë të ardhurash/PBB qëndroi në 21% të PBB-së. Mbledhja e të ardhurave tatimore plotësoi planin në 2004, por rastet e shpeshta të presioneve të padrejta të autoriteteve tatimore kanë qenë një problem mjaft shqetësues për bizneset. Kontributi i sigurimeve shoqërore është akoma i pakënaqshëm (mbulon më pak se 35% e punonjësve në firmat private). Evazioni dhe shmangia e taksave në sektorin e firmave vendase është i konsiderueshëm – të ardhurat e padeklaruar vlerësohen në 52% të PBB-së. Ekonomia informale shqiptare përbën 30% të PBB-së zyrtare, çka përbën një pengesë thelbësore në gjenerimin e të ardhurave nga kanale të tjera përveç tregtisë ndërkombëtare. Për sa u takon shpenzimeve, ka akoma mangësi të theksuara, veçanërisht në disa sektorë sociale dhe infrastrukturore, të cilët kërkojnë përparësi më të madhe në menaxhimin e investimeve publike, planifikimi dhe vënie në zbatim.

Ndërthurja e politikave makro-ekonomike ka qenë përgjithësisht i duhur. Politika fiskale dhe politika monetare kanë vazhduar të jenë të shtrënguara. Inflacioni ka qenë i ulët, rritja PBB ishte e konsiderueshme dhe llogaritë e jashtme janë përmirësuar. Sidoqoftë, reformat strukturore në fushën fiskale kanë qenë të ngadalta dhe duhet të jenë prioritet, duke u përqendruar sidomos në përmirësimin e procesit buxhetor, menaxhimin të shpenzimeve, shërbimit civil dhe reformës së pagave publike.

Shumica e çmimeve janë liberalizuar. Megjithatë, subvencionet e shtetit akoma aplikohen për çmimet e ujit, arsimimit, transportit hekurudhor dhe energjisë elektrike.

Reforma e pronave ka kontribuar në zhvillimin e sektorit privat, që përbënte rreth ¾ të PBB-së në 2004. Shqipëria ka ndërmarrë reforma të përgjithshme për tokën, si parakusht i domosdoshëm për zhvillimin e tregjeve të tokës. Si rezultat i kësaj reforme, terreni rural është transformuar tërësisht pasi u shpërbënë fermat

kolektive, dhe afërsisht 98% e tokës bujqësore (546,000 ha) iu shpërnda pronarëve të vegjël. Kjo gjë e shndërroi bujqësinë nga një strukturë kolektive e komanduar në një sektor plotësisht privat ku familjet përdorin parcela të vogla apo të ndara toke për konsum vetjak dhe për treg. Livadhet dhe tokat pyjore thuajse nuk kanë qenë pjesë e procesit privatizues. Vetëm kohët e fundit, pronësia shtetërore i është transferuar komuniteteve dhe personave privatë.

Privatizimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme ka përfunduar, privatizimi i ndërmarrjeve të mëdha ka pasur vonesa. Në këto vonesa kanë kontribuar pasiguria politike dhe niveli i ulët i interesimit nga ana e investitorëve. Në këtë kontekst, privatizimi i Bankës së Kursimeve në 2004-ën, ishte një hap i madh përpara. Në agjendën e privatizimit dhe ristrukturimit tashmë mbetet çështja e kompanive të mëdha. Politika e përgjithshme e Shqipërisë është që fillimisht të ristrukturojë ndërmarrjet shtetërore, pastaj t'i privatizojë. Kompania e energjisë elektrike KESH është akoma në fazën e ristrukturimit dhe po zbaton një program gjithëpërfshirës për modernizimin dhe rehabilitimin e sektorit energjetik të financuar nga institucionet donatore ndërkombëtare si dhe përmes fondeve të veta. Procesi i privatizimit gjithashtu po vazhdon në sektorin e naftës dhe gazit. Ka filluar procesi privatizues i Albpetrol (prodhim), ARMO (rafineri) dhe Servcom (shpërndarje). Qeveria u tregua e gatshme t'i shesë të paktën 51% të ARMO-s një investitori strategjik i cili mund të aplikonte edhe për blerjen e aksioneve të tjera që do t'i ofroheshin publikut. Përpjekja e parë dështoi dhe autoritetet po shqyrtojnë mënyrat për ta provuar sërish privatizimin. Në sektorin e telekomunikacionit, në tetor 2005 Kuvendi e hodhi poshtë ratifikimin e marrëveshjes së shitjes që privatizonte Albtelekomin, pasi kërkoi rishikimin e kontratës së shitjes dhe të të gjitha procedurave tenderuese. Kushtet e privatizimit do të jenë të lidhura ngushtë me angazhimet përkatëse ndërkombëtare të Shqipërisë. Në 2004, qeveria miratoi një marrëveshje koncesioni për aeroportin kryesor komercial të vendit, Rinasin, afër kryeqytetit Tirana, duke i lejuar një konsorciumi ndërkombëtar të përdorë aeroportin për 20 vjet, duke thithur një investim me vlerë rreth 83 milion EUR dhe duke rritur kapacitetin e aeroportit deri në 10 milion udhëtarë nga viti 2010. Përveç kësaj marrëveshjeje, disa koncesione janë dhënë në vitet e fundit, edhe pse sipas një kuadri ligjor jo plotësisht në përputhje me standardet ndërkombëtare. Në qershor 2005, qeveria e mëparshme miratoi projektin e hekurudhës Tirana-Durrës-Rinas ku përfshihej financim i huaj komercial dhe përfaqësonte mbi 1% të PBB-së. Për këtë projekt pritet ratifikimi nga parlamenti.

Në 2004 janë regjistruar 55 000 subjekte biznesi, afërsisht 6% më shumë se në 2003 kur u regjistruan afërsisht 52 000. 99% e tyre ishin subjekte ose mikro dhe të

vogla, ose të mesme, me deri 80 punonjës. Në 2004, numri i subjekteve të reja shkoi në 9 603, që përfaqëson 23% rritje për bizneset e sapoformuara krahasuar me vitin 2003. Gjatë 2004-ës, sektorët kryesorë të aktivitetit të SME-ve ishin tregtia (50%), shërbimet (22%), transporti (10%) dhe industria (12%). 39% e numrit total të bizneseve është përqendruar brenda dhe përreth kryeqytetit Tirana.

Krijimi i sipërmarrjeve të reja vazhdoi të haste pengesa. Këto pengesa kanë qenë kryesisht infrastruktura e dobët, legjislacioni i mangët dhe zbatimi i dobët i legjislacionit tatimor, veprime dhe vendime arbitrare administrative, mungesa e krahut të kualifikuar të punës dhe furnizimi me energji, si dhe aksesimi në financim. Përveç këtyre, konkurrenca e padrejtë e bizneseve që operojnë në ekonominë informale mbetet akoma problem. Për të hapur një biznes në Shqipëri, numri i procedurave që kërkohen është 11, që është relativisht i lartë krahasuar me kontekstin rajonal dhe ndërkombëtar. Edhe kostot që e shoqërojnë këtë hap (si përqindje e të ardhurave për frymë) janë relativisht të larta. Megjithatë, vështirësitë si në punësimin por edhe në pushimin e punëtorëve janë relativisht të pakta krahasuar me vendet e tjera.

Thuajse aspak progres nuk është bërë në përmirësimin e procedurave të regjistrimit të kompanive. Veçanërisht, Regjimi i licensimit të bizneseve vazhdon të karakterizohet nga një sistem i çorientuar ku përfshihen një sërë autoritetesh që aplikojnë rregullore të ndërlikuara dhe të paqarta në përmbajtje. Mungesa e një procesi administrativ regjistruar dhe licencues, që kryhet pa pjesëmarrjen e gjykatave dhe pa procedura të thjeshta dhe transparente, e pengojnë krijimin e sipërmarrjeve të reja. Një nga të paktat përmirësime ishte heqja e kërkesës për regjistrim të përvitshëm në Zyrën e Tatim-Taksave, si edhe e disa kritereve për licencimin e kompanive jo-ushqimore. Zhvillimi i SME ka nevojë për inkurajim të mëtejshëm duke përmirësuar klimën e biznesit, duke zbatuar më mirë kuadrin ligjor, duke përmirësuar infrastrukturën dhe duke sjellë sektorin informal brenda ekonomisë formale, çka garanton kushtet e konkurrencës së drejtë.

Të drejtat e pronësisë mbeten të dobëta, duke dëmtuar potencialin për investime si dhe aktivitetin ekonomik. Qartësimi i të drejtave të pronës është një kusht thelbësor për nxitjen e zhvillimit ekonomik dhe të menaxhimit afatgjatë të tokës. Për më tepër, regjistrimi i pronave nuk ka përfunduar akoma në zonat kryesore urbane dhe bregdetare (ku tregu i tokës është më aktiv dhe ka potenciale më të mëdha ekonomike). Çështjet e pronësisë së tokës kanë qenë pengesë e madhe që shoqëritë e vogla të përfitonin hua bankare për shkak të kërkesave kolaterale. Mungesa e pronësisë së qëndrueshme pengon zhvillimin ekonomik dhe shton

praktikat korruptive. Pavarësisht faktit që ekzistojnë ligjet formale për investimet e huaja, pronësia e pasigurt e tokës i dekurajon investimet në Shqipëri. Programet e shumta të privatizimit dhe rikthimit të pronës, bashkë me aktivitetet kaotike ndërtuese, po pengojnë seriozisht transaksionet private.

Shqipëria tashmë gëzon një sektor bankar tërësisht privat që po i siguron shërbime më të mira bizneseve dhe personave. Privatizimi i suksesshëm i bankës kryesore shqiptare, Banka e Kursimeve, bashkë me hapat e ndërmarrë për privatizimin e kompanisë shqiptarë të sigurimit, INSIG, përfaqësojnë një progres të konsiderueshëm drejt përfundimit të privatizimit në sektorin financiar. Sektori bankar shqiptar tani konsiston në 16 banka private. Nisur nga pozita dominuese e bankës së Kursimeve (ajo zotëron 57% të depozitave bankare dhe 70% të tregut të bonove të thesarit), konkurrenca në sektorin bankar shqiptar është i kufizuar në këtë fazë. Megjithatë, me privatizimin e Bankës së Kursimeve dhe praninë e bankave të tjera me pronarë të huaj, pritet që konkurrenca të rritet shumë. Prania e një investitori të huaj strategjik do ta lehtësonte transferimin e njohurive dhe do të kontribuonte në përmirësimet e shërbimeve bankare.

Performanca e sektorit financiar në kanalizimin e kursimeve drejt investimeve produktive është përmirësuar së fundmi, por sërish mbetet e dobët. Fillimisht autoritetet ndoqën një polici sektoriale financiare të hartuar për forcimin dhe rritjen e besimit në sektorin bankar, ku përfshihej kufizimi i rritjes së ndërmjetësimit duke parandaluar huadhënien (dhe krijimin e mundshëm të një niveli të lartë të huave të papaguara) nga ana e Bankës së Kursimeve, të cilat përbënin mbi 50% të sektorit bankar, derisa ajo u privatizua në 2004. Pas privatizimit të Bankës së Kursimeve, aktivitetet bankare janë rritur, veçanërisht huat për sektorin privat janë shtuar me 30% gjatë vitit të kaluar. Në 2004, kreditë për sektorin privat janë shtuar fuqishëm dhe raporti kredi-depozita është rritur nga 15.7% në 2003, në 18% në 2004. Afërsisht 2/3 e kreditimeve të reja që shtriheshin edhe në 2004, kishin natyrë afatshkurtër dhe në valutë të huaj. Përqindja e interesit hua-depozitë për lekun qëndronte në 650 pikë në fundin e 2004-ës. Për USD dhe EUR, arriti në 703 dhe 681 pikë përkatësisht. Përveç bankave, huadhënia nëpërmjet institucioneve mikro-financiare dhe 130 Shoqërive të Kursimeve dhe Kreditimit, është një faktor efikas sepse u shërben atyre segmenteve të popullatës që nuk kanë akses të lehtë në financimin bankar. Megjithatë, mundësia më e madhe për kredi që gëzon tani sektori privat, kërkon përmirësimin e monitorimin e kujdesshëm të sektorit financiar në përgjithësi. Përqindjet e ndërmjetësimit po rriten, por prapë mbeten relativisht të ulëta. Nga 46.5% e PBB-së që mbahej si depozita nga bankat në fund të 2004-ës, vetëm 8.5% u shfrytëzua si kredi për sektorin privat vendas. Bankat tregtare përballen me

rreziqe të mëdha dhe evidentimi i klientëve të besueshëm është i vështirë. Si rezultat, likuiditeti i sistemit bankar mbetet i lartë dhe bankat priren të ruajnë likuiditet të tepërt në lek dhe valutë të huaj. Edhe pse në treg operojnë 16 banka, vetëm gjysma e tyre janë aktive në dhënien e huave për ekonominë. Niveli i ulët i ndërmjetësimit financiar vazhdon të jetë pengesë për sektorin privat në Shqipëri. Rritja e huave nga bankat për sektorin privat vendas, sidomos për SME-të, mbetet një sfidë e vështirë.

Sektori i sigurimeve po zgjerohet. Faza e parë e privatizimit të INSIG-ut u krye në tetor 2003, ku 39% e aksioneve të kompanisë shqiptare të sigurimeve u transferuan tek Korporata Ndërkombëtare e Financave (IFC) dhe Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH). IFC dhe BERZH do ta marrin INSIG-un nën vëzhgim për një periudhë tranzitore prej 1-2 vite, me objektivin që të tërheqin një investitor strategjik që do të ishte i interesuar në 51% të aksioneve. Në vjeshtën e 2004-ës, 5 kompani të reja sigurimesh morën licenca për sigurim të jetës dhe të përgjithshëm, duke e dyfishuar në dhjetë numrin e kompanisë në këtë sektor. Mbikëqyrja dhe rregullime të sigurimeve duhen forcuar më tej, në mënyrë që sigurimi të luajë një rol më qendror në zhvillimin ekonomik të vendit.

Banka e Shqipërisë e ka forcuar shumë kapacitetin mbikëqyrës përmes zbatimit të një procesi mbikëqyrës bazuar në rreziqe; megjithatë struktura mbikëqyrëse ka nevojë për përmirësime të mëtejshme. Është ngritur një Agjenci e Sigurimit të Depozitave dhe po funksionon siç duhet. Progres domethënës është bërë në përmirësimin e sistemit të pagesave. Sistemi i ri i ndërbankar për pagesat e mëdha është vënë në punë që në janar 2004 dhe sistemi plotësisht i automatizuar pritet të përfundohet nga mesi i vitit 2005. Përveç kësaj, përpjekje po bëhen për forcimin e kuadrit ligjor për procedurat e insolvencës dhe falimentimin. Një regjistër kolaterali për pasuritë e luajtshme ka funksionuar mjaft mirë për më shumë se tre vite.

Konkurrueshmëria e ekonomisë

Konkurrueshmëria e një ekonomie varet nga progresi në vendosjen e parimeve të tregut dhe arritja e një kuadri të qëndrueshëm makroekonomik, duke lejuar agjentët ekonomikë që të marrin vendime në një klimë të parashikueshme. Gjithashtu varet edhe nga sasia e kapitalit njerëzor dhe fizik, përfshi këtu infrastrukturën. Ndërmarrjes shtetërore duhet të ristrukturohen dhe të gjitha ndërmarrjet duhet të përmirësojnë efikasitetin e tyre. Për më tepër, sa më tepër akses të jenë ndërmarrjet në financimin e jashtëm, aq më i suksesshëm do të jetë

ristrukturimi dhe përtëritja e tyre dhe aq më i lartë do të jetë kapaciteti i tyre për t'u përshtatur. Në përgjithësi, sa më e përgatitur të jetë ekonomia që të ndërmerret detyrimet kontraktuale të një MSA-je dhe të anëtarësimit të ardhshëm, aq më e lartë do të jetë shkalla e integritit ekonomik drejt Bashkimit Europian para aderimit. Vëllimi dhe shumëllojshmëria e produkteve të tregtuara me Shtetet Anëtare të BE-së na japin shembuj të tillë.

Shqipëria ka arritur një masë të mjaftueshme stabiliteti makroekonomik dhe mekanizmat e tregut por funksionojnë gjerësisht për të lejuar një akordim efikas të burimeve.

Niveli arsimor i Shqipërisë – mesatarisht 8.5 vite shkollim – është më e ulët se shumica e ekonomive në tranzicion. Regjistrimi në shkollat e mesme ka rënë ndjeshëm (38.7% në 2002 kundrejt 79% në 1990) dhe është më e ulët sesa e vendeve të tjera të rajonit. Shkalla e regjistrimeve bien në mënyrë drastike pas tetë viteve të arsimimit të detyrueshëm. Gjithashtu ka edhe variabla të gjera midis rajoneve dhe niveleve të të ardhurave. Shpenzimet publike për arsimin kanë rënë, nga 5% të PBB-së në 1991, në 2.8 të PBB-së në 2003³². Edhe pse kjo prirje negative është si shkak i rënies së përgjithshme në shpenzimet publike, shpenzimet për arsimin publik në lidhje me PBB-në janë më të ulëta sesa në vendet e tjera të rajonit.

Papunësia në Shqipëri mbetet e lartë, por besueshmëria e të dhënave të papunësisë mbetet shumë e kufizuar për shkak të vështirësive serioze për ta matur me saktësi. Sipas statistikave zyrtare, në fund të vitit 2004, papunësia e regjistruar arriti në 14.1%. Kjo përfaqëson një progres të lehtë krahasuar me një vit më parë, kurse treguesi ishte 15%. Për shkak të mospërputhjeve të theksuara të burimeve të të dhënave, shkalla e lartë e emigracionit të jashtëm dhe e punësimit informal ose të nën-punësimit, është e vështirë të vlerësohet se deri në ç' masë ndryshimet në përqindjen e papunësisë pasqyrohen në rritjen ekonomike.

Industria e kufizuar, me përjashtim të ndërtimit, ka rënë edhe më tej. Në 2004 llogaritet më pak se 10% të PBB-së. Nga ana tjetër, pjesa që zinin ndërtimet në PBB rritej më tepër deri në 9%. Pjesa e bujqësisë në PBB u zvogëluar në 24%. Të dhënat e punësimit në bujqësi ndryshojnë shumë. Burimet zyrtare pas disa rregullimeve dhe llogaritjeve të reja, konstatojnë 526 000 person atë punësuar në bujqësi, por kjo është më tepër një shifër e përafërt me hamendje – llogaritjet e mëparshme e çonin këtë shifër në 761 000. Kjo është më shumë se gjysma e punësimit total dhe rreth 1/3 e krahut të punës. Papunësia afatgjatë është mjaft më e ulët në zonat bregdetare. Përqindja e papunësisë së femrave ia kalon

meshkujve vetëm në zonat urbane. Po t'i supozojmë faktorët e tjerë të barabartë, rreziku i papunësisë është më i lartë për meshkujt me moshë 15-34 vjeç dhe për femrat me moshë 15-24. Në vija të përgjithshme, duket se as arsimi fillor dhe as ai mesëm nuk kanë ndonjë peshë thelbësore në punësim.

Progresi drejt punësimit dhe politikës sociale është pjesë e punës drejt standardeve europiane. Përpjekjet e mëtejshme për të vendosur të drejtat ekonomike dhe sociale, si dhe promovimi i punësimit dhe nxitja e dialogut social do të kontribuojnë në përmirësimin e qeverisjes dhe performancës ekonomike.

Numri i përdoruesve të telefonisë celulare ka vazhduar të rritet në 2004. Sipas operatorëve të telefonisë celulare, 80% e territorit të Shqipërisë që i korrespondon 90% të popullatës totale, tashmë mbulohet nga ky shërbim. Depërtimi i linjave fikse qëndroi në 7%. Vetëm 12.4% e rrugëve shqiptare janë të shtruara.

Sektori bujqësor përbënte 24% të PBB-së në 2004 dhe vazhdon të ketë një funksion të rëndësishëm si zbutës ekonomik dhe social, duke zvogëluar varfërinë dhe papunësinë. PBB e bujqësisë regjistroi një rritje prej 3% në 2004. Pjesa më e madhe e rritjes i atribuohet industrisë përpunuese të mallrave ushqimore e cila regjistroi një rritje prej 11% në 2004. Në këtë rritje kontribuuan kryesisht sektorët tradicionalë si vaji i ullirit, drithërat, produktet e baxhos, mielli, vera dhe birra. Megjithatë, roli i industrisë së brendshme për promovimin e rritjes bujqësore është akoma i vogël meqë pjesa më e madhe e lëndëve të para për përpunim si gruri, elbi dhe mishi, importohen nga jashtë. Në 2004, investimet në industrinë përpunuese të mallrave ushqimore u rrit me 10%. Investimet kryesore shkuan për industrinë e qumështit, përpunimit të frutave dhe ujërave minerale. Përqindja e sektorit të shërbimeve në ekonomi vazhdoi të rritet deri në 46%, ndërkohë që bujqësia ra me 24% edhe pse mbetet akoma në shkallë të gjerë. Industria dhe ndërtimet kanë qenë të qëndrueshme, përkatësisht me 10% dhe 9.5% të PBB-së totale.

Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (SME-të) përbëjnë një pjesë të rëndësishme të ekonomisë shqiptare. Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme në industri dhe ndërtime, janë gjeneruesit kryesorë të rritjes së punësimit krahasuar me sektorët e tjerë jobujqësorë. Ndërmarrjet mikro dhe të vogla zënë 71% të qarkullimit total në sektorët jobujqësorë dhe kontribuojnë në 75% të punësimit në sektorët jobujqësorë.

Asnjë progres nuk është raportuar për sa i përket përmirësimit të aksesit të SME-ve në instancat kredituese, pasi fondi garanci i huave nuk është operacional. Për të bërë

progres në këtë fushë, Shqipëria duhet të gjejë rekurse të saj financiare për të kredituar SME-të. Asnjë progres s'është bërë sidomos në reduktimin e varësisë nga mbështetja e jashtme që sigurohet nga donatorët e huaj për adresimin e shkaqeve që çojnë në eksenin e dobët për kreditim. Prandaj nevojitet forcimi i kuadrit ligjor dhe mbikëqyrës për sektorët bankarë dhe të sigurimeve, si dhe përmirësimi i kuadrit ligjor, rregullator dhe administrativ për hyrjen, operimin dhe daljen e bizneseve.

Progres është bërë në vendosjen e politikave të konkurrencës. Megjithatë, për t'i shërbyer nevojave të tregut në mënyrën e duhur dhe për t'iu siguruar kompanive kushte operuese të hapura, transparente dhe konkurruese dhe për të mbrojtur interesat e tregut dhe konsumatorëve, më tepër duhet bërë për të rritur njohuritë mbi parimet e konkurrencës. Përveç kësaj, legjislacioni ekzistues ka nevojë për përmirësime për ta bërë efikas kontrollin mbi konkurrencën.

Miratimi i Ligjit për Ndihmën Shtetërore në prill 2005, ishte një hap pozitiv, por, në përgjithësi, kuadri ligjor i ligjeve të ndihmës shtetërore dhe i parashikimeve zbatuese, duhet të rishikohet dhe të përmirësohet.

Shqipëria ka një regjim tregtar mjaft të liberalizuar. Megjithatë, gjatë vitit 2004 u duk qartë që për arsye fiskale dhe ekonomike, Shqipëria nuk është në gjendje të përballonte uljen e tarifave në kuadrin e angazhimeve në OBT. Që nga janari 2004, Tarifa Doganore Shqiptare nuk pasqyronte më uljen e parashikuar të tarifave në paketën aderuese në OBT. Prandaj, Shqipëria aplikoi në janar 2005 për një zgjatje të periudhës për zbatimin e uljeve të tarifave për produktet si pijet alkoolike, birrën, produktet plastike, kozmetikën, lëndën drusore, letrën, mobiljet dhe çelikon përtej vitit 2004 i vendosur si afat në traktatin e pranimit të Shqipërisë në OBT. Në mars 2005, OBT e pranoi kërkesën dhe Shqipëria tashmë është e angazhuar të respektojë periudhën e pandryshueshme tranzitore që përfundon në 2009.

Në përgjithësi, Shqipëria ka bërë progres me liberalizimin e mëtejshëm të tregtisë dhe me qasjen e duhur për problemet që lindin në kontekstin e angazhimeve në OBT. Megjithatë, duhet akoma që të forcohen kapacitetet në menaxhimin e tregtisë dhe promovimin e eksporteve.

Ekonomia shqiptare demonstroi një nivel të ulët të tregtisë me jashtë, krahasuar me vendet e tjera të rajonit. Vlera e eksporteve dhe importeve të mallrave dhe shërbimeve përbën 64% të PBB-së, çka tregon se ekonomia është akoma relativisht e mbyllur për sa i takon tregtisë. BE mbetet partneri kryesor tregtar i Shqipërisë, duke përfaqësuar 74% të totalit të importeve shqiptare dhe afërsisht

85% të totalit të eksporteve. Për sa i takon tregtisë me BE, asnjë progres nuk është bërë nga Shqipëria në diversifikimin e eksporteve drejt BE-së, që akoma konsistojnë në lëndët e para. Përveçse është anëtare e OBT-së, Shqipëria ka hyrë në marrëveshje dypalëshe të tregtisë së lirë (MTL) me ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë, Kroacinë, Bullgarinë, Kosovën (nën Rregulloren 1244 të KS) Rumaninë, Serbi-Malin e Zi, Moldavinë dhe Bosnjë-Hercegovinën. Këto MTL gjeneruar përfitime për eksportet shqiptare në rajon të cilat u rritën me 18% në 2004. Megjithatë, eksportet në tetë shtetet MTL si përqindje e totalit të eksporteve shqiptare mbeten të qëndrueshme midis viteve 2003 dhe 2004, në afërsisht 6% të totalit eksportues të Shqipërisë.

Eksportet e Shqipërisë përbëhen më tepër nga prodhime që kërkojnë shumë krah punë. Mallrat industriale përbënin 88% të eksporteve shqiptare të orientuar drejt BE-së, krahasuar me 56% me pjesën tjetër të botës, ku BE ka 95% të të gjitha eksporteve industriale. Mallrat ushqimore, lëndët e para bujqësore dhe industriale, përbënin 1/3 e eksporteve në pjesën tjetër të botës dhe 12% të eksporteve të orientuara drejt BE-së. Prodhimet e industrisë së lehtë, kryesisht prodhuar nga krah pune i pakualifikuar (lëkure dhe veshmbathjeje) përbëjnë rreth 85% të eksporteve të mallrave industriale të destinuara për BE-në. Tekstilet dhe veshmbathja, bashkë me prodhimet e lëkurës dhe për këmbët, luajnë një rol të rëndësishëm në eksportet e Shqipërisë drejt BE-së; përbëjnë 64% të eksporteve të Shqipërisë drejt BE-së. Kostot e larta të prodhimit dhe cilësia e dobët e infrastrukturës, e pengojnë zhvillimin e tregtisë. Përqindja e eksportit në PBB është ndër më të ulëtat midis ekonomive në tranzicion. Pavarësisht nga hapja formale e regjimit tregtar shqiptar, vetëm pak më shumë se 1/5 e PBB-së gjenerohet nga eksportimi i mallrave dhe shërbimeve, një shifër e ulët në terma ndërkombëtarë. Në krahasim me vendet e tjera të Europës Juglindore, Shqipëria është mjaft mbrapa për sa i takon koston prodhuese.

2.3 Vlerësim i përgjithshëm

Ekonomia e Shqipërisë operon deri në njëfarë mase brenda kuadrit të parimeve të tregut funksionues. Përpjekje të mëtejshme reformuese janë të nevojshme për adresimin e mangësive në konkurrueshmërinë e ekonomisë.

Rritja ka vazhduar e sigurt dhe trysnia e inflacionit është mbajtur nën kontroll. Deficiti i llogarive rrjedhëse është ngushtuar. Konsolidimi fiskal ka vazhduar dhe deficiti buxhetor ka pësuar rënie. Progresi në reformën e administratës publike ka vazhduar dhe kapaciteti administrativ i administratës tatimore është përmirësuar. Në fushën e kontrollit publik financiar dhe auditimit të brendshëm, është bërë njëfarë progresi. Privatizimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme ka përfunduar. Shitja e Bankës e Kursimeve u mbyll në 2004 dhe privatizimi i Albtelekomit nisi në fillim të vitit 2005. Mbikëqyrja e kujdesshme është forcuar përmes zbatimit të një procesi mbikëqyrës bazuar në rreziqe. Tregu i punës cilësohet relativisht fleksibël.

Megjithatë, qeverisja e sektorit publik mbetet për t'u forcuar dhe privatizimi i ndërmarrjeve të mëdha ka pësuar vonesa. Performanca e sektorit financiar në kanalizimin e kursimeve drejt investimeve produktive ka shënuar përmirësime së fundmi, por prapëseprapë mbetet e dobët. Vendosja dhe zbatimi i të drejtave të pronësisë mbetet i vështirë, duke dëmtuar potencialin për investime dhe aktivitete ekonomike. Krijimi i sipërmarrjeve të reja vazhdoi të përballet me pengesa si infrastruktura e dobët, legjislacioni i mangët dhe zbatimi i dobët i legjislacionit tatimor. Problem mbetet konkurrenca e pandershme nga bizneset që operojnë në ekonominë e zezë. Niveli arsimor vazhdon të jetë relativisht i ulët dhe krahu i punës i kualifikuar i pakët.

3. Standardet europiane

Ky kapitull bën një vlerësim të zbatimit të Procesit të Stabilizim-Asociimit. Përveç vlerësimit të zhvillimeve përkatëse të fushave kyçe që nga raporti i 2004-ës dhe Partneritetet Europiane, kjo pjesë jep një vlerësim të përgjithshëm të progresit të Shqipërisë drejt përafrimit të standardeve evropiane dhe se çfarë mbetet për t'u bërë.

Në këtë pjesë shtjellohet edhe një vlerësim për kapacitetet administrative të Shqipërisë në aspekte të ndryshme. Shqipëria duhet të forcojë institucionet, kapacitetet menaxhuese, sistemin administrative dhe gjyqësor në nivel kombëtar dhe rajonal, me synim arritjen e progresit të mëtejshëm në përmbushje të standardeve europiane. Në nivel të përgjithshëm, kjo kërkon një administratë publike të qëndrueshme dhe mirëfunksionuese, e ndërtuar mbi një shërbim civil efikas dhe asnjans, dhe një sistem gjyqësor të pavarur dhe efikas.

Në raportin 2004, për çështjet e **tregut të brendshëm**, Komisioni konstatoi se:

“Kquadri ligjor shqiptar për lëvizjen e mallrave, shërbimeve dhe kapitalit, si dhe të drejtës për vendosje, është në teori relativisht i hapur dhe jodiskriminues. Megjithatë, mangësitë e administratës si dhe problemi serioz i korrupsionit, vazhdojnë të kenë efekt negativ në zbatimin në praktikë të këtyre ligjeve. Kjo gjë ndikon për keq edhe tek lidhjet tregtare. Ka raportime të shpeshta të zbatimit të ligjit në mënyrë favorizuese/diskriminuese, për shembull në fushën e tatimit të korporatave. Mungesa e garancive në lidhje me zbatimin e drejtë të procedurave, është një problem që duhet zgjidhur urgjentisht.

Njëfarë progresi është arritur në përmirësimin e legjislacionit dhe bërja palë në konventa ndërkombëtare për fsuhat e tregut të brendshëm. Megjithatë, kapacitetet administrative, në këtë fazë, janë tepër të dobëta për të garantuar ekzekutimin e duhur të legjislacionit dhe rrjedhimisht nuk garantojnë që Shqipëria do të përmbushë kërkesat e MSA-së. Përpyekje duhen bërë sidomos në fushat e doganave dhe prokurimit publik.

Në lidhje me politikat sektoriale:

“Përpyekjet për ristrukturimin e sektorëve kyçë të ekonomisë shqiptare si për shembull industria, transporti, mjedisi, bujqësia, energjia dhe telekomunikacioni, duhet të vazhdojnë dhe të përforcohen më tej në planin afatshkurtër dhe afatmesëm. Industria shqiptare vazhdon të jetë e prapambetur dhe sektori MSE,

edhe pse po zhvillohet, ka nevojë të konsolidohet dhe të rritet më shumë në një bazë të qëndrueshme. Edhe pse janë bërë disa hapa për përmirësimin e trafikut ajror dhe sigurisë aeroportuale, infrastruktura rrugore dhe hekurudhore vazhdon të jetë e amortizuar. Në fushën e menaxhimit të ujërave, disa strategji janë përgatitur; tashmë duhen vënë në zbatim. Në lidhje me mjedisin, nuk është vënë re ndonjë përmirësim domethënës i situatës së përgjithshme, pavarësisht disa përpjekjeve për miratimin dhe ekzekutimin e disa ligjeve, përfshi këtu ndëshkimet për ndotësit. Progres po bëhet në adresimin e problemeve të vazhdueshme në sektorin energjetik, por do të duhet njëfarë kohe para se Shqipëria të stabilizojë situatën në këtë fushë.”

Dhe në lidhje me drejtësinë, lirinë dhe sigurinë:

“Fusha e drejtësisë, lirisë dhe sigurisë, mbetet një çështje mjaft shqetësuese. Vullneti i plotë politik dhe angazhimi i të gjithë aktorëve (organet e rendit, gjyqësori, prokuroria) janë elemente thelbësore për arritjen e progresit domethënës në këtë fushë mjaft sfiduese. Këto elemente nuk kanë qenë të pranishme sa duhet gjatë periudhës raportuese, prandaj edhe rezultatet kanë qenë të pakta. Shqipëria ka vazhduar të ndër marrë veprime sporadike kundër krimit të organizuar, por nuk ka siguruar ndjekjen e duhur penale për shumë nga të dyshuarit e arrestuar. Nevojiten veprime më të vendosura dhe thelbësore në këtë drejtim. Shqipëria duket se ka bërë progres në lidhje me kontrollin e migracionit/trafikut të paligjshëm drejt BE-së përmes detit Adriatik dhe Jon, por ngjarjet e fillimit të janarit treguan kërkohen më shumë përpjekje. Hapa pozitivë kanë qenë negociatat për një Marrëveshje Ripranimi Komunitar dhe përfundimi i një marrëveshjeje të tillë me BE-në dhe vende të tjera. Megjithatë, menaxhimi i kufijve vazhdon të ketë nevojë për përmirësime rrënjësore. Progres i kufizuar është arritur në luftën kundër pastrimit të parave. Disa hapa janë ndërmarrë në luftën kundër prodhimit të drogës dhe është rritur sasia e drogës së kapur. Shqipëria duhet të bëjë shumë më tepër kundër trafikut të drogave të forta si heroina dhe kokaina.

Shqipëria ka vazhduar të mbajë një pozicion konstruktiv në luftën kundër terrorizmit. Megjithatë, burimet e kufizuara e pengojnë aftësinë e Shqipërisë që të përballlet me efikasitet me kërcënimet terroriste.”

3.1 Tregu i brendshëm

3.1.1. Lëvizja e lirë e mallrave

Vërehet progres në fushën e **standardizimit dhe certifikimit**.

Adoptimi I standardeve Europiane ecën me një hap të kënaqshëm. Drejtoria e përgjithshme e Standardizimit (DPS) administron standardizimin dhe certifikimin në Shqipëri. Nga mesi i vitit 2005, DPS ka transpozuar 6856 ose 57% të standardeve europiane (EN) të miratuara nga CEN si standarde shqiptare. Shqipëria është përqendruar kryesisht në miratimin e atyre standarteve europiane të harmonizuara që japin mundësinë e njëjtësimit të kërkesave rregullatore, në mënyrë që të përgatitet për transpozimin dhe zbatimin e Direktivave të Përqasjes së Re. Megjithatë, ministritë e linjës që janë përgjegjëse për Direktivat e Përqasjes së Re dhe Globale si edhe për ato të Përqasjes së Vjetër, duhet që të shtojnë përpjekjet për të transpozuar *Acquis Communautaire* në mënyrë që të përfitojnë në mënyrë të plotë nga standardet që mundësojnë njëjtësimin e kërkesave rregullatore. DPS është e përqendruar në detyrat e saj dhe zotëron kompetencat për të përmbushur misionin që ka: Në mars 2005, DPS u vlerësua me ISO 9001:2000 certifikata për sistemin cilësor të manaxhimit. Ajo është anëtarësuar në Komitetin European për Standardizimin (CEN) dhe në Komitetin European për Standardizimin Elektroteknik (CENELEC), megjithëse e ka të vështirë që të sigurojë nga buxheti financimin që të paguajë për kuotizacionin e anëtarësimit. Ka pasur një rritje në shitjen e standardeve EN me 36% në mesin e vitit 2005 krahasuar me 25% në vitin 2003, megjithëse kjo nuk siguroi të ardhura të mjaftueshme për të mbuluar kuotizacionin e anëtarësimit në CEN/CENELEC. Sektori i certifikimit në DPS kryen certifikim vullnetar të produkteve. Shqipëria ka planifikuar të ndajë funksionin e certifikimit nga ai i standardizimit nga fundi i vitit 2007. Ligji për Standardizimin i vitit 1999 është ende në fuqi (me ndryshimet përkatëse në lidhje me ligjin për akreditimin) dhe do të ndryshohet kur funksionet e certifikimit të ndahen nga ato të standardizimit. Plani kombëtar për përafrimin e legjislacionit dhe zbatimin e MSA-së parashikon ngritjen e një Bordi për Standardizimin që do të monitorojë veprimtarinë e përditshme të GPS. Një dekret i qeverisë për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së akreditimit hyri në fuqi më shkurt 2004, duke siguruar ndarjen e funksioneve të akreditimit nga ato të standardizimit dhe certifikimit. Drejtoria e Akreditimit është tani nën përgjegjësinë e Ministrisë së Ekonomisë. Në shtator 2004, ajo nisi të funksionojë në mënyrë të pavarur dhe numri i punonjësve u rrit nga dy në pesëmbëdhjetë. Stafi specialist i Drejtorisë ka bërë trajnime të kufizuara. Në fushën e metrologjisë nuk është miratuar asnjë ligj i ri.

Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë dhe Kalibrimit (DPMK) është institucioni përgjegjës për metrologjinë shkencore, ligjore dhe industriale në Shqipëri dhe i raporton Ministrisë së Ekonomisë.

Strategjia afatgjatë kombëtare (2005-2015) mbi zhvillimin e sistemit të metrologjisë, si edhe ndryshimet e Ligjit për Metrologjinë janë ende nën diskutim. Megjithatë, organizimi i DPMK është forcuar nëpërmjet ngritjes së një departamenti të ri ligjor dhe rekrutimit të pesë specialistëve të rinj.

Në total DPMK ka gjithsej një personel prej 95 vetash. Stafi teknik ka marrë një trajnim shumë të kufizuar. Gjatë dy viteve të fundit, operatorët e biznesit kanë treguar një interesim gjithnjë e në rritje për kalibrimin, gjë e cila i atribuohet veprimeve të ndërmarra nga DPMK për të rritur ndërgjegjësimin e operatorëve të tregut mbi metrologjinë dhe kalibrimin.

Megjithatë, ajo nuk është në gjendje të përmbushë kërkesat, pavarësisht nga hapat pozitive që janë ndërmarrë nga Drejtoria e Mbrojtjes së Konsumatorit; sistemi i **mbikëqyrjes së tregut** është në fillimet e tij dhe për këtë fushë nevojitet një progres i mëtejshëm si për shembull: Drejtoria nuk është e autorizuar për të marrë veprime ligjore në rastet e shkeljes së të drejtave të konsumatorëve. Punonjësit e Drejtorisë si edhe operatorët e tregut janë trajnuar mbi çështjet e mbikëqyrjes së tregut. Drejtoria ka marrë disa masa për të përmirësuar ndërgjegjësimin e konsumatorëve mbi të drejtat e tyre dhe për të lehtësuar në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve. Drejtoria ka përgatitur modele të gatshme ankesash që mund të plotësohen nga operatorët e tregut dhe që mund të përdoren për tu paraqitur në gjykatë.

Në fushën e **mbrojtjes së konsumatorit**, ekziston vetëm një organizëm i pavarur që është Shoqata Shqiptare e Konsumatorëve, që luan rol aktiv në informimin e konsumatorëve dhe në ndërgjegjësimin për të drejtat që ata kanë. Parimisht, Shoqata duhet të jetë në gjendje që të trajtojë dhe të ndjekë ankesat e konsumatorëve si edhe të fillojë procedimin gjyqësor kundër procedurave, shitësve, furnizuesve dhe ofruesve të shërbimeve në raste shkeljesh. Shoqata ka kryer një punë të mirë në identifikimin në treg të atyre produkteve që nuk kanë qenë të përshtatshme për përdorim.

Anëtarët e kësaj shoqate kanë ngritur grupe këshillimore në të gjithë vendin për të përhapur informacion mbi të drejtat dhe detyrimet e konsumatorëve.

Kjo forcon gjithashtu përpjekjet e administratës publike për të monitoruar qarkullimin në treg të produkteve të pasigurta.

Megjithatë, Shoqata është e varfër në personel dhe për këtë arsye operacionet e saj janë të kufizuara. Drejtoria e Mbrojtjes së Konsumatorit, që është një organizëm i ndarë nga Ministria e Ekonomisë, ka katër specialistë. Drejtoria përqendrohet kryesisht në hartimin e legjislacionit dhe në dhënien e këshillave mbi politikat. Në përgjithësi në fushën e standardizimit dhe të akreditimit vihet

re se është bërë një farë progresi. Shqipëria ka vijuar me miratimin e Standardeve Europiane, si edhe funksionet e akreditimit janë ndarë duke e përforcuar Drejtorinë e Akreditimit me personel të ri.

Megjithatë, Drejtoria e sapokrijuar e Akreditimit duhet të tregojë aftësinë e saj për të përmbushur funksionet dhe duhet të fuqizohet për sa i takon si strukturës fizike ashtu edhe kompetencave teknike dhe administrative të personelit. Sfidat kryesore për Drejtorinë janë që të ngrihet një strukturë e re operationale së me një procedurë të brendshme cilësore si edhe të miratohet një plan pune gjithëpërfshirës për anëtarësimin e ardhshëm të Shqipërisë në Bashkimin European për Akreditim (EA). Shqipëria duhet të bëjë progres të mëtjshëm në miratimin e standardeve evropiane si edhe të përshpejtojë përpjekjet për tu bërë anëtare me të drejta të plota në organizmat evropiane të standardizimit si CEN, CENELEC dhe ETSI. Një progres i mëtjshëm nevojitet në fushën e akreditimit në mënyrë që Shqipëria të jetë në gjendje të përmbushë kërkesat e EA. Ndërgjegjësimi i operatorëve ekonomikë mbi përfitimet nga akreditimi duhet të rritet edhe më tej. Një fushë në të cilën është e qartë që duhen bërë më shumë përpjekje lidhet me rritjen e ndërgjegjësimit të sektorit privat mbi përfitimet që sjell standardizimi dhe certifikimi për biznesin dhe tregtinë. DPS duhet të rrisë gjithashtu bashkëpunimin me ministritë e linjës. Sistemi i certifikimit të palëve të treta për kërkesat rregullatore kërkon aftësi të mjaftueshme teknike dhe pavarësi. Hapa të mëtjshme duhen marrë edhe për përmbushjen e afatit në vitin 2007 për ndarjen e funksioneve të certifikimit dhe të standardizimit.

Në përgjithësi, një progres shumë i kufizuar mund të raportohet në fushën e metrologjisë. Po të njëjtët inspektorë të DPMK janë përgjegjës si për certifikimin dhe për funksionet e mbikëqyrjes së tregut. Nevojitet ndarja e këtyre funksioneve në mënyrë që të shmangen konfliktet e interesit. Laboratorët ekzistues nuk kanë hapësirën e nevojshme; janë të pajisura në mënyrë të papërshtatshme dhe nevojitet që të përmirësohen në mënyrë që ti përmbushin në mënyrë të kënaqshme të gjithë testimet që nevojiten për certifikimin e produkteve.

Shumë më tepër duhet bërë për të pasur një sistem funksional të mbikëqyrjes së tregut deri në fundin e vitit 2006. Baza ligjore duhet të përmirësohet, përfshirë ligjin mbi mbrojtjen e konsumatorit të vitit 2003. Duhet të krijohen strukturat e nevojshme administrative si edhe duhet të përmirësohen njohuritë teknike mbi mbrojtjen e konsumatorit në shkallë vendi si edhe mbi mbikëqyrjen e tregut. Nevojitet një strategji kombëtare për mbikëqyrjen e tregut si edhe një bashkërendim mes Drejtorisë së Mbrojtjes së Konsumatorit dhe autoriteteve të tjera që merren me detyrat që kanë lidhje me mbikëqyrjen e tregut.

Pavarësisht nga disa hapa pozitive nga ana e Drejtorisë së mbrojtjes së konsumatorit dhe të Shoqatës shqiptare për mbrojtjen e konsumatorit, ky i fundit mbetet ende jo shumë i informuar për të drejtat e tij. Akoma më tej, shërbimi

doganor dhe gjyqësori nuk kanë specialistë të trajnuar që kuptojnë synimet e ligjit mbi mbikëqyrjen e tregut dhe zbatimin e tij.

3.1.2. Qarkullimi i personave, shërbimeve dhe e drejta e vendosjes

Shqipëria ka shënuar përpjekje të mëdha për të hapur ekonominë e saj për kompanitë dhe investimet e huaja. Liberalizimi po shtrihet progresivisht edhe tek shërbimet, përfshirë fusha kryesore si sektorët financiarë dhe të telekomunikacioneve.

Shqipëria vazhdon të përballet me probleme të konsiderueshme në lidhje me emigrimin. Njohja e ndërsjellë e kualifikimeve profesionale në Shqipëri, përgjithësisht nuk është e kufizuar.

Vendi vazhdon të ketë një regjim liberal porsa i takon qarkullimit të shërbimeve dhe përgjithësisht vërehet një trajtim i barabartë mes kompanive vendase dhe atyre të huaja në lidhje me të drejtën e vendosjes. Nuk ka pasur ndonjë progres të veçantë në lidhje me **qarkullimin e personave**. Emigrimi nga Shqipëria mbetet një problem. Në nëntorin e vitit 2004, qeveria aprovoi strategjinë kombëtare të emigrimit, pasuar nga plani kombëtar i veprimit (shikoni *Seksionin 3.3.1*). Strategjia parashikon veprime për të nxitur rikthimin në Shqipëri të emigrantëve të kualifikuar profesionalisht. Ndërkohë që çdo masë veprimi për të ulur largimin e 'trurit' duhet inkurajuar, është e qartë që një progres i matshëm do të ndodhë vetëm kur të shënohet një përmirësim i përgjithshëm i kushteve social ekonomike dhe i besimit politik. Për sa i takon sistemit të sigurimeve shoqërore, legjislacioni aktual në Shqipëri i mundëson punëtorëve të huaj që të zgjedhin midis sistemit të sigurimeve shoqërore në Shqipëri dhe atij të vendit të tyre të origjinës.

Në fushën e njohjes së ndërsjellë të kualifikimeve profesionale, përgjithësisht nuk ka kufizime të bazuara në kombësinë, me përjashtim të noterëve dhe të juristëve që kërkohet që të kenë shtetësinë shqiptare. Kërkesa speciale për njohjen e diplomave të marra jashtë shtetit ekzistojnë për disa profesione të caktuara, si për shembull mjekët, infermieret, arkitektët dhe inxhinierët.

Legjislacioni shqiptar është relativisht i hapur porsa i përket **të drejtës së vendosjes**. Firmat e BE-së mund të vendosen në Shqipëri duke ndjekur të njëjtat procedura si kompanitë shqiptare. Megjithatë ka edhe diskriminime: taksa e pullës për regjistrimin ligjor të një kompanie është rreth 35 EUR kompanitë e huaja, krahasuar me rreth 11 EUR për kompanitë shqiptare. Gjithashtu, kompanitë e huaja duhet të paguajnë një shumë prej 70 eurosh që të noterizojnë dokumentet e nevojshme. Ministria e Ekonomisë duhet të modifikojë legjislacionin aktual në lidhje me të drejtën e vendosjes në mënyrë që të përqafojë në mënyrë të plotë parimet e trajtimit të barabartë dhe të bëjë një ndarje të qartë

mes operatorëve që ofrojnë shërbime të përkohshme dhe atyre që ofrojnë shërbime në anë të një vendosjeje të përhershme.

Duhet të vlerësohet gjithashtu edhe proporcionaliteti i disa prej kërkesave ekzistuese për ofrimin ndërkufitar të shërbimeve.

Për më tepër, Shqipëria duhet të marrë masa që të parandalojë trajtimin e saj përgjithësisht liberal mbi vendosjen e cili minohet nga zbatimi i dobët i legjislacionit dhe nga procedurat e paqarta.

Në fushën e shërbimeve, Shqipëria duhet të garantojë që zotimet e saj GATS të kenë një përputhshmëri sa më të madhe me ato të Bashkimit Europian. Për këtë qëllim, Shqipëria duhet të vazhdojë të bashkëpunojë dhe të bashkërendojë punën e saj ngushtësisht me Komisionin, veçanërisht për sa i takon axhendës së zhvillimit të Dohas.

Shqipëria ka rregulla mjaft liberale për sa i takon fushës së **Lirisë për të ofruar shërbime ndërkufitare**. Këto rregulla janë shtrirë kohët e fundit edhe në sektorin e telekomunikacioneve me hapjen e tregut në këtë sektor, që nga fillimi i vitit 2005.

E drejta shqiptare i mundëson kompanive të huaja të sigurimit që të ofrojnë shërbime për mbulimin e rreziqeve që u ndodhin shtetasve të huaj në territorin shqiptar, pa kërkesën që këto kompani të vendosin një filial në Shqipëri. Nuk ka asnjë kufizim praktik për tregtinë e elektronikës. Progres vihet re në sektorin bankar, me privatizimin e suksesshëm të Bankës së Kursimeve në korrikun e vitit 2004, që rezultoi në një rritje të aktivitetit bankar, veçanërisht i hapur për sektorin privat; shihet si i nevojshëm përmirësimi i monitorimit të kujdesshëm të sektorit financiar në përgjithësi. Shqipëria duhet të ngrejë autoritete mbikëqyrëse të pavarura dhe me personelin e duhur, për sektorët bankarë, të sigurimeve dhe të tregut të letrave me vlerë.

Për sa i takon shërbimeve postare, ligji ekzistues i vitit 1999 duhet të harmonizohet me *acquis*, veçanërisht për sa i takon zonës së rezervuar postare dhe rregullatorit të pavarur kombëtar. Çështje e të drejtave mbi pronën (*shikoni Seksionin B 1.2 të këtij raporti*) ka një ndikim të veçantë mbi të drejtën e vendosjes dhe për rrjedhojë tek investimet e huaja – prandaj duhet të trajtohet në mënyrë urgjente. Gjithashtu, çështja e zhvillimeve të përgjithshme social ekonomike duhet të adresohet në mënyrë që të ulët gradualisht niveli i konsiderueshëm i emigrimit.

3.1.3. Lëvizja e lirë e kapitalit

Asnjë zhvillim domethënës nuk është shënuar në fushën e **lëvizjes së kapitalit**. Regjimi mbi lëvizjen e kapitalit është vendosur në Rregulloren e nxjerrë në korrik

të vitit 2003 mbi veprimtarinë e shkëmbimeve valutore, bazuar në Ligjin për Bankën e Shqipërisë

dhe në Ligjin e vitit 1993 mbi Investimet e Huaja.

Këto ligje parashikojnë liberalizimin e investimeve të drejtpërdrejta që kryhen në kompanitë shqiptare dhe të investimeve të kryera në përputhje me ligjet shqiptare si edhe garantojnë rikthimin e plotë në vendin e origjinës të kapitalit të huaj fillestar që është investuar, si edhe të përfitimeve.

Nuk ka asnjë kufizim mbi investimin e brendshëm të drejtpërdrejtë përveç atyre që kanë lidhje me blerjen e pronave të paluajtshme nga të huajt, burimeve natyrore dhe monumenteve historike.

Ligji shqiptar për Investimet e Huaja ofron garanci për të gjithë të huajt (individë ose kompani) që dëshirojnë të kryejnë një aktivitet ekonomik në Shqipëri. Rrjedhja e kapitalit nuk kërkon më autorizimin e Bankës së Shqipërisë. Ato mund të transferohen nëpërmjet bankave të licencuara me tu kompletuar legjislacioni i duhur (arsyeja e transfertës, burimi, shuma, etj). Gjithë kategoritë e tjera të lëvizjes së kapitalit janë të kufizuara. Agjencia e Sigurimit të Depozitave është krijuar dhe funksionon në mënyrën e duhur. Progres i rëndësishëm është bërë në përmirësimin e **sistemit të pagesave** me futjen në korrik të vitit 2005 të Sistemit të shlyerjes së pagesave me vlerë të vogël. Ky sistem i siguruar nga Banka e Shqipërisë për bankat tregtare me qëllim shlyerjen e pagesave të klientëve, ka përmirësuar sistemin kombëtar të pagesave duke rritur shpejtësinë dhe sigurinë si edhe duke ulur kostot. Shqipëria mban ende kufizime në përputhje me Nenin XIV të Marrëveshjes FMN në formën e borxheve të papaguara nga pagesat e marrëveshjeve dypalëshe kooperative me një sërë vendesh. Megjithatë, në vitin 2004 borxhet e prapambetura me Hungarinë u fshinë dhe u barazuan bilancet me Republikën Çeke, me Republikën Sllovaqe dhe me Poloninë.

3.1.4. Doganat dhe tatimet

Shqipëria ka bërë një progres të konsiderueshëm në disa fusha të **regullave doganore**, ndërkohë që progresi në fusha të tjera ka qenë më i kufizuar. Administrata doganore shqiptare është nën varësinë e Ministrisë së Financave. Ajo ka një strukturë të centralizuar me tre shtresa organizative; departamente qendrore, drejtori rajonale dhe pika doganore në nivel lokal. Në vitin 2004, administrata doganore shqiptare nuk e arriti për pak që të përmbushte objektivin e vendosur për vitin fiskal, pasi mblodhi 98% të të ardhurave të planifikuara.

Megjithatë, rezultati ishte një rritje prej 11% krahasuar me vitin 2003.

Për më tepër, në janar-maj 2005, të ardhurat e mbledhura kapën shifrën 101% të të ardhurave të planifikuara. Korrupsioni në radhët e funksionarëve të doganave

trajtohet në komisionin disiplinor që operon që prej vitit 1999. Për punonjësit e doganave u miratua Kosi i Etikës.

Janë marrë disa masa për çështjen e korrupsionit dhe aktiviteteve të tjera kriminale brenda shërbimit doganor. Komisioni disiplinor ka trajtuar 158 raste të shkeljes së rregullave nga ana e oficerëve të doganave dhe 33 oficerë iu nënshtruan gjyqimit. Megjithatë, përpjekje të mëtejshme nevojiten për parandalimin e përfshirjes së oficerëve të doganave në aktivitete të paligjshme dhe për të garantuar procedimin e duhur gjyqësor të çdo veprimtarie kriminale. Progres mund të raportohet për sa i takon rolit të shërbimit të doganave në luftën kundër krimit të organizuar, drogës dhe kontrabandës. Bashkëpunimi mes doganave dhe policisë është forcuar dhe janë ndërmarrë disa veprime të efektshme.

Një grup i përbashkët pune me policinë (Nisma e Krimit të Organizuar) është tashmë në funksion.

Që prej vitit 1999, nuk është bërë asnjë përditësim i legjislacionit mbi rregullat e origjinës; pavarësisht nga kjo, certifikimi dhe kontrolli i procedurave është përmirësuar në mënyrë të dukshme për sa i takon periudhës në të cilën raportohet. Për sa i takon procedurave të auditimit, administrata e Doganave ka nisur të kryejë kontrole pas zhdoganimit. Në fushën e **kapaciteteve administrative dhe operacionale**, zbatimi i sistemit automatik të përpunimit të të dhënave ASYCUDA (zhvilluar nga Kombet e Bashkuara) është bërë një progres i konsiderueshëm. Sistemi ASYCUDA u zbatua në pikat doganore në Tiranë, Durrës, Qafë Thanë, Vlorë, Kakavijë dhe Kapshticë si edhe në qendrën e shërbimit doganor. Mbi 95% të të gjitha deklarimeve doganore tani përpunohen automatikisht me anë të ASYCUDA-s.

Qarkullimi i dukshëm i personelit vërejtur në vitin 2003 u reduktua në 25 vetë personel në vitin 2004. Megjithatë, zëvendësimi i një numri funksionarësh të lartë të doganave në fundin e vitit 2005 pa u mbështetur në procedurat e duhura është një burim shqetësimi. Punonjësit në personelin e doganave mbulohen nga Ligji për Shërbimin Civil, sipas ndryshimeve të prillit 2004 në Kodit Doganor, por ndryshime të mëtejshme kërkohet të kryhen në mënyrë që personeli i doganave të trupëzohet në shërbimin civil si edhe që të sigurohet një nivel i barabartë pagash. Operatorët e tregut së bashku me funksionarë të doganave janë trajnuar gjatë periudhës raportuese mbi disa çështje që kanë lidhje me tregtinë si për shembull, mbi origjinën e mallrave.

Përgjithësisht, administrata doganore shqiptare ka shënuar një zhvillim pozitiv, veçanërisht në fushën e menaxhimit të burimeve njerëzore, në aktivitetet trajnuese, në zhvillimet IT, në futjen e sistemit ASYCUDA dhe në afrimin e personelit të doganave më pranë statusit të nëpunësit civil. Megjithatë, kontrabanda mbetet ende një problem.

Shqipëria duhet të bëjë përpjekje të mëtejshme që të rrisë luftën kundër korrupsionit, që të sigurojë trajnime të mëtejshme për specialistët në terren dhe të përmirësojë sistemin ASYCUDA.

Nevojitet një harmonizim i mëtejshëm me *acquis* dhe me standardet e BE-së për: doganat dhe procedurat e tranzitimit, magazinat doganore; vlerësimet doganore; kontrollet fizike dhe analizimin e risqeve. Shqipëria duhet të bëjë të detyrueshëm dhënien e informacionit tatimor dhe të bëjë më efikas menaxhimin e kuotave tarifore (që aktualisht bëhet me faks dhe telefon). Përpjekje të mëtejshme kërkohet të bëhen për të trajtuar në mënyrë efektive materialet me përdorim të dyfishtë dhe ato të falsifikuara si edhe të merren masat e nevojshme për të zbatuar në mënyrën e duhur rregullat e origjinës.

Progres raportohet në fushën e tatimeve. Ndryshimet e kufizuara për TVSH-në dhe legjislacioni mbi taksat indirekte ka hyrë në fuqi në janar të vitit 2005. U prezantua një sistem i integruar tatimesh për deklarin e të ardhurave personale (duke zëvendësuar sistemin e taksës në burim).

Vlera e tatimit të thjeshtuar u reduktua nga 4% në 3% (të xhiros) kurse tatimi mbi fitimin nga 25% në 23% në vitin 2005. Procedura për regjistrimin vjetor të bizneseve të vogla taksapagues janë hequr si edhe janë përmirësuar procedurat për rimbursimin e taksave. Procedurat e apelimit për të gjithë llojet e taksave janë unifikuar. Gjatë vitit 2004 dhe gjysmës së parë të vitit 2005, u krye transferimi i funksionit të mbledhjes së kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Instituti i Sigurimeve Shëndetësore tek administrata tatimore. Përveç kësaj, Ministria e Financave i paraqiti qeverisë në shtator të vitit 2005 ndryshimet ligjore mbi uljen e taksave të biznesit të vogël, që pritet të diskutohen hollësisht nga qeveria e re. Vendimi mbi uljen 50% të taksave të biznesit të vogël dhe atyre vendore, pritet të hyjë në fuqi para përfundimit të vitit 2005. Përgjithësisht, janë vërejtur disa zhvillime pozitive por shumë çështje duhet ende të adresohen. Është vendosur një sistem tarifash mbi TVSH-në dhe akcizën por shihet si e nevojshme kryerja e një analize mbi hendeqet legjislative me legjislacionin e BE-së. Shqipëria duhet që të veprojë konform parimeve të Kodit të Sjelljes mbi tatimet e biznesit. Fillimisht, duhet të kryejë një analizë hendeqesh që synon identifikimin e masave ekzistuese që mund të jenë në kundërshtim me këto parime.

Mbledhja e të ardhurave është përmirësuar në mënyrë të ndjeshme gjatë viteve. Megjithatë, mbetet shumë për të bërë për të përmirësuar mbledhjen e të ardhurave dhe për të ulur shkallën e ekonomisë së zezë, pasi përqindja e taksave në GDP është shumë e ulët.

Më shumë përpjekje duhen bërë për të trajtuar problemin e evazionit në fushën e tarifave të akcizës. Gjatë harmonizimit të legjislacionit mbi tatimet me atë të BE-

së, Shqipëria duhet të përmirësojë gjithashtu edhe transparencën dhe shkëmbimin e informacioneve me shtetet anëtare të BE-së për të lehtësuar shtrëngimin e masave parandaluese të shmangies apo evazionit të taksave.

Në këtë kontekst, shkëmbimi i informacionit me shtetet anëtare të Bashkimit Europian duhet të bazohet në modelin e marrëveshjes OECD për shkëmbimin e informacionit. Kapaciteti administrativ i administratës së tatimeve është përmirësuar gjatë periudhës së fundit si edhe janë ndërmarrë disa reforma shumë të rëndësishme (p.sh. Menaxhimi i burimeve njerëzore, trajnimet dhe reforma në sistemet e apelimit.) Megjithatë, arkëtimi dhe kontrolli i kapaciteteve mbeten të dobëta. Lufta kundër korrupsionit duhet gjithashtu që të ndiqet dhe të përforcohet në mënyrë që të arrihet një zbatueshmëri jo diskriminuese e ligjeve mbi tatimet. Për sa i takon fushës së IT, tanimë ekziston një regjistër qendror i gjithë taksapaguesve që është kompjuterizuar, por procesi i kompjuterizimit të zyrave të tatimeve nuk ka përfunduar ende.

3.1.5. Konkurrenca

Progres raportohet në fushën e konkurrencës dhe një progres real është bërë edhe në fushën e ndihmës shtetërore. Në përputhje me ligjin e dhjetorit 2003 për konkurrencën, u ngrit Autoriteti i Kompetencës dhe në shkurt 2004 u zgjodhën edhe pesë anëtarë të Komisionit të Konkurrencës.

Autoriteti është një institucion i pavarur që i raporton Kuvendit dhe ka kompetenca të gjera për të zbatuar rregullat e konkurrencës.

Autoriteti është i përbërë nga Komisioni i Konkurrencës si një organizëm vendimmarrës dhe nga Sekretariati, si organizmi ekzekutiv.

Parlamenti emëron anëtarët e Komisionit të Konkurrencës në bazë të propozimeve nga Presidenti i Republikës, Këshilli i Ministrave dhe Kuvendi për një mandat pesë vjeçar. Sekretariati ka nën varësi shtatë nëpunës civilë.

Një Departament i ri i **Ndihmës Shtetërore** u krijua në mars 2004 brenda Ministrisë së Ekonomisë. Në prill të vitit 2005 u miratua Ligji për ndihmën shtetërore. Ky ligj përmbledh parimet e rregullave BE-së për ndihmën shtetërore dhe parashikon ngritjen e Autoritetit për ndihmën shtetërore nga viti 2006.

Ka nisur puna për hartimin e masave zbatuese. Miratimi i Ligjit për ndihmën shtetërore është një shenjë e angazhimit të Departamentit të Ndihmës Shtetërore në Ministrinë e Ekonomisë. Departamenti ka rritur numrin e personelit dhe ka aktualisht shtatë specialistë. Ky Departament është në procesin e kryerjes së një inventari për ndihmën shtetërore. Janë mbajtur trajnime për stafin si edhe seminare për funksionarë të institucioneve të tjera të përfshira në dhënien e ndihmës shtetërore. Janë ndërmarrë disa masa për të rritur ndërgjegjësimin e bizneseve dhe autoriteteve lokale mbi parimet e ndihmës shtetërore. Shqipëria ka

ndërmarrë masa të rëndësishme ligjore dhe administrative në vendosjen e strukturave që rregullojnë konkurrencën dhe ndihmën shtetërore. Megjithatë, në një vend ku kultura e konkurrencës është ende në hapat e saj të parë, nevojitet të bëhet shumë më tepër për të rritur kuptimin e përgjithshëm mbi parimet e konkurrencës, si një mjet për të mbrojtur interesat e tregut dhe të konsumatorëve. Autoriteti i Konkurrencës ka një numër të vogël punonjësish dhe një buxhet të pamjaftueshëm. Pavarësisht nga progresi në miratimin e një kuadri ligjor, legjislacioni në këtë fushë duhet të përmirësohet akoma më tej për ta bërë efikas kontrollin mbi konkurrencën.

Nevojitet të kryhen përpjekje të mëtejshme në mënyrë që të garantohet mbulimi i çështjeve të ndihmës shtetërore me një legjislacion konsistent dhe plotësues dhe që të ngrihet një Autoritet i pavarur i Ndihmës Shtetërore.

3.1.6. Prokurimi publik

Në fushën e **prokurimit publik**, vihet re një progres shumë i kufizuar.

Legjislacioni shqiptar mbi prokurimin publik, që daton që nga viti 1995, ka pësuar një numër ndryshimesh (më i fundit në qershor 2005). Legjislacioni aktual është i bazuar në kritere përkufizimi, parime themelore, procedura, pragjesh, vlerësimi dhe shpërblimi, si edhe në kërkesa publikimi dhe procedura rishikimi që janë krejtësisht të ndryshme nga ato të legjislacionit të BE-së.

Për më tepër, ka hendeqe shumë të mëdha në fusha që kanë lidhje me koncesionet dhe me përqendrimin e enteve që operojnë në fushën e shërbimeve komunale. Kuadri i vendosur nga legjislacioni parësor (Ligji i Prokurimit Publik) dhe aktet normative zbatuese (vendime dhe udhëzime) është tepër i komplikuar dhe për më tepër jo konsistent. Për këtë arsye është shumë e vështirë që entet prokurorese dhe aktorë të tjerë që të bëjnë interpretimin dhe veç kësaj, mungesa e qartësisë i lë enteve prokurorese shumë liri veprimi. Këto vështirësi, të cilave u shtohet edhe një mungesë e përgjithshme sensibilizimi për legjislacionin, nga ana e enteve lokale dhe të sektorit privat, rezultojnë në një zbatim shumë të dobët dhe në pasiguri ligjore në praktikën e prokurimit. Agjencia shqiptare e Prokurimit Publik është shumë e dobët, me staf dhe financim të pamjaftueshëm, gjë që çon në parregullsi të shpeshta. Vija ndarëse mes sektorëve të saj të ndryshëm (sidomos mes sektorit të Prokurimit, atij Ligjor dhe të Kontrollit) nuk është mjaft e qartë; mungon gjithashtu dhe mekanizmi i duhur për këshillimin.

Veç kësaj, shumë pak është bërë edhe për IT brenda sistemit shqiptar të Prokurimit Publik në përgjithësi. Në vitin 2004, Agjencia e Prokurimit Publik, hapi një faqe në internet, por informacioni në të nuk freskohet rregullisht. Por megjithatë, APP ka refuzuar një numër të madh kërkesash për miratimin e

tenderimit të drejtpërdrejtë, pjesa më e madhe e kërkesave për miratim të tenderimit të drejtpërdrejtë (222 nga 340) u refuzuan në vitin 2004.

Në raste mospranimi, APP i mbron sistematikisht vendimet e saj mbi shkeljet, përfshirë gjobat administrative, dhe i çon me sukses çështjet në Gjykatën e Apelit- në bashkëpunim të ngushtë me Institucionin e Avokatit të Shtetit.

Pavarësisht nga një ulje e pragjeve për tenderët e hapur ndërkombëtare në janar të vitit 2005, pragu vazhdon të jetë jashtëzakonisht i lartë dhe nuk është në përputhje me legjislacionin e BE-së për prokurimin.

Në dhënien e **kontratave publike**, entet prokurorese japin tendera vetëm mbi bazën e çmimit më të ulët, në vend që të përdorin kriterin e tenderit më të leverdishëm ekonomikisht. Përveç kësaj, nuk ka procedura efikase dhe të pavarura, sidomos për shkak se nuk ka as një organizëm të pavarur për ankesa dhe as një dispozitë që mundëson një apelim në gjykatë pas tezurimit të procedurës administrative. Hetimi dhe procedimi penal për shkelje që kanë lidhje me prokurimin publik është i pamjaftueshëm; influenca politike dhe korrupsioni mbeten faktorë të rëndësishëm. Çështjet e sipërpërmendura, së bashku me zbatimin e dobët të parimeve themelore si transparenca, trajtimi i barabartë, konkurrenca e lirë dhe jo diskriminimi, rezultojnë në sistem prokurimi që diskriminon fuqimisht ofruesit e huaj në favor të atyre vendas; në një sistem që nuk arrin të marrë vlerën më të mirë për paratë dhe efikasitet në procesin e prokurimit, duke lënë shkas për korrupsion dhe marrëveshje të fshehta. Përpjekje të tjera shumë të mëdha janë të nevojshme nëse Shqipëria do të garantojë zbatimin korrekt të rregullave të prokurimit. Përmirësime të dukshme nevojitet të kryhen edhe për legjislacionin në mënyrë që ai të harmonizohet me *acquis* dhe të ketë koherencë të plotë. Masa radikale për të parandaluar parregullsitë dhe për të ndjekur penalisht mashtrimin dhe korrupsionin në të gjitha nivelet, duhet të miratohen dhe të zbatohen energjikisht.

3.1.7. Ligji për pronën intelektuale

Progres raportohet në fushën e pronësisë intelektuale dhe industriale.

Për sa i përket të **drejtës së autorit dhe të drejtave të tjera lidhur me të**, Shqipëria është palë në Konventën e Parisit për Mbrojtjen e Pronësisë Industriale, Konventës Bernit për mbrojtjen e veprave letrare dhe atyre të artit, Konventës së Romës për mbrojtjen e Artistëve, Prodhuesve të Fonogrameve dhe Organizatave të Transmetimit televiziv. Gjithashtu, Shqipëria ka ratifikuar dy traktatet e vitit 1996 të Organizatës Botërore të Pronësisë Intelektuale: Traktatin ËIPO të së drejtës së Autorit dhe Traktatin për Fonogramet.

Zyra shqiptare e Patentave dhe Markave siguron një mbrojtje të madhe për patentat mbi shpikjet dhe modelet e modelet e përdorimit, dizenjot industriale, markat tregtare e te shërbimit, emërtimet e origjinës si edhe topografit për qarqet e integruara. Zbatimi i këtyre të drejtave të pronësisë zakonisht i lihet pronarit. Për sa i takon Pronësisë Industriale, Ligji për Pronësinë Industriale i prillit 1994 dhe Ligji për mbrojtjen e tipografive të qarqeve të integruar, i majit 1999, formojnë pjesërisht bazën për të drejtat e pronësisë industriale.

Megjithatë, këto ligje përgjithësisht nuk zbatohen dhe shkeljet e së drejtës së autorit, të markave dhe të të drejtave të tjera intelektuale, janë shumë të përhapura dhe haptazi. Për sa i përket të drejtës së Autorit dhe të Drejtave të tjera lidhur me të, në prill të vitit 2005 u miratua Ligji për të Drejtat e Autorit dhe të drejta të tjera lidhur me të, i cili siguron mekanizmat për mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale. Sipas ligjit, përgjegjësia për zbatimin e tij bie mbi Zyrën për të Drejtën e Autorit. Ministria e Kulturës ka licencuar dy shoqata për mbrojtjen kolektive të së drejtës së autorit. “Forumi për Mbrojtjen e Autorëve të Veprave Audiovizuale” u krijua në prill të vitit 2004 dhe përbëhet nga 85 anëtarë përfshirë operatorë publikë dhe privatë të televizioneve. Ky forum bashkëpunon gjithashtu me Këshillin e Përgjithshëm të Radios dhe Televizionit, që monitoron televizionet kombëtare dhe lokale.

Shoqata e dytë, e quajtur “Albautor” ka për qëllim mbrojtjen e të drejtave të autorëve muzikorë. Megjithatë, përgjithësisht, menaxhimi kolektiv i së drejtës së autorit ende funksionon me vështirësi. Aktualisht, Departamenti Ligjor i Ministrinë së Kulturës Rinisë dhe Sporteve është përgjegjës për hartimin e politikës së mbrojtjes së pronësisë intelektuale, ngritjes së infrastrukturës institucionale dhe për zbatimin e politikave. Departamenti përbëhet nga pesë punonjës, që janë të pamjaftueshëm për të siguruar zbatimin e duhur të politikave. Zyra Shqiptare për të Drejtën e Autorit nuk është ngritur ende, megjithëse krijimi parashikohet në ligjin e ri për të drejtën e autorit ; dhe është planifikuar për vitin 2006; krijimi i zyrave rajonale për mbrojtjen e të drejtave të autorit planifikohet për periudhën 2007-2008. Vihet re progres në sensibilizimin e komunitetit të biznesit dhe organeve të ruajtjes së rendit në lidhje me çështjet e Pronësisë Intelektuale. Gjatë periudhës raportuese, inspektorët e taksave kanë mbikëqyrur 40 operatorë të tregut, dhe masa ligjore janë ndërmarrë kundër 18 prej tyre. Si pasojë, disa operatorë të tregut kanë nënshkruar kontrata dhe u kanë bërë atyre pagesa. Disa autorë kanë fituar çështje gjyqësore në mbrojtje të të drejtave të tyre. Një Memorandum Mirëkuptimi është nënshkruar në korrik të vitit 2004 ndërmjet institucioneve shqiptare që merrem me mbrojtjen e Pronësisë Intelektuale, konkretisht Ministrisë së Kulturës dhe Rinisë, Ministrisë së Financave, Ministrisë së Drejtësisë, Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit dhe dy shoqërive për të Drejtat e Autorit.

Për sa i përket **shtrëngimit**, Shkolla e Magjistraturës ka organizuar disa trajnime për gjyqtarët mbi çështjet që kanë të bëjnë me pronësinë intelektuale, por nuk ekzistojnë gjykata të specializuara që të trajtojnë çështjet që lidhen me pronësinë intelektuale dhe vihet re një mungesë e gjyqtarëve të kualifikuar për të trajtuar çështje të pronësisë intelektuale. Përgjithësisht, vihet re progres në fushën e legjislacionit, të marrëveshjeve ndërkombëtare dhe të ndërgjegjësimit mbi të drejtat e pronësisë intelektuale. Megjithatë, duhet të bëhen përpjekje të mëtejshme për të vënë në funksionim kapacitetet institucionale dhe administrative për të zbatuar kuadrin e përgjithshëm ligjor në këtë fushë. Për një progres të mëtejshëm në këtë fushë, është thelbësore që të ngrihet Zyra e të Drejtës së Autorit dhe që ajo të vihet në funksionim. Një progres i mëtejshëm nevojitet në rritjen e ndërgjegjësimit mbi çështjet e pronësisë intelektuale në komunitetin e biznesit dhe organeve të shtrëngimit të ligjit, përfshirë gjyqësorin. Duhet të intensifikohen gjithashtu edhe fushatat kundër piraterisë dhe falsifikimit.

3.1.8 Statistikat

Shqipëria ka bërë progres në fushën e **infrastrukturës statistikore**. Ligji për statistikat zyrtare u miratua nga Parlamenti në 5 shkurt 2004 dhe është në përputhje me parimet themelore të OKB-së dhe standardet Europiane. Programi pesë vjeçar për statistikat zyrtare i periudhës 2005-2009 është një mjet shumë i rëndësishëm për përcaktimin dhe bashkërendimin e sistemit kombëtar statistikor, ndërkohë që INSTAT luan një rol shumë të rëndësishëm. Megjithatë, INSTAT duhet të fuqizojë infrastrukturën statistikore, përfshirë zyrat lokale dhe të rritë bashkëpunimin me prodhues të tjerë të statistikave zyrtare. Pjesa më e madhe e klasifikimeve është kryer në përputhje me standardet e BE-së. Pavarësisht nga progresi i arritur, disa nga klasifikimet si Prodcom, NUTS, ICD-10 dhe klasifikimit të Statistikave për Turizmin OBT, nevojitet që të zbatohen. Për sa i takon **statistikave sektoriale**, nuk është vërejtur ndonjë progres i dukshëm në statistikat rajonale, demografike dhe sociale.

Zyrat e gjendjes civile duhet të rrisin kapacitetet dhe të krijojnë shtypsa për regjistrimin e të gjithë aktiviteteve demografike, duhet të krijohet gjithashtu edhe një regjistër për popullsinë. Në shumë fusha të statistikave shoqërore nevojitet një përmirësim i mëtejshëm. Për sa i takon statistikave makroekonomike, kuadri konceptual i referimit është sistemi i OKB-së i llogarive kombëtare. Të dhënat e PBB për periudhën 1996-2002 u botua në shtator të vitit 2004. Parimet themelore të indeksit të çmimeve të konsumatorit shqiptar, janë në përputhje me rekomandimet ILO. INSTAT merr pjesë në Programin Krahasues Europian që përpilon të dhënat e PBB-së në PPP.

Një progres i mëtejshëm duhet të arrihet në fusha si llogaritja e hollësishme e PBB-së, shprehja e PBB sipas llojit final të shpenzimit dhe vlerësime tremujore të PBB. Duhet të modifikohet struktura vlerësuese për indeksin e çmimeve të konsumatorit. Për sa i takon statistikave të biznesit, regjistri statistikor i biznesit po krijohet. Një analizim tremujor i biznesit në përputhje me rregullat e BE-së mbi statistikave afatshkurtra u fut në fund të periudhës raportuese. Analiza strukturore e biznesit e kryer nga INSTAT është në përputhje me standardet e BE-së deri në një farë mase. Megjithatë, statistikave mbi biznesin duhet të zhvillohen më tej dhe të përmirësohen në mënyrë që nevojat për statistikave afatshkurtra, statistikave strukturore dhe regjistri statistikor për biznesin të shtrihen dhe të mbulojnë të gjitha njësitë, ashtu siç parashikon dhe Rregullorja. Për sa i takon statistikave mbi tregtinë e jashtme, në vitin 2004 administrata doganore vuri në zbatim sistemin e kompjuterizuar ASYCUDA për përpunimin automatik të të dhënave, gjë që ka lehtësuar mbledhjen e të dhënave. Ka një bashkëpunim të mirë mes INSTAT dhe administratës doganore mbi hartimin dhe botimin e statistikave mbi tregtinë e jashtme. Të dhënat i kalojnë Eurostatit sistematikisht. Në lidhje me statistikave mbi bujqësinë, INSTAT ka krijuar një regjistër bujqësor mbi bazën e numërimeve të popullsisë të viteve 1998 dhe 2001. Puna për hartimin e statistikave të bujqësisë ka nisur me një projekt binjakëzimi. INSTAT dhe Ministria e Bujqësisë duhet të përfundojnë një memorandum bashkëpunimi që aktualisht po përgatitet për të ravijëzuar bashkëpunimin e tyre të ardhshëm në fushën e statistikave të bujqësisë. Shqipëria duhet të forcojë mbledhjen dhe përpunimin e statistikave bujqësore në përputhje me metodologjinë dhe standardet e BE-së. Megjithatë, ka shumë fusha që kanë nevojë për harmonizim. Një progres i mëtejshëm duhet të bëhet në zhvillimin e llogarive kombëtare dhe në shtrirjen e regjistrit statistikor të biznesit dhe në vendosjen e regjistrit të popullsisë. Përmirësime duhet të bëhen gjithashtu edhe porsa i përket statistikave makroekonomike, sociale dhe bujqësore.

3.2 Politikat Sektoriale

3.2.1. Industria dhe SME-të

Një progres i pakët raportohet për sa i përket politikës së SME-ve dhe në fushën e politikave industriale. Sektori privat, përfshirë prodhimin bujqësor, përbën 75% të Prodhimit të Brendshëm Bruto të Shqipërisë dhe punëson rreth 60% të fuqisë punëtore. Agjencia Shqiptare e SME-ve ka ngritur në qershor të vitit 2004, një program kombëtar trajnimit për të rritur konkurrencën e SME-ve zbatimi i të cilit ka vijuar edhe në vitin 2005. programi u prezantua në Konferencën e Kartës Europiane për SME-të që u mbajt nga presidenca e Luksemburgut në qershor të vitit 2005. Për sa i takon **mjedisit të biznesit**, progres është shënuar në

reformimin e tatimeve, me heqjen e taksës vjetore të regjistrimit për bizneset e vogla dhe përmirësimin e procedurave për rimbursimin e tatimeve. Përveç kësaj, aktualisht kompanitë nuk kanë asnjë detyrim për të paraqitur raporte vjetore mbi veprimtaritë e tyre. Pas një studimi të FIAS (Shërbimi Këshillimor për Investimet e Huaja i Korporatës Ndërkombëtare të Financës / Banka Botërore) në mars të vitit 2005, i cili identifikonte barrierat kryesore administrative për shoqëritë dhe investitorët, u hartua një plan veprimi dhe u ngrit një grup pune. FIAS po vlerëson aktualisht progresin e deritanishëm të reformës. Një zhvillim pozitiv ka qenë përfshirja e përfaqësuesve të biznesit në hartimin e një plani veprimi për heqjen e barrierave administrative, dhe raporti i FIAS do të japë rekomandime për fazën e mëtejshme të reformave në këtë sektor. Sektori industrial vazhdon të hasë vështirësi, pasi ka trashëguar asete të dëmtuara të industrisë dhe kapacitete të vjetruara. Përqindja e saj në PBB ra nga 10.2 % në vitin 2003 në 9.9 % në vitin 2004. Megjithatë, gjatë viteve 2004-2005, pesë klasa të tjera në fushën e përpunimit të mishit, barërave dhe erëzave, lëkurës, medias dhe industrisë së turizmit – ishin premtuese. Nevojiten investime të konsiderueshme për të zhvilluar këtë sektor, kështu që përmirësohet mund të vihen re vetëm në një periudhë afatmesme dhe afatgjatë. Megjithëse **procesi i ristrukturimit dhe i privatizimit** të sipërmarrjeve i ka përshpejtuar disi investimet në sektorin industrial, një numër marrëveshjesh të nisura së fundmi për privatizimin kanë dështuar (si për shembull rafineria e naftës ARMO, Kompania e shpërndarjes së naftës Servcom dhe Albtelecom, kompania shqiptare e telekomunikacionit). Korporata Elektroenergjitike Shqiptare është përfshirë nga një ristrukturim i konsiderueshëm. Në fushën e politikave të SME-ve, mbetet i ulët progresi mbi zbatimin e Kartës Europiane për Ndërmarrjet e Vogla. Përgjithësisht, një numër i kufizuar hapash pozitive është ndërmarrë për sa i takon tatimeve dhe barrierave administrative. Megjithatë, hapa të tjerë nevojitet që të ndërmerren për të përmirësuar mjedisin e biznesit. Shqipëria duhet të sigurojë në kohë hartimin e një legjislacioni të ri në mënyrë që regjistrimi i kompanive të jetë më i lirë dhe më i thjeshtë; aktualisht, regjistrimi është i mundur vetëm në Shqipëri dhe administrohet nga vetëm tre punonjës. Shqipëria duhet të përmirësojë gjithashtu edhe procedurat për të nxjerrë licencat, lejet dhe certifikatat – që aktualisht janë shumë të komplikuar, të kushtueshme dhe që lënë shteg për favorizime. Më tej, Shqipëria duhet të fusë standardet e raportimit financiar dhe hapjes në përputhje me ato të BE-së si edhe të sigurojë zbatimin e tyre me efikasitet. Kërkohet marrja e masave për të përmirësuar transparencën dhe për të parandaluar diskriminimin në fushën e tatimeve, nëse Shqipëria do të dojë të distancohet nga ekonomia e keshit (*cash*). Dispozitat, me anë të të cilave sipërmarrësit janë përgjegjës para ligjit për të paguar tatimet mbi të ardhurat të korporatës përpara datës së regjistrimit të kompanisë duhet të

analizohen me kujdes dhe duhet të merren menjëherë hapa për të zbatuar planin e veprimit të prillit 2005 për të adresuar ekonominë informatë, pas studimit të OECD mbi këtë çështje. Shqipëria duhet të bëjë progres të mëtijshëm për zhvillimin e një portali ueb, për SME-të, ashtu siç është propozuar nga Agjencia Shqiptare e SME-ve, si edhe duhen marrë masa për miratuar një ligj elektronik, për të ngritur procedurat që do të vlerësojnë impaktin e biznesit në masat e reja të planifikuara rregullatore, si edhe për të përshpejtuar ngritjen e një fondi kombëtar të garancisë që do të lehtësonte kreditimin e SME-ve (një nga qëllimet kryesore të kartës së SME-ve). Shqipëria duhet të përmirësojë qëndrueshmërinë financiare të Agjencisë së SME-ve dhe të zbatojë programin kombëtar të trajnimit për SME-të. Shqipëria duhet të marrë masa për të vendosur inkubatorë të tjerë të biznesit: aktualisht ekzistojnë vetëm dy të tillë. Të mësipërmet janë në përgjegjësinë e Ministrisë së Punës dhe jo të Ekonomisë, pavarësisht nga këshilla e vitit 2003 e OECD për transferimin e përgjegjësisë. Qeveria ka ndërmarrë hapat e parë për të nisur dialogun ndërmjet komunitetit të biznesit dhe qeverisë. Megjithatë, kapaciteti i Këshillit Këshillues të Biznesit, dhe veçanërisht Sekretariati i tij që do të vepronte si një kanal efikas për këtë dialog, duhet të forcohen. Përveç kësaj, Shqipëria duhet të ekzaminojë fizibilitetin për një park teknologjik biznesi në Shqipëri dhe të mbajë parasysh përdorimin e gjerë të politikës kërkimore dhe novative për mbështetjen dhe realizimin e reformës ekonomike si edhe të ndërtimit të kapaciteteve, ashtu siç kërkohet nga Marrëveshja e Stabilizimit dhe Asociimit. Probleme më të përgjithshme që kanë lidhje me mjedisin e biznesit, të cilat Shqipëria duhet ti adresojë në mënyrë urgjente, përfshijnë regjistrimin e ngadaltë të pronës, kthimin dhe kompensimin, korrupsionin (*shikoni gjithashtu edhe Seksionet B1.1 dhe B 1.2*) si edhe infrastruktura e dobët.

3.2.2. Bujqësia dhe Peshkimi

Shqipëria ka bërë një progres të pakët në fushën e bujqësisë dhe të peshkimit. Sektori i **bujqësisë**, ka dhënë të paktën një të katërtën e PBB në vitin 2004 dhe afërsisht gjysma e popullsisë e siguron jetesën nga bujqësia, kryesisht me anë të fermave të vogla. Kontributi i bujqësisë në PBB është rritur lehtësisht në vitin 2004, kryesisht nëpërmjet përpunimit tradicional ushqimor në sektorë si ai i vajit të ullirit, mishit, prodhimeve të baxhove, miellit, verës dhe birrës. Megjithatë, roli i industrisë së brendshme në nxitjen e rritjes së prodhimit bujqësor, mbetet i ulët duke qenë që shumica e lëndëve të para për përpunim si gruri, elbi dhe mishi janë të importuar. Në vitin 2004, investimet në industrinë e përpunimit ushqimor janë rritur me 10%, kryesisht për sa i takon qumështit, frutave dhe ujit mineral.

Shqipëria duhet që tani të përgatisë një program për përmirësimin e stabilimenteve të përpunimit të ushqimit në mënyrë që ato të plotësojnë kërkesat e BE-së. Shqipëria duhet të zhvillojë strategji për përdorimin e tokës, tregun e tokës, zhvillimin rural, zgjerimin e aktiviteteve fermere dhe rritjen e konkurrueshmërisë bujqësore.

Është gjithashtu e nevojshme që të përmirësohen kanalet e shpërndarjes dhe të ngrihen ambiente të përshtatshme për magazinimin e prodhimit. Progresi në këto fusha duhet të kontribuojë për qëllimin final që është përmirësimi i cilësisë së prodhimit dhe rritja e konkurrueshmërisë. Shumë aspekte të të mësipërmeve përfshijnë kosto që fermerët duhet të paguajnë. Në këtë kontekst, aksesimi për kredi është shumë i rëndësishëm për një zhvillim të mëtejshëm në këtë sektor. Dhënia e një titulli ligjor të qartë për tokën është e një rëndësie tepër të madhe për progresin në këtë sektor: Shqipëria duhet të veprojë me një shpejtësi më të madhe me procesin e regjistrimit të tokës, kthimit dhe kompensimit (*shikoni gjithashtu dhe seksionin B1.2*). Shqipëria i ka rritur marrëdhëniet tregtare me vendet fqinje me të cilat ka marrëveshje të tregtisë së lirë. Eksportet janë rritur më shumë se importet dhe megjithëse bilanci i tregtisë mbetet negativ, marrëveshjet e tregtisë së lirë pritet që të kenë një efekt pozitiv mbi ekonominë dhe ri-orientimin e strukturës së prodhimit, përfshirë bujqësinë dhe peshkimin në një periudhë kohe afatmesme e afatgjatë. Një progres i pakët raportohet në fushën e sigurisë së ushqimit. Shqipëria ka futur rregulla të reja mbi ngjyruesit ushqimorë dhe ruajtjen e qumështit, por në mënyrë që sistemi i sigurisë ushqimore si një i tërë të jetë efikas, duhet që më parë të ristrukturohet, si edhe të forcohen sistemet e kontrollit. Shqipëria duhet gjithashtu të zgjidhë problemin e konkurrencës së pandershme në tregun e brendshëm që lind si pasojë e produkteve false, të skaduara apo me cilësi të dobët. Një progres i kufizuar vërehet edhe në fushën veterinare dhe fitosanitare. Në nëntor të vitit 2004, Kuvendi shqiptar miratoi një ligj të ri mbi shërbimet veterinare, duke rregulluar shpërndarjen e fondeve veterinare e duke eliminuar disa barrierat për tregtinë e kafshëve të gjalla, me anë të ngritjes së një organizmi profesionist – Urdhrit të veterinerit. Shqipëria duhet të shpejtojë përpjekjet për të sjellë në një linjë legjislacionin e saj me *acquis* mbi veterinarinë dhe atë fitosanitare si edhe të harmonizojë sistemin e identifikimit të kafshëve dhe regjistrimin për gjedhët, delet dhe dhitë sipas kërkesave të BE-së. Duhet të merren masa që prodhimet shqiptare të ngrihen në lartësinë e standardeve shëndetësore të BE-së, veçanërisht për sa u takon molusqeve bivalve dhe produkteve të tjera të peshkimit. Duhet të forcohet kontrolli i strukturave. Shqipëria duhet të qartësojë kompetencat dhe të rrisë nivelin e stafit në shërbimin veterinar, të përmirësojë dhe pajisë më mirë laboratorët, sidomos Institutin e Kërkimeve Veterinare. Janë ngritur skema certifikimi për materialet mbjellëse të disa pemëve frutore, por

Shqipëria duhet të garantojë një kontroll efikas të prodhimit të brendshëm të bimëve në përgjithësi, sidomos për ato produkte të cilat kanë kërkesa specifike nga BE-ja, si edhe për të ngritur kapacitetin analitik të sektorit fitosanitar. Administrata përkatëse shqiptare duhet të afrohet më shumë me standardet Europiane në fushën e Politikës së Përbashkët të Peshkimit, veçanërisht në fushat e menaxhimit të burimeve, inspektimit dhe kontrollit, di edhe politikave të tregut dhe ato strukturore. Në mungesë të një progresi të matshëm në këtë fushë gjatë katër viteve të fundit, pavarësisht nga çështjet që kanë lidhje me tatimet, duhet të bëhen përpjekje më të vendosura.

3.2.3 Mjedis

Shqipëria ka bërë një progres të kufizuar në fushën e mjedisit. Për sa i takon **legjislacionit horizontal**, një ligj mbi Vlerësimin e Impaktit në Mjedis u miratua në 23 janar të vitit 2003 dhe është aktualisht në fuqi. Shqipëria ka ratifikuar Protokollin e Kijotos në dhjetor të vitit 2004. Për sa i takon **cilësisë së ajrit**, të dhënat monitoruese të ajrit në qendrat kryesore urbane tregojnë që ndotja e ajrit nuk është kontrolluar apo ulur. Në dhjetor të vitit 2004, Ministria e Mjedisit ka hartuar disa udhëzime të përbashkëta me Ministrinë e Transportit mbi kontrollin e niveleve të lejuara të ndotësve të ajrit nga automjetet. Në fushën e **menaxhimit të mbetjeve**, Shqipëria ka miratuar në tetor të vitit 2004 një ligj për të aprovuar ndryshimet në Konventën Bazel mbi kontrollin e lëvizjes ndërkufitare të substancave të rrezikshme, dhe një ligj mbi klasifikimin e mbetjeve në shkurt të vitit 2005. Në lidhje me vatrat e nxehta të mbetjeve, Ministria e Mjedisit ka përfunduar një studim fizibiliteti mbi trajtimin e problemeve që kanë lindur në ish zonën industriale të ndotur të Porto Romanos, afër Durrësit, ku ndotja po ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në shëndetin e popullsisë, e cila nuk ka as furnizim me ujë të pijshëm dhe as kanalizime të ujërave të zeza. Ka nisur puna teknike për të adresuar problemet në ish fabrikën PVC të Vlorës. Me asistencën e BE-së, vazhdon puna për eliminimin e ndotjes nga fabrika e amoniakut në Fier (mbetjet e arsenikut) dhe në rafinerinë e naftës në Ballsh (ku ka ndotje naftë). Manaxhimi i mbetjeve duhet të fuqizohet dhe të merren masa për dy vatrat e nxehta që vazhdojnë të gjenerojnë ndotje: vend-depozitimi i mbetjeve të ngurta urbane në Sharrë, afër Tiranës dhe në naftë-nxjerrësin Patos-Marinëz. **Cilësia e ujit** është e dobët, rrjedhjet dhe lidhjet e paligjshme janë të shpeshta. Rreth 80% e popullsisë urbane ka ujë të rrjedhshëm, por furnizimi me ujë dhe sistemet sanitare janë të vjetruara. Shtëpitë kanë ujë të rrjedhshëm mesatarisht 12 orë në ditë në zonat urbane, dhe rreth 6 orë në zonat rurale. Për sa i takon kanalizimeve të ujërave të zeza, progresi është i kufizuar: vetëm 40% të

popullsisë në qytet ka kanalizime të rregullta të ujërave të zeza, ndërkohë që trajtimi i këtyre ujërave vazhdon të jetë pothuajse inekzistent. Janë shënuar edhe disa përmirësime. Humbjet në sistemet e shpërndarjes së ujit janë ulur me 6% që nga viti 2001, ndërkohë që të arkëtimet janë rritur me 9% për të njëjtën periudhë. Në dhjetor të vitit 2004, arkëtimet kapën shifrën 75%. Shumë ndërmarrje kanë arritur arkëtime deri në 75% e madje disa te tjera edhe 97%. Decentralizimi dhe privatizimi në sektorin e ujësjellësit vazhdon. Gjatë periudhës raportuese, janë ndërmarrë disa hapa pozitivë në kuadër të Strategjisë Kombëtare të Ujit dhe kanalizimeve për përmirësimin e menaxhimit të burimeve ujore, përfshirë futjen e sahatit të ujit, ngritjen e një sistemi të kompjuterizuar të faturimit dhe arkëtimin, transferimit të përgjegjësisë për vendosjen e tarifave tek autoritetet lokale (që nga marsi 2005) si edhe në lidhje me ngritjen e një departamenti të veçantë brenda Drejtorisë së Përgjithshme të Ujësjetës Kanalizimeve, që është përgjegjës për ujin e pijshëm dhe çështjet e kanalizimit në zonat rurale. Në mars të vitit 2005, Shqipëria miratoi një ligj mbi normat që kanë lidhje me shkarkimet në ujë, sipas të cilit asnjë biznesi që shkarkon ujera industriale, nuk do ti jepet leja e punës nëse nuk instalon pajisje për pastrimin e ujit. Pavarësisht nga tendencat pozitive të theksuara më sipër, furnizimi me ujë mbetet problematik në shqipëri. Shqipëria duhet të përqendrojë forcat në zhvillimin e një strategjie për menaxhimin e ujit, përfshirë përafrimin me standardet evropiane, të përcaktojë nevojat për investime dhe të përmirësojë kapacitetet ministrore dhe ato të autoriteteve lokale për të menaxhuar ujin dhe çështjet e lidhura me kanalizimin e ujërave të zeza. Për sa i takon **mbrojtjes së natyrës**, në tetor të vitit 2004 Shqipëria ka miratuar një ligj sipas të cilit pejsazhi ujqor-tokësor Vjosë-Nartë është i mbrojtur dhe në shkurt të vitit 2005, u miratua një ligj për ngritjen e komiteteve manaxhuese për zonat e mbrojtura. Për sa i takon **kimikateve dhe organizmave të modifikuar gjenetikisht (OMGJ)**, Shqipëria ka ratifikuar Konventën e Stokholmit për Ndotësit e Qëndrueshëm Organikë në korrik të vitit 2004 dhe Protokollin e Kartagjenës në shtator të vitit 2004. Megjithatë, pavarësisht nga zhvillimet legjislative përfshirë nënshkrimin dhe ratifikimin e konventave ndërkombëtare e disa përmirësimeve praktike në sektorin e mjedisit, veçanërisht për sa i takon ujit, shumë çështje të rëndësishme mbeten për tu adresuar.

Kapacitetet Administrative në fushën e mjedisit vazhdojnë të jenë të dobëta. Shqipëria duhet të forcojë kapacitetet e Ministrisë së Mjedisit, që është shumë e dobët si në nivel kombëtar ashtu edhe në nivel lokal. Zbatimi i legjislacionit mbi mjedisin mbetet problematik dhe integrimi i politikave mjedisore me politikën në fushat e tjera është i papërshtatshëm. Arkëtimi nga gjobat që u vihen shkelësve të legjislacionit mjedisor është i kufizuar dhe nivelet e gjobave nuk janë të mjaftueshme për të sjellë ndryshim. Taksat ekologjike vazhdojnë të mbledhen dhe të përdoren nga buxheti i shtetit. Mbledhja e të dhënave mbi mjedisin është e

pamjaftueshme dhe jo e mirëorganizuar. Shqipëria duhet të adoptojë një strategji të qartë për të afruar akoma më tepër legjislacionin mjedisor me standardet e BE-së, të zbatojë ashtu siç duhet legjislacionin aktual, sidomos për sa i përket vlerësimit të impaktit të mjedisit. Ministria e Mjedisit duhet gjithashtu të forcojë bashkëpunimin me ministritë e tjera dhe me qeverinë lokale si edhe të marrë masa për të integruar mbrojtjen mjedisore në politika të tjera. Megjithëse pjesëmarrja e OJQ-ve në vendimmarrjen për çështjet e mjedisit është rritur, pjesëmarrja e publikut në procesin vendimmarrës duhet të forcohet edhe më tej.

3.2.4. Politika e transportit

Vihet re progres në sektorin e transportit. Plani kombëtar i transportit, i mbështetur nga BE-ja u miratua nga Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit në maj të vitit 2005. Ky plan jep udhëzime për zhvillimet sektoriale, propozon përmirësime në lidhje me një planifikim politikëbërës dhe strategjik të përparësive të investimeve që mund të ndihmojnë në akordimin e saktë të ndihmës nga ana e institucioneve financiare ndërkombëtare. Për sa i takon infrastrukturës së transportit, përparësitë kryesore të Shqipërisë mbeten përfundimi i korridorit lindje-perëndim (Durrës – Varna, nëpërmjet Tiranës dhe Sofjes); aksi veri-jug (që lidh Greqinë me Malin e Zi) si edhe aksi Durrës-Kukës-Morinë, që lidh Kosovën me Durrësin dhe Adriatikun. Pjesa më e madhe e burimeve kombëtare të akorduara për transportin janë përdorur për të blerë tokë për ndërtim rrugësh dhe për mirëmbajtje. Përgjithësisht, infrastruktura e transportit është e dobët dhe për shkak të mirëmbajtjes së pamjaftueshme dhe të instalimeve të paligjshme nëntokësore, edhe investimet e reja përkeqësohen shpejt. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve duhet të vërë në funksionim sa më shpejt që të jetë e mundur sistemin e planifikuar të menaxhimit të aseteve rrugore. Në nivel rajonal, duhet siguruar lidhja e duhur me rrjetin e transportit trans-europian. Shqipëria ka një pjesëmarrje aktive si nënkryetare e Komitetit Drejtues për zbatimin e Memorandumit të Mirëkuptimit të qershorit 2004 mbi Rrjetin Rajonal të Transportit për Europën Juglindore, përfshi Observatorin e Transportit (SEETO). Shqipëria ka marrë pjesë gjithashtu edhe në Grupin e Nivelit të Lartë, për shtrirjen e akseve më të mëdha trans-europiane në vendet fqinje dhe rajon, që është themeluar në vitin 2004. Në fushën e **transportit tokësor**, Shqipëria ka ratifikuar në shtator të vitit 2004, marrëveshjen Europiane në lidhje me transportin ndërkombëtar të mallrave të rrezikshëm. Është ratifikuar gjithashtu në tetor të vitit 2004 edhe Marrëveshja ndërkombëtare mbi transportin ndërkombëtar të artikujve ushqimorë delikate si edhe marrëveshjen INTERBUS mbi transportin ndërkombëtar të rastit të udhëtarëve me autobus në nëntor të vitit 2004.

Qeveria aprovoi në nëntor të vitit 2004 një program për të përmirësuar kushtet e sigurisë rrugore, përfshirë eliminimin e pikave të rrezikut (ku kanë ndodhur më shumë aksidente) dhe sigurimin e pajisjeve të specializuara për policinë rrugore. Shqipëria duhet ta zbatojë këtë plan dhe të adresojë shpeshtësinë e madhe të aksidenteve të rënda rrugore duke përmirësuar sinjalistikën, duke edukuar drejtuesit e automjeteve dhe kalimtarët mbi trafikun si edhe duke marrë masa për të parandaluar ndërtimet e paligjshme buzë rrugëve. Duhet të merren gjithashtu masa edhe për të harmonizuar legjislacionin shqiptar me *acquis communautaire* për sa i takon peshës dhe dimensioneve të automjeteve, testeve të kolaudimit, inspektimeve teknike në rrugë, patentave dhe regjistrimit të automjeteve. Zhvillimet në sektorin e transportit hekurudhor vazhdojnë të shkaktojnë shqetësim. Qeveria shqiptare duhet të marrë menjëherë masa për të reformuar hekurudhat shqiptare dhe humbjet e papërbalueshme vjetore. Raporti mbi modernizimin e HSH dhe plani kombëtar i transportit, rekomandojnë shkurtime në sistemin hekurudhor derisa t'i afrohet të qenit rentabël, si dhe hartimin e një plani biznesi për ristrukturime të thella në HSH. Pavarësisht nga kjo, qeveria ka vazhduar të investojë në sistemin hekurudhor pa pasur një politikë të shëndoshë dhe të mbështetur në treguesit ekonomikë. Në këtë kontekst, është për të ardhur keq që Shqipëria ka miratuar një propozim të padëshiruar – që ende pret ratifikimin nga Kuvendi Shqiptar – për të përforcuar shërbimin hekurudhor ndërmjet Tiranës dhe Durrësit dhe për të ndërtuar një lidhje me aeroportin Nënë Tereza të Rinasit, duke mos marrë fare parasysh paralajmërimet e Bankës Botërore, të Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe të Bashkimit Europian mbi disa aspekte të këtij plani, veçanërisht për prokurimin, rentabilitetin dhe përbalimin e borxhit. Një farë progresi është shënuar edhe në **sektorin e transportit ajror**. Në dhjetor të vitit 2004, qeveria Shqiptare miratoi Kodin e ri Ajror, megjithëse nuk është miratuar nga parlamenti. Shqipëria duhet të sigurohet që projekt Kodi Ajror të ndryshohet në përputhje me *acquis communautaire* mbi aviacionin në kuadrin e Hapësirës së Përbashkët Evropiane të Aviacionit. Kodi i Aviacionit Civil është përditësuar për ta sjellë legjislacionin më pranë standardeve evropiane. Në mars të vitit 2005, Shqipëria nisi një “Marrëveshje Horizontale” me Komunitetin Europian mbi disa aspekte të shërbimeve ajrore. Shqipëria po vazhdon negociatat mbi një marrëveshje të Hapësirës së Përbashkët Evropiane të Aviacionit me Bashkimin Europian. Ka nisur një program për inkorporimin e legjislacionit të BE-së mbi aviacionin. Duhet të zbatohen rekomandimet e korrikut 2005 të HPEA gjatë vizitës vlerësuese. Partnerët e Aeroportit të Tiranës nënshkruan një marrëveshje koncesioni për funksionimin e Aeroportit të Tiranës (Aeroportit Nënë Tereza/Rinas) në prill të vitit 2004. Ndërtimi i një infrastrukture të re të aeroportit, përfshirë një rrugë të re hyrjeje nga autostrada Tiranë – Durrës pritet

të nisë në 2005. Në fushën e transportit detar, shkalla e ndalimit e anijeve shqiptare për vitin 2004 ishte 31.43 %, duke e bërë atë flamurin me performancën më të keqe mes flamurëve me rrezikshmërinë më të lartë të Listës së Zezë të botuar nga Memorandumi i Mirëkuptimit i Parisit. Situata e sigurisë detare duket se është përmirësuar disi në vitin 2005, por shkalla e ndalimit mbetet në një nivel alarmues (22.9 % në 9 muajt e parë).

Për këtë arsye janë të nevojshme të kryhen përpjekje të fuqishme dhe të përvijohet një plan i qartë mbi përafrimin e legjislacionit, organizimin dhe menaxhimin administrativ, trajnimin e personelit dhe infrastrukturën. Për sa i takon zhvillimeve legjislative, një kod i ri detar u miratua në korrik të vitit 2004, duke mundësuar ngritjen e një Agjencie të re Kombëtare të Transportit Detar. Megjithatë, Shqipëria duhet të bëjë një punë të vazhdueshme që të përcaktojë me hollësi se si do të vihet në zbatim ky kod dhe veçanërisht se si do të lidhet agjencia e re me Drejtorinë e Përgjithshme të transportit detar në Ministrinë e Transportit dhe Telekomunikacionit. Shqipëria ka plotësuar gjithashtu në mars 2005 edhe procedurat për përputhshmëri me kodin e sigurisë së organizatës ndërkombëtare detare SOLAS ISPS. Në nëntor të vitit 2004 Shqipëria miratoi një ligj mbi zbatimin e këtyre kërkesave të sigurisë për anijet dhe portet. Për sa i takon privatizimit të operacioneve portale, është bërë progres, veçanërisht në portin e Durrësit. Sipas ligjit të tetorit 2003 të Autoritetit Portual, portet menaxhohen sipas rregullave tregtare nën drejtimin dhe kontrollin e një bordi mbikëqyrës. Megjithatë, ato janë ende pronë krejtësisht shtetërore dhe autonomia e autoritetit të portit të Durrësit është e eklipsuar nga varësia shumë e madhe nga disa ministri. Shqipëria ka si qëllim privatizimin progresiv të operacioneve portale, ku autoritetet portale të luajnë rolin e pronarit. Në një linjë me ligjin për Autoritetin Portual, Autoriteti i Portit të Durrësit dhe Departamenti Detar kanë përgatitur një plan veprimi për të plotësuar legjislacionin e nevojshëm zbatues. Në Durrës, një numër operacionesh portale si rimorkimi, pilotimi, furnizimi me ujë i anijeve, ngarkimi, pastrimi, shërbimet ushqimore dhe puna e hamejve është privatizuar, dhe një privatizim i mëtejshëm pritet nga fundi i vitit 2005. Përmirësimet në infrastrukturën portale, veçanërisht në Durrës dhe Vlorë, janë duke vazhduar. Përgjithësisht, pavarësisht nga një farë progresi në sektorin e transportit, hapa të mëtejshëm dhe investime të kujdesshme të shtrira në kohë janë të nevojshme në mënyrë që ky sektor të ketë një përmirësim të qëndrueshëm. Shqipëria duhet të sigurojë zbatimin e planit kombëtar për transportin. Përpjekje të mëtejshme nevojiten për ta sjellë legjislacionin për transportin më pranë standardeve evropiane, veçanërisht për sa i takon standardeve teknike, të sigurisë si edhe atyre të liberalizimit të tregut. Qeveria duhet që të ndërmarrë gjithashtu edhe reformën e nevojshme në sektorin hekurudhor. Mirëmbajtja e aseteve të transportit duhet të jetë e mirëplanifikuar

dhe e parashikuar në buxhetin vjetor. Procedurat e prokurimit publik duhet të aplikohen sistematikisht për investimet e mëdha si një tregues i qeverisjes së mirë dhe si një mjet për të arritur shpenzime të shëndosha publike. Më shumë përpjekje nevojiten gjithashtu edhe për të përmirësuar sigurimin e qarkullimit rrugor.

3.2.5. Energjia

Shqipëria ka bërë goxha progres në fushën e energjisë, megjithëse kriza e kohëve të fundit nuk është kaluar ende plotësisht. Enti rregullator për energjinë (ERE) po prodhon në mënyrë aktive një kuadër modern legjislativ bazuar në ligjin për sektorin energjetik të vitit 2003. Është bërë goxha progres edhe në respektimin e standardeve evropiane, sidomos për sa i përket efikasitetit energjetik. ERE financohet ekskluzivisht nga tarifat; bordi i anëtarëve emërohet nga Kuvendi pa përfshirjen e qeverisë. Qeveria ka vazhduar të zbatojë plan veprimin e rishikuar të vitit 2003 për zbatimin e strategjisë kombëtare të energjisë, duke miratuar një numër masash për të ristrukturuar dhe liberalizuar sektorin shqiptar të energjisë dhe për ta integruar atë në tregun në zhvillim të energjisë të Europës juglindore. Planveprimi siguron gjithashtu dhe përdorimin e lëndëve djegëse alternative dhe energji-kursyese, ndërtimin e një TEC-i të ri në Vlorë dhe prodhimin e vazhdueshëm të energjisë hidroelektrike. Vendi i përzgjedhur për ndërtimin e TEC-it në Vlorë ka çuar në shqetësime lidhur me impaktin ndaj mjedisit dhe rentabilitetin ekonomik dhe për këtë arsye duhet të rikonsiderohet. 98% e prodhimit të energjisë në Shqipëri rrjedh nga burime hidroelektrike. Zhvillimi ekonomik ka çuar në rritjen e kërkesës. Vlerësimi i aseteve të KESH, korporatës shtetërore ka nisur, megjithatë fatkeqësisht jo plotësisht në një linjë me modelin e tregut evropian, të cilin Shqipëria ka ndërmend ta miratojë nga viti 2008. Asetet e KESH janë ndarë si edhe është bërë një ristrukturim; kompania është ndarë në tre njësi operative: ajo e prodhimit, transmetimit dhe e shpërndarjes. Privatizimi i aseteve të prodhimit, rafinerisë dhe ofruesve të shërbimeve është nën proces. Aktualisht vazhdon të ekzistojë një blerës me shumicë i vetëm publik dhe sistemi i transmetimit mbetet në pronësinë e shtetit. Humbjet e energjisë elektrike janë reduktuar nga 39% në vitin 2003 në 36% në vitin 2004. Prodhimi i elektricitetit është rritur në mënyrë të ndjeshme falë një situatë të favorshme hidrologjike, por ende vazhdojnë ndërprerjet e energjisë. Mbledhja e të ardhurave është rritur lehtësisht nga 92% në 94% në vitin 2004, por arkëtimet në disa pjesë të vendit ende mbeten të pamjaftueshme. KESH po ecën drejt qëndrueshmërisë: subvencionet e shtetit për KESH janë ulur gjatë periudhës raportuese dhe kanë ndaluar në janar të 2005. Çmimi i energjisë për shtëpitë është rritur (10 % çdo

vit) dhe për konsumatorët e tjerë (5%) për të reflektuar më mirë kostot, ndërkohë që konsumatorët vulnerabël (191 000 ose një e katërta e të gjithë familjeve) kanë marrë subvencione të drejtpërdrejta nga qeveria që nga janari i vitit 2005. Sahate të veçantë të energjisë elektrike janë instaluar në mbi 200 000 shtëpi. Përpjekjet për një përdorim më të gjerë të gazit të lëngshëm, që ka një çmim më të lirë, sidomos për të zëvendësuar ngrohjen me energji elektrike, tani duket se kanë një përqafim më të gjerë në popullatë, e cila më parë shqetësohej për çështje të sigurisë për shkak të pajisjeve të vjetra që kish në përdorim. Shqipëria tashmë ka luajtur një rol shumë aktiv në themelimin e Traktatit të Energjisë për Europën Juglindore, sidomos gjatë presidencës së Greqisë nga janari deri në qershorin e vitit 2004, kur nisën dhe negociatat për traktatin. Traktati ka për qëllim krijimin e një tregu energjie rajonal të integruar për elektricitetin dhe gazin natyror si pjesë e tregut më të gjerë të BE-së. Ky traktat u siglua në 13 maj të vitit 2005 dhe u nënshkrua së fundmi. Përgjithësisht Shqipëria ka bërë progres të mirë, por kriza në sektorin energjetik duhet ende të kapërcehet. Shtëpitë dhe kompanitë vazhdojnë të kenë ndërprerje të shpeshta të energjisë. Humbjet e elektricitetit dhe lidhjet e paligjshme janë ende të larta, veç kësaj, edhe arkëtimet duhet të përmirësohen akoma. Pra, nevojitet një zbatim i suksesshëm i strategjisë dhe planveprimit të Shqipërisë për energjinë. Kapacitetet administrative duhet të forcohen akoma më shumë.

3.2.6. Information society and media

Shqipëria ka shënuar progres në sektorin e shoqërisë së informacionit dhe medias. Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit si edhe Enti rregullator i telekomunikacionit kanë ndryshuar ligjin e vitit 2000 për telekomunikacionin, duke çuar në një liberalizim të plotë së sektorit shqiptar të telekomunikacionit në 1 janar 2005. Hapi përfundimtar ishte çmontimi i monopolit për lidhjet ndërkombëtare në përputhje me angazhimet e Shqipërisë në kuadër të OBT, megjithëse deri në mesin e vitit 2005 nuk ka pasur kërkesa për licenca të lidhjeve ndërkombëtare. Shqipëria ka mbi 50 operatorë aktivë ruralë (me një numër relativisht të kufizuar abonentësh në total) dhe tre operatorë të licencuar të telefonisë celulare, dy nga të cilët janë aktualisht aktivë në treg. Që nga raporti i vitit të kaluar Enti Rregullator i Telekomunikacionit ka marrë vendime ku Albtelekomi dhe dy operatorët e telefonisë celulare njihen si operatorë mbizotërues në treg dhe vendime në lidhje me marrëveshjet e interkonjeksionit. Qëllimi i këtyre vendimeve, me anë të të cilave Enti Rregullator i Telekomunikacionit ka zbatuar dispozitat kombëtare legislative, është që të vendosë detyrime mbi operatorët SMP dhe të lejojë një metodë më homogjene në marrëveshjet e interkonjeksionit ndërmjet operatorëve. Megjithatë, përgjithësisht

këto vendime nuk u mirëpritën nga aktorët e tregut dhe duket se ato nuk e kanë përmirësuar gjendjen për operatorët e rinj. Sektori i komunikacionit elektronik është përmirësuar si për sa i përket shpërndarjes edhe sasisë së informacionit të shpërndarë, megjithëse në zona të largëta ka ende vatra problematike. Ky zhvillim ka ardhur si pasojë e rritjes së investimeve në sistemin e telefonisë fikse si edhe nga zgjerimi i tregut të telefonisë celulare. Numri i përdoruesve të telefonisë celulare ka njohur rritje të vazhdueshme gjatë vitit 2004 dhe, sipas operatorëve të telefonisë celulare, 80% e territorit të Shqipërisë – që i korrespondon 90% të popullsisë totale – është tashmë e mbuluar nga ky shërbim. Çmimet e telefonisë mbeten shumë më të larta se mesatarja e çmimeve në BE. Në shtator të vitit 2004, Ministria e Ekonomisë botoi ofertë të hapur për shitjen e Albtelekomit dhe bordi i drejtorëve kontaktoi me operatorë nga disa kompani të shteteve anëtare të BE-së, duke dhënë hollësi mbi kompaninë dhe planet e qeverisë. Pavarësisht nga përpjekjet, vetëm një kompani paraqiti ofertë. Marrëveshja e shitjes u nënshkrua ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë dhe asaj kompanie, por në tetor të vitit 2005 Kuvendi hodhi poshtë ratifikimin e kontratës së privatizimit. Shqipëria ka bërë progres në liberalizimin dhe përmirësimin teknik të sektorit të komunikacionit elektronik. Megjithatë, në mënyrë që të tërhiqen investime të tjera për këtë sektor, Shqipëria duhet të garantojë plotësimin e legjislacionit të kërkuar, në mënyrë që mos të krijohen barrierë për hyrjen në treg dhe që ky legjislacion të zbatohet. Legjislacioni i ri ose i ndryshuar duhet të marrë parasysh kuadrin rregullator të zbatueshëm aktualisht në BE. Shqipëria duhet të forcojë rolin dhe kapacitetin e ERT dhe të lejojë që ai të ekzekutojë masat zbatuese në një mënyrë të pavarur, transparente dhe jo diskriminuese. Duhet të krijohet një sistem i qartë apelimi, me faktorë gjyqësorë racionalë dhe të kualifikuar. Duhet të adresohet hendeku ligjor për normat në zonat urbane, që krijon një situatë të tillë në të cilën ofruesit mund të kryejnë aktivitetin vetëm në nivel kombëtar ose rural. Në mënyrë që të sigurohet një treg konkurrues për telefoninë fikse, tarifat e operatorëve të telefonisë fikse duhet të ribalancohen dhe duhet të vihet në funksionim e drejta për të për zgjedhur një rrjet shpërndarës, porta hyrëse dhe një akses lokal të pakufizuar. Në fushën e shërbimeve të shoqërisë së informacionit, Shqipëria ka nënshkruar dhe ratifikuar Konventën e Këshillit të Europës mbi Krimin Kibernetik, por duhet të përafrojë legjislacionin e saj me *acquis* mbi tregtinë elektronike dhe shërbimet e kushtëzuara të aksesit. Raportohet progres në fushën e politikës audiovizuale. Hedhja poshtë e projekt ligjit për transmetimet dixhitale ishte një hap pozitiv, meqë përmbante ndryshime, që nëse do të miratoheshin, mund të kishin krijuar një situatë monopoli. Shqipëria duhet që të marrë masat e duhura për të miratuar legjislacionin mbi shërbimet dixhitale dhe median elektronike në përputhje me standardet evropiane dhe të nisë procesin e përafrimit të

legjislacionit me Konventën Europiane mbi Televizionin Ndërkufitar dhe Direktivën e Televizionit pa kufi. Përveç kësaj, autoritetet shqiptare duhet të rinisin diskutimet mbi projekt strategjinë për zhvillimin e transmetimeve televizive dhe finalizimin e Planit Kombëtar për Radion dhe Televizionin. Shqipëria duhet të vazhdojë të përforcojë kapacitetet e Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit në mënyrë që ai të monitorojë në mënyrën e duhur dhe të zgjidhë problemet në lidhje me mbledhjen e taksave të transmetimit nga disa transmetues privatë, si edhe të shmangë diskriminimin mes transmetuesve. Nevojitet gjithashtu që të përmirësohet zbatimi i Aktit të Lirisë së Informacionit dhe të sigurohet përputhshmëria me Ligjin mbi të drejtën e autorit duke luftuar piraterinë që është shumë e përhapur. Përgjithësisht, është vërejtur progres në komunikacionet elektronike dhe teknologjinë e informacionit, por mbetet shumë për të bërë në kuadrin përkatës ligjor për ta përafuar atë me *acquis communautaire* si edhe për të siguruar zbatimin e duhur dhe jo diskriminues. Shqipëria duhet të analizojë gjithashtu edhe mënyrat për përmirësimin e procedurave të privatizimit në mënyrë që të mundësohet privatizimi i suksesshëm i Albtelekomit.

3.2.7 Kontrolli financiar

Shqipëria ka bërë progres në fushën e **Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik (KBFP)**. Ministria e Financave ka nisur një strategji për zhvillimin e sistemit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik në përputhje me standardet ndërkombëtare. Kjo Ministri ka zhvilluar një kartë politikash për KBFP dhe një plan veprimi që është miratuar në qershor të vitit 2005 nga Komiteti ndërmintor i Politikës Ekonomike dhe nga Këshilli i Ministrave. Karta e politikave parashtron parimet themelore të llogarive menaxheriale dhe një auditim të brendshëm të pavarur në sektorin publik, megjithatë, një zhvillim i mëtejshëm do të ishte dobiprurës. Funkzioni i inspektimit duhet të përcaktohet qartësisht si i ndarë nga funksionet e tjera të kontrollit dhe të auditimit të brendshëm. Ministria e Financave duhet të nisë hartimin e ligjeve për KBFP në një kuadër gjithëpërfshirës ndërkohë që duhet të sigurojë një konsensus të gjerë ndërmjet aktorëve kryesorë. Në këtë kuadër, legjislacioni aktual duhet të ndryshohet në mënyrë koherente. Shqipëria duhet të krijojë një njësi qendrore përgjegjëse për futjen e menaxhimit financiar dhe të sistemeve të kontrollit në administratën publike. Kjo duhet bërë duke krijuar dy organizma qendrorë të pavarur, një për auditimin e brendshëm dhe një për kontrollin e brendshëm financiar. Këto organizma duhet të bashkëpunojnë ngushtësisht por të jenë të pavarura. Në maj të vitit 2005, Ministria e Financave miratoi një program

kualifikimi dhe një rregull për certifikimin e auditorëve të brendshëm në sektorin publik. Ministria duhet të vazhdojë programet e trajnimit për menaxherët e buxhetit, oficerët financiarë dhe auditorët e brendshëm. Në fushën e **auditimit të jashtëm**, Kontrolli i Lartë i Shtetit i Shqipërisë duhet të përmirësohet në përputhje me udhëzimet e Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve të Kontrollit Financiar, si edhe duhet të sigurohet pavarësia e tij financiare.

3.2.8 Politika të tjera

Progresi për sa i përket **punësimit** dhe **politikave sociale**, është pjesë e punës drejt standardeve evropiane. Përpjekje të tjera për zbatimin e të drejtave ekonomike dhe sociale si edhe për të nxitur punësimin e për të përkrahur dialogun social, do të kontribuojnë në përmirësimin e qeverisjes dhe të performancës ekonomike.

3.3 Drejtësia, liria dhe siguria

3.3.1. Viza, kontrolli i kufijve, azili dhe migracioni

Shqipëria ka bërë progres në fushat e vizave, azilit dhe migrimit, si edhe një progres mjaft të mirë në menaxhimin e kufijve. Shqipëria e ka liberalizuar regjimin e vizave për shtetet e reja anëtare të Bashkimit Europian që prej qershorit 2003, me përjashtim të Maltës dhe Qipros. Parimi i reciprocitetit për sa i takon regjimit të vizave zbatohet ndërmjet Shqipërisë dhe vendeve të tjera të Ballkanit perëndimor, me përjashtim të Kroacisë, shtetasit e së cilës nuk kërkojnë vizë për të hyrë në Shqipëri, kurse shtetasit shqiptarë kërkojnë vizë për të hyrë në Kroaci. Pasaportat me afat dhjetëvjeçar që përmbajnë elemente sigurie janë në përdorim për shtetasit shqiptarë. Pasaportat e vjetra pesëvjeçare mbeten në përdorim deri në afatin e skadencës. Ndryshimet në Ligjin për të Huajt, që kanë për qëllim rritjen e përputhshmërisë me standardet e BE-së veçanërisht në fushën e politikës së vizave, i janë paraqitur Komisionit Parlamentar për Ligjet në fillim të vitit 2004 dhe duhet të miratohen pa vonesë nga Kuvendi. Në legjislacionin ekzistues duhet të futen ndryshime për të siguruar nxjerrjen e dokumenteve të udhëtimit në përputhje me standardet evropiane; veç kësaj duhet të ngrihet sa më shpejt që të jetë e mundur një rrjet qendror IT dhe një bazë të dhënash e lidhur me zyrat konsullore jashtë vendit për administrimin e vizave. Deri sa të jetë kryer kjo, praktika e dhënies së vizave në pikat kufitare mbetet një shqetësim. Shqipëria ka bërë në progres të konsiderueshëm për përmirësimin e **kontrollit kufitar** dhe për mbikëqyrjen në kuadrin e “Strategjisë për kontrollin dhe menaxhimin e integruar të kufijve 2003-2006”. Menaxhimi është përmirësuar falë një ristrukturimi që është kryer në tetor të vitit 2004. Kontrollat për

imigrimin në pikat kufitare janë përmirësuar nëpërmjet funksionimit më të mirë të rrjeteve IT si edhe disponueshmërisë së pajisjeve për ekzaminimin e dokumenteve në të gjithë pikat kryesore të kalimit. Futja e njësive të lëvizshme mbikëqyrëse e ka bërë kontrollin e kufijve shumë më efikas, sidomos në luftën kundër trafikut të qenieve njerëzore dhe drogës.

Shqipëria ka marrë masa në kuadër të marrëveshjeve ekzistuese, për të përforcuar bashkëpunimin me fqinjët në luftën kundër krimit ndërkufitar, gjë që ka çuar në një ulje të volumit të vlerësuar të migrimit të paligjshëm dhe të trafikimit drejt BE-së, nëpërmjet detit Adriatik dhe detit Jon.

Megjithatë, trafikimi nëpërmjet kufijve të Shqipërisë me fqinjët e saj të Ballkanit Perëndimor, si edhe migrimi i paligjshëm për në Greqi, mbeten problematike. Burime të tjera financiare dhe njerëzore duhet të përqendrohen në adresimin e këtij problemi; Shqipëria duhet të marrë masa për të siguruar një bashkërendim efikas ndërmjet shërbimeve që operojnë në kufi. Në veçanti, Shqipëria duhet të qartësojë ndarjen e përgjegjësisive ndërmjet Policisë Kufitare dhe Shërbimit Doganor për kontrollin e kufijve. Këto çështje të bashkërendimit duhet të adresohen si pjesë e zhvillimit të një strategjie për Manaxhimin e Integruar të Kufijve, në përputhje me udhëzimet e BE-së për Ballkanin Perëndimor. Një strategji e tillë duhet të sigurojë gjithashtu edhe një sistem të kuptueshëm dhe efikas IT me qëllim që të lejojë policinë dhe shërbimet kufitare që të vihen në dijeni me shpejtësi për pasaportat e vjedhura ose pullat e vizave, si edhe për të regjistruar personat që kalojnë transit në vend. Një strategji kombëtare për **migrimin** u miratua në nëntor të vitit 2004 dhe plani përkatës i veprimit në maj të vitit 2005. Zbatimi i strategjisë do të mbikëqyret nga një Ministër Shteti. Në marsin e vitit 2005, Shqipëria miratoi Konventën ILO Migrim për Punësim. Shqipëria nuk është palë e Konventës Europiane mbi Statusin Ligjor të Punëtorëve Emigrantë. Nënshkrimi i marrëveshjes së ripranimit BE-Shqipëri në prill të vitit 2005 tregoi dëshirën e madhe të Shqipërisë për të pranuar përgjegjësitë e saj ndërkombëtare në këtë fushë dhe siguroi kuadrin për marrëveshje dypalëshe me shtetet anëtare të BE-së. Aktualisht, Shqipëria ka marrëveshje ripranimi me Italinë, Belgjikën, Hungarinë, Zvicrën, Bullgarinë, Rumaninë, Kroacinë, Gjermaninë dhe Mbretërinë e Bashkuar. Marrëveshjet dypalëshe me Holandën, Luksemburgun, ish Republikën e Maqedonisë, dhe Republikën sllovaqe janë në përgatitje e sipër. Nuk ka ende marrëveshje me Bosnjën dhe Hercegovinën apo me Serbinë dhe Malin e Zi. Shqipëria duhet të lidhë marrëveshje ripranimi jo vetëm me fqinjët e saj rajonale por edhe me vendet e origjinës së migrantëve që kalojnë transit nëpër të. Manaxhimi i rasteve të azilit nga Drejtoria e Refugjatëve në Ministrinë e Rendit Publik, ka nisur të përmirësohet, pjesërisht si pasojë e ndryshimeve legislative, sidomos për sa i

takon procedurave për garantimin e mbikëqyrjes së afateve kohore në ndjekjen e rasteve të azilit, si edhe në prodhimin dhe përhapjen e njoftimeve të duhura.

Kjo drejtori, ka rifreskuar gjithashtu në shkurt të vitit 2005 edhe Planin Kombëtar të Veprimit të Vitit 2003 mbi Azilin. Masat zbatuese duhet të miratohen për sa i takon menaxhimin dhe furnizimin për azil-kërkuesit.

Nevojiten gjithashtu edhe disa rregullime legjislative: pa përputhshmëritë mes Ligjit për Azilin dhe Ligjit për të Huajt duhet të hiqen. Kapacitete të mjaftueshme administrative dhe financiare duhet të përqendrohen në zbatimin e legjislacionit ekzistues, sidomos të plan veprimeve për azilin dhe migrimin.

3.3.2. Pastrimi i parave

Shqipëria ka bërë progres në luftën kundër pastrimit të parave, por duhen bërë ende përpjekje më të mëdha. Legjislacioni i vitit 2003 kundër pastrimit të parave u përforcua nga masa të reja zbatuese gjatë vitit 2004, megjithëse fakti që përdorimi i mallrave të vjedhura nuk konsiderohet shkelje penale, mbetet një shqetësim. Tani më shumë transaksione i raportohen autoriteteve të duhura; edhe institucionet jobankare si për shembull kazinotë janë përfshirë në kërkesat raportuese. Komiteti Kombëtar për Koordinimin e Luftës kundër Pastrimit të Parave i drejtuar nga Kryeministri me përfshirjen e Bankës së Shqipërisë, Prokurorit të Përgjithshëm, Shërbimit Informativ Shtetëror, dhe Ministrave të Financës, Rendit Publik, Mbrojtjes dhe Drejtësisë, u mblodh për herë të parë në mars të vitit 2004. Paralelisht, në mars të vitit 2004, u ngrit edhe një grup pune teknik i përbërë nga përfaqësues të Njesisë së Inteligjencës Financiare në Ministrinë e Financës, shërbimeve inteligjente dhe prokurisë. Në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar, është nënshkruar një marrëveshje mbi pastrimin e parave me Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë në janar të vitit 2004, ndërkohë që më parë janë nënshkruar marrëveshje të këtij tipi me Slloveninë dhe Bullgarinë. Pas një vendimi në shkurt të vitit 2005, Njësia e Inteligjencës Financiare është pajisur me personel shtesë dhe, së bashku me prokuroritë dhe Njësinë e Krimit Ekonomik të Policisë së Shtetit shqiptar, po merret tani me çështjet e para.

Duhet të ruhet ky nivel i progresit legjislativ; kapacitetet administrative duhet të forcohen më tej dhe të pasohen nga një zbatim efikas. Në veçanti, Shqipëria duhet të garantojë që legjislacioni i saj kundër pastrimit të parave të jetë në përputhje me zhvillimet më të fundit të *acquis*. Shqipëria duhet të vazhdojë punën për hartimin e ndryshimeve në ligjin ekzistues për Parandalimin e Pastrimit të Parave në mënyrë që të sigurojë përputhshmëri me standardet evropiane, përfshirë rekomandimet e Task Forcës për Veprimin Financiar. Mbikëqyrësve të enteve raportuese, Njësia e Inteligjencës Financiare, prokurorive

dhe Njesisë së Krimit Ekonomik duhet ti sigurohen burimet e duhura financiare dhe IT; si edhe duhet të përcaktohet më qartë pavarësia operationale e Njesisë së Inteligjencës Financiare nga Ministria e Financave. Duhet të përmirësohet niveli i bashkërendimit të punës ndërmjet agjencive. Kjo duhet të kryhet nëpërmjet një bashkëpunimi më të mirë me autoritetet e vendeve të tjera, sidomos nëpërmjet një përdorimi më aktiv të Rrjetit Rajonal të Inteligjencës Financiare. Duhet të bëhen përpjekje urgjente për të shtrënguar akoma më shumë legjislacioni kundër pastrimit të parave për sa i takon dënimeve, konfiskimeve, bllokimit dhe ngrirjes së aseteve. Deri më sot, nuk ka pasur procedime penale për mos përputhshmëri me rregullat raportuese. Shtrëngimi i duhur i detyrimit raportues duhet të nisë në mënyrë urgjente. Mes të tjerash, duhet të ekzaminohet edhe pragu aktual relativisht i lartë për raportimin e një transaksioni si të detyrueshëm. Zgjerimi i fushës së shtrirjes së legjislacionit kundër pastrimit të parave përtej veprimtarive bankare, duhet të përputhet me një shtrëngim më të mirë në sektorë të tjerë. Një shtrëngim efikas i legjislacionit në këtë fushë pengohet gjithashtu si nga korrupsioni, nga krimi i organizuar dhe nga ekonomia gjerësisht informale me nivele të larta transaksionesh në *cash*. Është e rëndësishme që të vihet në funksionim një mekanizëm për kontrollin e kartëmonedhave. Suksesi i Shqipërisë në luftën kundër pastrimit të parave, është i lidhur dukshëm me progresin në fusha më të gjera si për shembull korrupsioni, krimi i organizuar dhe zhvillimi ekonomik. Shqipëria duhet të shqyrtojë mënyrat për të lehtësuar transferimin e parave nga jashtë shtetit, gjë që mund të ndihmojë gjithashtu edhe në uljen graduale të nivelit të parave që qarkullojnë në vend e në këtë mënyrë në uljen e mundësive për pastrimin e parave.

3.3.3. Droga

Shqipëria ka shënuar progres në luftën kundër shitjes së drogave të paligjshme, por duhet të bëhen përpjekje të tjera. Shqipëria vazhdon të jetë një vend kryesor tranziti për trafikimin e drogës si edhe një vend në të cilin numri i brendshëm i përdoruesve është në rritje. Ekziston legjislacioni i duhur për trafikimin e drogës, i cili përcakton dënime të ashpra për ata që dënohen.

Shqipëria miratoi një Strategji Kombëtare kundër drogës për periudhën 2004-2010 në maj të vitit 2004, si edhe planin e veprimit përkatës në shtator 2004.

Duhet të garantohet përputhshmëria me Strategjinë e BE-së kundër drogës për periudhën 2005-2012 si edhe me planin e veprimit të BE-së për periudhën 2005-2008. Shqipëria duhet të përmirësojë kapacitetet e saj për të kryer hetime efikase kundër drogës, duke përmirësuar trajnimin, menaxhimin dhe pajisjen e oficerëve të antidrogës në polici, sidomos në Departamentin e Antidrogës, por gjithashtu edhe në drejtori të tjera të policisë. Vihet re sukses në luftën kundër kultivimit

dhe trafikimit të hashashit. Në kuadrin e Strategjisë kombëtare, është nënshkruar në prill të vitit 2005 nga Ministri i Rendit Publik, Ministri i Pushtetit Lokal dhe Decentralizimit si edhe Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit një Marrëveshje për ndalimin e kultivimit të kanabisit në Shqipëri. Që atëherë, janë kryer disa konfiskime dhe shkatërrime të mbjellash. Përdorimi i Mjeteve të veçanta të hetimit, si për shembull shpërndarja e kontrolluar dhe simulimi i blerjeve të drogës nga ana e policisë, janë futur ligjërisht në shtator 2004 dhe janë kryer dhe trajnime për këto teknika. Është futur legjislacioni për konfiskimin e aseteve të trafikantëve të dënuar. Është nënshkruar gjithashtu edhe një marrëveshje mes Ministrisë së Rendit Publik dhe Ministrisë së Shëndetësisë për shtrëngimin e kontrollit për qetësuesit dhe lëndët narkotike që përdoren për qëllime mjekësore. Progres i rëndësishëm është regjistruar për sa i takon shifrave të drogës së kapur, veçanërisht heroinës – në vitin 2004 janë kapur 240.6 kg, më shumë se në tre vitet e mëparshme marrë së bashku (190.9kg).

E megjithëse shifrat për drogën e kapur janë rritur, sasi të vogla janë të vogla krahasuar me sasi të duket se kalojnë nëpër Shqipëri. Shqipëria duhet ti japë një përparësi shumë më të madhe dhe financim zbatimit efikas të Strategjisë Kombëtare kundër drogës dhe planit të veprimit të saj.

Shqipëria duhet të vazhdojë përpjekjet në lidhje me prodhimin e brendshëm të hashashit dhe të bëjë përpjekje të bashkërenduara për të rritur shtrëngimin e ligjit kundër trafikut të heroinës dhe kokainës, si edhe të marrë masa për të identifikuar shkallën dhe natyrën e prodhimit të brendshëm të drogave sintetike. Shqipëria duhet të bëjë përpjekje të tjera të bashkërenduara për të parandaluar pengimin e hetimeve, duke identifikuar dhe ndjekur penalisht përgjegjësit për korrupsion në lidhje me tregtimin e drogës në të gjithë nivelet e administratës publike, veçanërisht në polici dhe në gjyqësor. Shqipëria duhet të marrë masa për të siguruar një bashkëpunim më të mirë si brenda për brenda ashtu edhe me partnerë në vende të huaja me qëllim shkatërrimin e rrjeteve të drogës. Autoritetet shqiptare duhet të garantojnë një transparencë më të madhe në lidhje me shifrat e drogës së kapur, dhe të sigurohen për asgjësimin e drogës së kapur në të kaluarën e cila aktualisht ndodhet nën një ruajtje të papërshtatshme.

3.3.4. Policia

Është shënuar progres në rritjen e efikasitetit të Policisë së Shtetit shqiptar gjatë periudhës raportuese. Policia e Shtetit shqiptar është riorganizuar krejtësisht pas një vendimi administrativ të shtatorit 2004, që hyri në fuqi në tetor të vitit 2004. Elementet kyçe për ristrukturimin ishin krijimin e një Drejtorie të kompletuar kundër krimit të organizuar dhe forcimi i Zyrës për Kontrollin e Brendshëm.

Struktura e re organizative e policisë është më shumë në përputhje me agjencitë e BE-së për ruajtjen e rendit.

Tani mbetet për të provuar efikasitetin e saj operacional. Progres i dukshëm është bërë në luftën kundër korrupsionit në radhët e policisë, pas vënies në zbatim të reformës të fillimit të vitit 2004 “Rend brenda Rendit”, si edhe pas miratimit të disa ndryshimeve ligjore që synonin rritjen e kompetencave të kontrollit të brendshëm të policisë. Këto masa kanë rezultuar në pushimin nga puna të një numri të madh oficerësh të policisë (340 syresh gjatë periudhës raportuese) dhe në një rritje shumë të madhe të numrit të ndjekjeve penale kundër oficerëve të policisë që i janë paraqitur prokurorisë nga policia (323 në 2004 krahasuar me 190 në 2003), një e treta prej të cilëve përfshinte zyrtarë të lartë ose të mesëm.

Shqipëria duhet të bëjë përpjekje të mëtejshme për të përmirësuar menaxhimin e policisë, veçanërisht për sa i takon burimeve njerëzore dhe transparencës, në mënyrë që të shënojë progres të mëtejshëm drejt standardeve Europiane. Policisë duhet ti jepet gjithashtu kompetenca që të menaxhojë në mënyrë të pavarur burimet e saj financiare dhe materiale, që aktualisht kontrollohen nga Ministria e Rendit Publik, në mënyrë që të rritet autonomia e policisë dhe të minimizohet rreziku i ndërhyrjeve politike. Policia duhet gjithashtu që të garantojë zbatimin e plotë të ligjit mbi gradat. Çështja e planifikimit pasues për poste kyçe në polici, duhet të adresohet në një mënyrë më efikase në mënyrë që të sigurohet vazhdimësia dhe efikasiteti i procesit të reformës. Shqipëria duhet të vazhdojë të përmirësojë administrimin e dosjeve të policisë, përfshirë aksesin në këto dosje nga administrata e mesme. Shqipëria duhet të vazhdojë të analizojë ligjin e vitit 1999 për Policinë e Shtetit me qëllim përditësimin e tij në mënyrë që ai të jetë në përputhje me nevojat e Shqipërisë. Shqipëria duhet të përshpejtojë përpjekjet për të bërë një marrëveshje me Europolin; në janar të vitit 2005 Europoli sugjeroi një metodë me dy faza që do të niste me “një marrëveshje strategjike” dhe do të vazhdonte në rrugën e duhur me një bashkëpunim operacional, por që nga ajo kohë është shënuar shumë pak progres. Përgjithësisht, Policia e shtetit shqiptar ka shënuar progres në miratimin e një strukture shumë më efikase me mekanizma të përmirësuar të rregulloreve të brendshme dhe me rezultate më të mira na luftën kundër korrupsionit. Megjithatë, Shqipëria ka mjaft vend që të përmirësojë legjislacionin, menaxhimin, infrastrukturën dhe bashkëpunimin ndërkombëtar lidhur me punën e policisë.

3.3.5. Lufta kundër krimit të organizuar dhe terrorizmit

Shqipëria ka bërë progres në luftën kundër krimit të organizuar dhe terrorizmit. Kuadri legjislativ për luftën **kundër krimit të organizuar** është përmirësuar me miratimin e të ashtuquajturës ‘paketa anti-mafia’ në shtator të vitit 2004, që

konsiston në një ligj për luftën kundër krimit të organizuar, një ligji kundër financimit të terrorizmit dhe një ligji për mbrojtjen e dëshmitarit dhe të personave që bashkëpunojnë me autoritetet.

Këto ligje, sigurojnë përkufizimin shumë të nevojshëm ligjor për një organizatë kriminale dhe për trafikimin e qenieve njerëzore. Kjo paketë parashikon gjithashtu dhe përdorimin e mjeteve speciale të hetimit, trajton çështje të korrupsionit dhe të shpërdorimit të detyrës, si edhe shpërblen bashkëpunimin me autoritete. Është bërë progres në zbatimin masave specifike vepruese kundër krimit të organizuar, që i janë paraqitur BE-së në nëntor 2003 dhe në dhjetor 2004. Nën-Drejtorja e Krimit të Organizuar në Ministrinë e Rendit Publik dhe Njësia e Inteligjencës Financiare në Ministrinë e Financës kanë pësuar ngritje duke marrë statusin e drejtorisë. Kësaj drejtorie i janë dhënë ambiente më të mëdha dhe numër më i madh personeli. Në paketën anti mafia u futën ligje mbi transferimin e barrës së provës për sa i takon të ardhurave që dyshohet se vijnë nga krimi dhe mbi konfiskimin e aseteve. Janë miratuar masa fillestare zbatuese për një agjenci për konfiskimin e aseteve. Nisma kundër Krimit të Organizuar, në të cilën specialistët e shteteve anëtare në kuadrin e asistencës së KE-së, ndihmojnë forcat tona të rendit në terren, është shtrirë përtej Durrësit, Vlorës dhe Tiranës për të mbuluar më tepër pikëkalimet kufitare dhe ka kontribuar në zbulimin e një sërë operacioneve të mëdha kontrabandiste. Progresi në zbatimin e masave specifike vepruese kundër krimit të organizuar duhet të përshpejtohen: Shqipëria duhet të bëjë investime të tjera në IT për Njësinë e Inteligjencës Financiare dhe të adresojë shqetësimet për pavarësinë e saj nga Ministria e Financave. Gjyqtarët shqiptarë, prokurorët dhe oficerët e policisë, me ndihmën e aktorëve ndërkombëtarë, duhet të rishikojnë dispozitat e reja ligjore për transferimin e barrës së provës dhe për ligjet mbi konfiskimin e aseteve në mënyrë që të heqin zbrazëtirat ligjore dhe dispozitat e mangëta. Shqipëria duhet të miratojë masa të tjera zbatuese që nevojiten në këto fusha dhe në fushën e mbrojtjes së dëshmitarit. Duhet marrë masa legjislative për të penalizuar mbajtjen e mallrave të vjedhura. Shqipëria duhet të zhvillojë udhëzime operacionale në lidhje me mbrojtjen e dëshmitarit dhe të marrë hapa të menjëhershme për të trajtuar aspektet bazë të mbrojtjes së dëshmitarit, si mbrojtja e dëshmitarit në gjykatë dhe intervista në distancë. Duhet të vihen në zbatim më me vendosmëri marrëveshjet e lidhura me partnerë rajonale dhe ndërkombëtarë në lidhje me luftën kundër krimit të organizuar. Megjithatë, mungesa e një autoriteti për mbrojtjen e të dhënave personale e kufizon mbrojtjen e këtyre të dhënave dhe parandalon shkëmbimin e të dhënave me institucione të ruajtjes së rendit në vende të tjera. Shqipëria duhet ti përdore me më shumë vendosmëri dispozitat e ligjeve të reja mbi krimin e organizuar në mënyrë që të trajtojë problemin e korrupsionit në organet e ruajtjes së rendit.

Duhet të rritet përdorimi i mjeteve speciale të hetimit, përgjimi i telekomunikacioneve dhe përdorimi i informacionit të inteligjencës. Shqipëria duhet të përshpejtojë harmonizimin e Kodit Doganor dhe procedurave penale. Mbi të gjitha, Shqipëria duhet të përdorë mjetet që tani po i fut në mënyrë efikase, për të arrestuar dhe ndjekur penalisht kriminelët e organizuar, përfshirë dhe ata më të fuqishmit. Shqipëria po vazhdon të zbatojë strategjinë anti-trafik të vitit 2003. **Trafiku i qenieve njerëzore** nga deti Adriatik dhe Jon është ulur në mënyrë të ndjeshme. Qendra Antitrafik në Vlorë, ka luajtur një rol të kufizuar por pozitiv si një zyrë shkëmbimesh mes vendeve të informacioneve dhe inteligjencës mbi çështjet e trafikimit. Në nëntor të vitit 2004, Shqipëria ratifikoi një marrëveshje bashkëpunimi me ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë mbi luftën kundër terrorizmit, krimit të organizuar, trafikut të drogës dhe migrimit ilegal. Analistët në nëndrejtorinë e krimit të organizuar në polici tani po bëjnë një punë më të mirë duke u përqendruar në ekzaminimin e të dhënave dhe në jo futjen e tyre në sistem. Progres është shënuar në miratimin e legjislacionit zbatues mbi mbrojtjen e dëshmitarit, me gjashtë akte të reja zbatuese të miratuara në qershor dhe korrik të vitit 2005, dhe që tashmë kanë hyrë në fuqi. Përkrah ligjit të ri kundër financimit të terrorizmit, ngritje e Drejtorisë Kundër terrorizmit në Policinë e Shtetit Shqiptar në tetor të vitit 2004, shënoi një hap shumë të rëndësishëm. Shqipëria i ka mbështetur hapur nismat ndërkombëtare për luftën kundër terrorizmit dhe është duke transponuar progresivisht e duke zbatuar rezolutat përkatëse të Këshillit të Sigurimit të OKB-së dhe konventat ndërkombëtare. Shqipëria ka dëbuar nga vendi të dyshuar si mbështetës të terrorizmit. Shqipëria duhet të përshpejtojë përpjekjet për të transponuar krejtësisht këto masa në legjislacionin e brendshëm dhe për ti zbatuar ato, në mënyrë që të jetë në gjendje ti sjellë terroristët e dyshuar para drejtësisë mbi bazën e parimit që kërkon ose ekstradim ose ndjekje penale. Hapa të rëndësishëm janë gjithashtu në vazhdim për të përmirësuar sigurinë në fluturime dhe aeroport, por siguria në aeroportin e Tiranës nuk është ende në standardet ndërkombëtare. Shqipëria duhet të marrë masa për të rritur bashkëpunimin ndërmjet gjyqësorit dhe policisë në mbarë vendin, por sidomos për sa i takon Drejtorisë së Krimit të Organizuar dhe Policisë së Shtetit Shqiptar dhe Prokurorisë së Përgjithshme. Përgjegjësitë specifike e agjencive të shumta, duke nisur që nga Drejtoria Anti Terrorizëm e deri tek Njësia e Inteligjencës Financiare, duhet të qartësohen në mënyrë që të krijohet një sistem koherent dhe i mirëorganizuar i mbledhjes së inteligjencës dhe i ruajtjes së rendit. Përgjithësisht, Shqipëria ka bërë progres në luftën kundër krimit të organizuar dhe terrorizmit duke vendosur një bazë më të shëndoshë ligjore dhe administrative për punën në këtë fushë, duke përmirësuar kapacitetet ligjore, veçanërisht në lidhje me pastrimin e parave dhe duke forcuar bashkëpunimin

ndërkombëtar, por edhe duke mbështetur nismat ndërkombëtare. Megjithatë, pjesa më e madhe e progresit të deritanishëm të Shqipërisë në fushën e krimit të organizuar në veçanti, ka konsistuar në vendosjen e një kuadri: tani Shqipërisë i duhet që të ngrihet mbi këtë kuadër dhe ta përdorë që të përftojë rezultate.

3.4 Vlerësim i përgjithshëm

Shqipëria ka bërë relativisht progres në përmbushjen e standardeve europiane. Progresi kryesisht konsiston në miratimin e legjislacionit të ri dhe ngritjen e institucioneve të reja. Gjithashtu janë bërë disa përpjekje për forcimin e kapaciteteve administrative, por në disa raste nevojiten më shumë angazhime dhe burime për arritjen e një progresi të mëtejshëm.

Për sa u takon çështjeve të *tregut të brendshëm*, Shqipëria vazhdon të shënojë progres në fushën e *lëvizjes së lirë të mallrave*. Standardizimi dhe certifikimi kanë përparuar në mënyrë të kënaqshme, por i duhet kushtuar më tepër vëmendje vënies në zbatim të direktivave të Përqasjes së Re dhe të Vjetër Globale.

Nuk ka pasur zhvillime legjislative në metrologji, dhe mjetet për testim janë të mangëta. Kërkohej progres i konsiderueshëm dhe i mëtejshëm ligjor dhe administrativ për mbikëqyrjen e duhur të tregut. Duhet të përmirësohen dhe të zbatohen ligjet e mbrojtjes së konsumatorit. Në lidhje me *lëvizjen e personave, shërbimeve dhe të drejtës së vendosjes*, Shqipëria vazhdon të përballet me problemin e emigrimit. Legjislacioni për vendosjen është relativisht i hapur, por kërkon ndryshime për të zhdukur diskriminimin ndërmjet firmave vendëse dhe të huaja. Rregullat për sigurimin e shërbimeve janë mjaft liberale. Nuk ka pasur zhvillime domethënëse për sa i takon *lëvizjes së kapitalit*.

Shqipëria ka bërë progres të konsiderueshëm në fushën e rregullave *doganore*; është rritur mbledhja e të ardhurave doganore, ndërsa progresi në fushat që kanë lidhje me të ka qenë më i kufizuar dhe kërkohej veprim i mëtejshëm kundër korrupsionit në shërbimin doganor. Legjislacioni *tatimor* është përmirësuar, ku kanë përfituar veçanërisht SME-të. Një zhvillim pozitiv ka qenë transferimi i sektorit të mbledhjes së kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, në administratën tatimore. Legjislacioni *tatimor* duhet të vihet në zbatim me drejtësi dhe transparencë, dhe mbledhja e të ardhurave duhet përmirësuar.

Në fushën e *konkurrencës*, kërkohej më tepër punë në mënyrë që aktorët e tregut të kuptojnë më gjerësisht parimet e saj. Progres është arritur veçanërisht për sa i takon ndihmës shtetërore, me ngritjen e një departamenti të ndihmës shtetërore dhe miratimin e legjislacionit të ri. Rregullat ekzistuese të prokurimit publik duhet të respektohen, dhe legjislacioni përkatës kërkon punë të konsiderueshme që të sigurojë përputhshmërinë me standardet e BE-së.

Është miratuar legjislacioni i ri për *të drejtat e pronësisë intelektuale*, por duhet të rritet vënia në zbatim. Progres është bërë në sistemin e statistikave, sidomos në përpilimin dhe krijimin e një regjistri biznesi, që tashmë duhet të zgjerohet. Statistikat makroekonomike duhen përmirësuar. Për sa i takon *politikave sektoriale, industria dhe sektori SME* treguan vetëm progres të kufizuar, megjithatë ky sektor ka përfituar nga masat e mësipërme në fushën e tatimeve. Shqipëria duhet të zbatojë plotësisht planin e veprimit, për të zvogëluar barrierat administrative dhe për të trajtuar ekonominë informale.

Sektorët e bujqësisë dhe peshkimit, kanë bërë progres të pakët. Bujqësia vazhdon të funksionojë si zbutës ekonomik dhe social, duke ulur varfërinë dhe papunësinë, megjithëse pjesa e saj në GDP, vazhdon të zvogëlohet. Mbetet ende shumë punë për përmirësimin e cilësisë së produkteve bujqësore dhe të peshkimit, veçanërisht në lidhje me sigurinë e ushqimeve.

Progres i kufizuar është bërë për sa i takon *mjedisit*. Legjislacioni i ri i miratuar është i përmirësuar, por zbatimi i tij vazhdon të mbetet problematik. Duhet të forcohet kapaciteti administrativ për të zbatuar legjislacionin mbi mjedisin.

Njëfarë progresi është arritur në *sektorin e transportit*, veçanërisht në legjislacion dhe pjesëmarrjen në diskutime ndërkombëtare, por infrastruktura e saj mbetet e pamjaftueshme dhe me mirëmbajtje të dobët. Shqipëria duhet të zbatojë masterplanin për transportin dhe të përmirësojë sigurinë në mënyrat e ndryshme transportuese. Investimet në transport duhet të jenë transparente dhe të respektojnë rregullat e prokurimit. Shqipëria ka bërë goxha progres në *sektorin energjetik*, veçanërisht me vënien në zbatim të plan veprimit për energjinë, duke harmonizuar legjislacionin dhe duke nënshkruar traktatin e Komunitetit Energjetik të Europës Juglindore. Shqipëria duhet të vazhdojë me vendosmëri zbatimin e planit të veprimit për energjinë, në mënyrë që të ulë mungesat akoma të shpeshta të energjisë dhe lidhjet e paligjshme. Progres është bërë edhe në *sektorin e shoqërisë së informimit dhe medias*, veçanërisht përmes liberalizimit të sektorit të telekomunikacionit, dhe përmirësimit të shpërndarjes së komunikimit elektronik. Privatizimi i Albtelecom mbetet një çështje për t'u përfunduar me sukses dhe legjislacioni i telekomunikacionit duhet të zhvillohet që të tërheqë investime të tjera. Nevojitet punë e mëtejshme për të harmonizuar legjislacionin mbi komunikimin elektronik, teknologjinë e informacionit dhe atë audio-vizual, si dhe të sigurohet një zbatim jo diskriminues. Shqipëria ka hartuar një Kartë Politikash (*Policy Paper*) për kontrollin publik të brendshëm financiar, por duhet çuar më tej. Për sa i takon auditimit të jashtëm, Kontrolli i Lartë i Shtetit i Shqipërisë duhet të përmirësohet në përputhje me udhëzimet INTOSAI, si dhe duhet garantuar pavarësia financiare e tij.

Në fushën e *drejtësisë, lirisë dhe sigurisë*, dokumentet e udhëtimit janë bërë më të sigurt, por nevojitet një progres i mëtejshëm në kompjuterizimin e sistemit të

vizave dhe ne ngritjen e legjislacionit për vizat në standardet europiane. Shqipëria ka përmirësuar në mënyrë të konsiderueshme *kontrollin e kufijve* me anë të një administrimi më të mirë dhe një infrastrukturë IT si edhe në një bashkëpunim më të mirë me fqinjët por trafiku mbetet një problem domethënës që duhet të trajtohet me anë të një strategjie të integruar të menaxhimit të kufijve, me qëllim sigurimin e një bashkëpunimi shumëpalësh. Janë miratuar strategji kombëtare mbi *migrimin* dhe *azilin*, Shqipëria ka nënshkruar një marrëveshje ri-pranimi me BE-në. Tanimë këto strategji duhet të financohen dhe të zbatohen.

Përparim është bërë në *luftën kundër pastrimit të parave*, me legjislacion të ri zbatues dhe gjithashtu janë marrë masa për të përmirësuar bashkëpunimin ndërmjet agjencive dhe atë rajonal. Këto aspekte megjithatë kanë nevojë për një punë të mëtejshme, duke u përqendruar tek rezultatet; Njësia e Inteligjencës Financiare, Prokuroritë dhe Sektori i Krimin Ekonomik në Polici, kërkojnë më shumë burime që të funksionojnë në mënyrë efikase. Shqipëria ka bërë disa përparime në luftën kundër trafikimit të paligjshëm të drogës duke miratuar dhe një strategji kombëtare kundër drogës, futjen e mjeteve të veçanta të hetimit dhe legjislacionin për ngrirjen e aseteve.

Megjithatë Shqipëria vazhdon të mbetet një vend i rëndësishëm tranziti për trafikun e drogës dhe duhet ti japë një përparësi më të madhe financimit dhe zbatimit të strategjisë kundër drogës. Ajo duhet të forcojë më tej zbatimin e ligjit, të përmirësojë si koordinimin e brendshëm ashtu edhe atë me partnerët e huaj dhe të parandalojë pengimin e hetimeve mbi drogën nga ana e nëpunësve të administratës publike. Është bërë progres në rritjen e efikasitetit të *policisë së shtetit*, me forcimin e departamenteve që kanë të bëjnë me krimin e organizuar dhe korrupsionin; ndjekjen penale dhe shkarkimin e një numri të madh zyrtarësh të lartë të policisë me akuza për korrupsion. Megjithatë Shqipëria duhet të përmirësojë më tej pajisjen dhe menaxhimin e policisë veçanërisht për sa i takon burimeve njerëzore transparencës autonomisë dhe dosjeve të policisë dhe duhet gjithashtu të përshpejtojë përpjekjet për të arritur një marrëveshje me Europolin Shqipëria ka bërë progres në *luftën kundër krimin të organizuar dhe terrorizmit* duke miratuar një paketë ligjore për këtë çështje. Shqipëria ka vazhduar të zbatojë masat specifike vepruese kundër krimin të organizuar, ka përmirësuar organe kyçe të ministrisë dhe ka përmirësuar ligjet mbi burimet financiare të krimin. Është përmirësuar shërbimi informativ i policisë dhe është ulur trafikimi i qenieve njerëzore përmes detit. Progresi në zbatimin e masave vepruese duhet të përshpejtohet dhe duhen marrë hapa konkretë për përmirësimin e mbrojtjes së dëshmitarit në mënyrë urgjente. Shqipëria duhet të përmirësojë bashkëpunimin minim agjencive, të përfshihet me më shumë forcë në bashkëpunimin rajonal dhe ndërkombëtar dhe ti përdorë mjetet e reja ligjore me më shumë vendosmëri për të arrestuar, ndjekur penalisht anëtarët e krimin të organizuar. Lufta kundër

terrorizmit është përforcuar me ngritjen e një Drejtorie Speciale në Polici. Shqipëria ka mbështetur nismat ndërkombëtare në këtë fushë, ka dëbuar të dyshuarit si mbështetës të terrorizmit dhe po përmirëson sigurinë në aeroport. Ajo duhet të përshpejtojë zbatimin e konventave ndërkombëtare dhe të forcojë më tej sigurinë në aeroportin e Tiranës.

C. PARTNERITETI EUROPIAN: VLERËSIM I PËRGJITHSHËM

Progresi i Shqipërisë dhe zbatimi i përgjithshëm nga ana e shtetit i procesit të Stabilizimit dhe Asociimit është analizuar më sipër. Në këtë seksion vlerësohet shkurtimisht masa deri në të cilën janë zbatuar përparësitë e Partneritetit European, që janë miratuar nga Këshilli në qershor të vitit 2004. Qëllimi i Partneritetit European është që të ndihmojë autoritetet shqiptare në identifikimin e përparësive afatshkurtra dhe afatmesme që duhet të zbatohen nga Shqipëria për të bërë një progres të mëtejshëm drejt anëtarësimit në BE. Përparësitë janë hartuar në mënyrë realiste dhe me pritshmërinë që Shqipëria është e aftë t'i përmbushë apo t'i çojë mjaft përpara gjatë viteve të ardhshme. Duhet bërë dallim mes përparësive afatshkurtra, që duhen përmbushur brenda 1-2 viteve, dhe përparësive afatmesme, që duhen përmbushur brenda 3-4 viteve. Partneritetet Europiane janë baza e programimit të asistencës nga fondet e BE-së. Përgjithësisht, Shqipëria ka shënuar progres në zbatimin e përparësive afatshkurtra të Partneriteteve Europiane, por ende nuk ka nisur të adresojë në mënyrë të bashkërenduar përparësitë afatmesme. Një progres i dukshëm është shënuar në miratimin e ligjeve të reja dhe në formulimin e planeve të veprimit. Në disa raste këto plane veprimi janë pasuar nga zbatimi, por në shumë raste të tjera, zbatimi në mënyrën e duhur është penguar nga vështirësitë që kanë lidhje me bashkërendimin e burimeve e ndonjëherë edhe me mungesën e vullnetit politik. Për sa u takon kritereve që kanë të bëjnë me **situatën politike**, rekomandimet e OSBE/ODIHR të nxjerra pas zgjedhjeve lokale të vitit 2003 u zbatuan gjerësisht, megjithëse ngadalë, gjë që çoi në zgjedhje më të mira parlamentare në vitin 2005. Pavarësisht nga të metat, këto zgjedhje parlamentare ishin krejtësisht të vlefshme dhe çuan në një kalim të lehtë të pushtetit. Shqipëria ka miratuar ligje të reja në fusha të rëndësishme si për shembull kthimi dhe kompensimi i tokës, ndryshimi i Kodit Zgjedhor, dhe për luftën kundër krimit të organizuar. Rregullorja e re e Kuvendit ka potencialin për ta bërë punën e tij legislative më racionale dhe transparente. Komisioni i Shërbimit Civil po nis nëpërmjet përdorimit më të mirë të inspektorëve, rezultatet e Institutit të Trajnimit të Administratës Publike janë në rritje; përparim ka gjithashtu edhe në rishikimin e ndarjeve territoriale. Reforma legislative e sistemit gjyqësor e ka sjellë Shqipërinë më pranë standardeve të BE-së. Transferimi i çështjeve të Gjykatës së Krimeve të Rënda është bërë në mënyrë që përqendrimi të jetë më i

madh në çështje që kanë lidhje me krimin e organizuar. Shkolla e Magjistraturës tani po punon në përputhje me një plan strategjik që e bën trajnimin të detyrueshëm. Është miratuar një strategji kombëtare për të përmirësuar kushtet e jetesës së romëve, si edhe është ngritur një Komitet Special Shtetëror mbi Minoritetet. Shqipëria ka zhvilluar marrëdhënie të mira rajonale nëpërmjet marrëveshjeve të tregtisë së lirë me fqinjët jo anëtarë të BE-së dhe nëpërmjet pjesëmarrjes në një numër nismash shumëpalëshe rajonale. Shqipëria, me Axhendën e Angazhimeve, i ka konsoliduar pozitat në kontekstin e OBT-së, pas shtyrjes deri në 2007 të unifikimit të tarifave doganore për disa produkte si birra, çeliku dhe produkteve të drurit. Pavarësisht nga kjo, Shqipëria përballlet me sfida shumë të rëndësishme në adresimin e përparësive që kanë lidhje me situatën politike: rregulla më të mira parlamentare mund ta kanalizojnë më mirë debatin, por klima politike duhet të jetë më bashkëpunuese, nëse Shqipëria do të arrijë në marrëveshje në kohën e duhur, mbi reformat e vështira. Pas miratimit, reformat legjislative dhe planet e veprimit duhet të përkthehen më shpejt dhe me një vullnet më të madh në arritje konkrete. Transparenca juridike duhet të nxitet duke bërë publike më shumë vendime; duhet të funksionojë një ligj më i mirë për mbrojtjen e dëshmitarit si edhe të sigurohet një mbështetje më e mirë financiare. Ligji i shërbimit civil duhet të zbatohet plotësisht, dhe emërimet politike të reduktohen deri në minimum. Shqipëria duhet të garantojë që strategjia e saj për të luftuar korrupsionin të jetë realiste dhe e saktë, që të jetë e shtrënguar në mënyrën e duhur dhe që të funksionojnë njëkohësisht edhe kapacitetet për të hetuar dhe proceduar shkeljet. Shqipëria duhet të tregojë një përkushtim më të madh dhe të përdorë më shumë burime për të hetuar dhe ndjekur penalisht rastet e korrupsionit në të gjithë shërbimet publike përfshirë policë si edhe të verë në zbatim Ligjin për Deklarimin e Pasurisë. Përpjekje të mëtejshme duhet të bëhen në mënyrë që oficerët e ruajtjes së rendit të jenë të ndërgjegjshëm për të drejtat dhe detyrimet e tyre dhe që këto detyrime të shtrëngohen akoma më mirë, ndërkohë që edhe shkeljet të ndëshkohen sistematikisht. Shqipëria duhet të zbatojë plotësisht master planin e vitit 2004 për përmirësimin e trajtimit të të burgosurve. Shqipëria duhet të rrisë lirinë e medias dhe të shprehjes duke miratuar legjislacion të ri mbi shpifjen, pronësinë e medias dhe lirinë e shtypit, legjislacion i cili duhet të jetë në linjë me standardet ndërkombëtare. Përpjekje të mëtejshme janë të nevojshme për të kompletuar kuadrin ligjor dhe administrativ për mbrojtjen e minoriteteve. Strategjia kombëtare për përmirësimin e kushteve të jetesës së romëve duhet të zbatohet plotësisht. Për sa u takon përparësive që kanë lidhje me **situatën ekonomike**, Shqipëria ka qenë e suksesshme në ruajtjen e një kuadri të qëndrueshëm makro-ekonomik, duke arritur përgjithësisht objektivat e FMN. Progres është shënuar dhe në heqjen e barrierave administrative për sa u takon investimeve, dhe agjencia shqiptare për SME-të

është tashmë funksionale. Është miratuar legjislacioni i ri në kthimin dhe kompensimin e pronës. Menaxhimi i financave publike është përmirësuar në mënyrë të ndjeshme, me një vlerësim më të mirë të të ardhurave dhe planifikim buxhetor, ku ky i fundit është përforcuar nga Sistemi i Integruar i planifikimit dhe një strategji e re në përputhje me BE-në mbi kontrollin publik të brendshëm financiar. Megjithatë, Shqipëria duhet të bëjë më shumë përpjekje për tu siguruar se është në pozita të tilla që mund të përmbushë detyrimet e ardhshme që rrjedhin nga MSA-ja, për të siguruar një zbatim jo diskriminues të ligjit të biznesit për shoqëritë e BE-së që vendosen në Shqipëri, për të përmirësuar legjislacionin tregtar, për të siguruar më shumë burime për agjencinë shqiptare të SME-ve, dhe për ta bërë më të lehtë themelimin e shoqërive në të gjithë vendin, sidomos për sa i takon taksave. Më në thelb, siguria mbi zotërimin e pasurisë duhet të përmirësohet urgjentisht nëpërmjet një zbatimi të plotë dhe në kohë të ligjit të ri mbi kthimin dhe kompensimin e tokës, sidomos duke përshpejtuar progresin në regjistrimin fillestar të pronës e më pas me trajtimin e pretendimeve pasuese. Shqipëria duhet të zhvillojë gjithashtu një strategji për të promovuar punësimin dhe kohezionin social, përfshirë masa që për të përmirësuar mënyrën se si sistemet e mbrojtjes sociale përqendrohen në burimet e kufizuara. Për sa u takon përparësive që kanë të bëjnë me **standardet Europiane**, progres është shënuar me një numër përparësish. Në fushën e *tregut të brendshëm*, një progres i konsiderueshëm është arritur për sa i takon standardizimit dhe akreditimit, me 57% të standardeve evropiane (ENs) të adoptuara nga CEN si standarde shqiptare; Drejtoria e Akreditimit është funksionale. Një progres i mirë është arritur në fushën e doganave, me përmbushjen e objektivave për të ardhurat, kapacitete të përmirësuara administrative, lëvizje të pakta të personelit, bashkëpunim më të mirë me policinë dhe zbatimin e sistemit ASYCUDA në Tiranë, Durrës, Qafë Thanë, Vlorë, Kakavijë dhe Kapshticë. Është ngritur Autoriteti i Konkurrencës dhe është miratuar një ligj i ri për ndihmën shtetërore, që parashikon ngritjen e një autoriteti të ndihmës shtetërore nga viti 2006. Për sa i takon pronësisë intelektuale, ligji i ri garanton një mbrojtje më të mirë të së drejtës së autorit. Megjithatë, adoptimi i standardeve evropiane duhet të shoqërohet nga masa që rrisin ndërgjegjësimin për rëndësinë e tyre mes operatorëve ekonomikë. Një progres më konkret duhet të bëhet nga shërbimi doganor në luftën kundër kontrabandës dhe trafikut. Legjislacioni tatar duhet të shtrëngohet në mënyrë më intensive në mënyrë që të ndihmojë në luftën kundër evazionit. Prokurimi publik duhet të përmirësohet si nga ana legjislative ashtu edhe për sa u takon kapaciteteve administrative në Agjencinë e Prokurimit Publik dhe ministritë e linjës. Progresi legjislativ mbi mbrojtjen e së drejtës së autorit duhet të pasohet nga përforcimi i kapaciteteve administrative dhe sensibilizimi mbi të drejtat e pronësisë intelektuale mes operatorëve ekonomikë;

duhet të rriten dhe shërbimet e shtrëngimit të ligjit. Për sa u takon *politikave sektoriale*, Shqipëria ka nisur të adresojë vatrat e rrehta në Durrës dhe Vlorë dhe ka shënuar progres në zbatimin e strategjive të menaxhimit të ujit. Shqipëria ka shënuar progres në zbatimin e strategjisë së energjisë, planit të saj të veprimit 2003-2005 dhe për sa u takon angazhimeve që ka marrë në kuadrin e procesit të tregut rajonal të energjisë që çoi në nënshkrimin e traktatit të Komunitetit për Energjinë në 25 tetor 2005. Por pavarësisht nga kjo, koordinimi ndër ministror mbi çështjet e mjedisit duhet të përmirësohet dhe të forcohen kapacitetet administrative në Ministrinë e Mjedisit. Tregu i telekomunikacioneve është liberalizuar që nga fillimi i vitit 2005 dhe ky sektor duhet që të rregullohet në mënyrë efikase. Në fushën e *drejtësisë, lirisë dhe sigurisë*, progres është shënuar në forcimin e kapaciteteve teknike për menaxhimin e kufijve, në përmirësimin e standarteve të menaxhimit dhe në analizën e riskut. Bashkëpunimi me shërbimet kufitare të vendeve fqinje është përmirësuar. Është miratuar strategjia kombëtare e migrimit si dhe është futur një sistem 'pre-screening' për të trajtuar me më shumë efikasitet rastet e personave në situata të parregullta. Është miratuar një paketë e re ligjore për të përmirësuar luftën kundër krimit të organizuar, është në zbatim strategjia antitrafik e vitit 2003 si dhe është arritur një ulje e ndjeshme e trafikimit të personave nga deti Adriatik. Është në funksionim strategjia kombëtare kundër drogës. Është arritur progres në forcimin e kapaciteteve të Shqipërisë për të luftuar pastrimin e parave, duke përmirësuar aftësitë hetuese të Policisë së Shtetit Shqiptar dhe në luftën kundër korrupsionit në radhët e policisë. Shqipëria i ka dhënë një mbështetje të qartë nismave të luftës kundër terrorizmit, ka marrë masa për të dëbuar të dyshuar si përkrahës të terrorizmit dhe në përmirësimin e sigurisë ajrore dhe aeroportuale. Paketa e re ligjore mbi krimin e organizuar përfshin gjithashtu edhe ngritjen e një drejtorie kundër terrorizmit në Policinë e Shtetit Shqiptar. Megjithatë, Shqipëria duhet të zhvillojë një strategji të integruar të menaxhimit të kufijve në përputhje me standardet e BE-së, shërbimet e menaxhimit të kufijve duhet të bashkëpunojnë më ngushtë me homologët e tyre në vendet fqinje. Duhet të sigurohen burime të mjaftueshme për zbatimin e strategjisë kombëtare për migrimin dhe të përditësohet plani i veprimit kombëtar mbi azilin. Ligji mbi gradat e policisë duhet të zbatohet plotësisht. Procedurat e policisë në mënyrë të përgjithshme dhe veçanërisht disiplina e brendshme dhe ngritja në detyrë duhet të jenë më transparente. Bashkërendimi i shërbimeve në terren në luftën kundër krimit të organizuar duhet të përmirësohet, sidomos ndërmjet policisë dhe prokurorisë. Legjislacioni i ri në luftën kundër krimit të organizuar duhet të ndiqet nga një zbatim rigoroz që do të çonte në arritje konkrete- në arrestimin dhe ndjekjen penale të shkelësve si edhe në konfiskimin e aseteve. Duhet të përmirësohen procedurat e punës dhe niveli i burimeve për zbatimin e

legjislacionit mbi pastrimin e parave, gjithashtu, edhe legjislacioni për drogën duhet të shtrëngohet më fuqimisht. Progresi i Shqipërisë në adresimin e çështjeve të identifikuar si përparësi nga Partneriteti European i vitit 2004 është diskutuar në mënyrë më të hollësishme në pjesë të tjera të këtij raporti, veçanërisht në Seksionin B.3. Mbi bazën e konstatimeve të këtij raporti, Komisioni propozon një Partneritet European të korrigjuar për Shqipërinë që do të miratohet nga Këshilli. Partneriteti European do të vazhdojë të jetë një mjet kyç që do të udhëheqë përpjekjet e Shqipërisë drejt Bashkimit European. Atij i duhet dhënë vëmendja e duhur politike për të ndihmuar Shqipërinë në vendosjen e axhendës legislative dhe të ndërtimit të institucioneve.